



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 5 KORRIK 2012

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. JULA 2012. GODINE

KORRIK - JULI
2012

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Interpelanca e ministrit Besim Beqaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me procesin e privatizimit të Shpërndarjes dhe të Furnizimit të KEK-ut,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë,
7. Shqyrtimi i Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025,
8. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Interpelacija ministra Besim Beqaj prema zahtevu Parlamentarne grupe Pokreta “Vetëvendosje” u vezi sa procesom privatizacije Distribucije i Snabdevanja KEK-a,
5. Prvo razmatranje Nacrt zakona o zaštiti biljaka,
6. Prvo razmatranje Nacrt zakona o registraciji poljoprivrede,
7. Razmatranje Predloga-mineralne strategije Republike Kosova, za period 2012-2025,
8. Razmatranje Preporuke Komisije za nadgledanje javnih finansija u vezi sa Izveštajem revizije finansijskih pregleda Organa za razmatranje javne nabavke.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, dëshiroj që në emrin tim dhe tuajin t'i përshëndetim deputetët e Parlamentit të Bangladeshit, të cilët janë në një vizitë në Republikën e Kosovës.

(Duartrokitje)

Faleminderit! Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, në emër të grupeve parlamentare diskutimi 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta.

Fjalën e ka kërkuar në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuari kryetar,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Fillimisht dua t'u kërkoj falje qytetarëve të Kosovës dhe opinionit publik në lidhje me incidentin që ka ndodhur më 28 qershor në hapësirat e Kuvendit të Kosovës dhe dua ta sqaroj pozicionin tim.

Të nderuar kolegë deputetë,
Jemi përfaqësues të popullit, andaj e kemi obligim që të punojmë në ndërtimin e një shteti ligjor, duke paraqitur këto shqetësime të qytetarëve e duke ngrehur tema që janë në interes të tyre dhe për këtë unë kam qenë njëri nga deputetët më aktiv dhe më i zëshëm për qartësimin e opinionit publik. Paraprakisht, si deputet i Parlamentit të Kosovës, për hir të elektoratit që më ka votuar dhe qytetarëve të vendit, dëshiroj të qartësoj qëndrimin tim lidhur me incidentin.

Unë, Bekim Haxhiu, në asnjë moment, me asnjë fjalë dhe me asnjë veprim nuk kam qenë pjesëmarrës nxitës i asnjë dueli verbal që ka pasuar me sulm fizikë ndërmjet deputetëve Latif Gashi e Rexhep Selimi. Përkundrazi, e kam gjykuar dhe sot e gjykoj se ka qenë veprimi më banal që ka mundur t'i ndodhë këtij institucioni.

Duke i njohur të dy deputetët jam munduar ta parandaloj dhe ta evitoj më të keqen, që konsideroj se ka qenë turp për këtë vend dhe për këtë Kuvend.

Me sinqeritet e them se kam qenë faktori kryesor që e ka evituar më të rëndën. Për këtë dëshmojnë edhe deputetja dëshmitare Blerta Deliu dhe gazetarët e pranishëm. Jam munduar të evitoj përleshjen ndërmjet deputetëve Gashi e Selimi, e cila them edhe një herë se ka qenë veprim i ulët dhe jodinjitoz për Parlamentin e Kosovës, përfshirë edhe luftën dhe kërcënimet në medie se kush kend e ka rrahur dhe deklaratën politike të “Vetëvendosjes”, të cilat janë futur në politikë për ta nxitur luftën vëllavrasëse në Kosovë.

Por, do të ndalem te ngjarja e mëpastajme, pas incidentit ndërmjet Latif Gashit dhe Rexhep Selimit. Pas 20 minutave, në një pritë të organizuar hakmarrëse, jam sulmuar fizikisht, pa paralajmërim, nga 8 persona, gjë që mund të shihet edhe në incizime.

Jam sulmuar pabesisht nga ish-bashkëluftëtari im, Rexhep Selimi, të cilin 20 minuta më parë e kam shpëtuar që të mos e rreh keq Latif Gashi.

Jam sulmuar nga Florin Krasniqi, një bandit i nëntokës së palarë të biznesit të politikës në Kosovë, i cili që nga momenti i parë i futjes në politikë në Kosovë ka paralajmëruar vëllavrasjen, duke kërcënuar publikisht e fizikisht edhe kryeministrin e vendit.

Jam sulmuar nga Visar Ymeri, një milingonë e politikës sekrete të “Vetëvendosjes”, e këta u ndihmuan edhe nga 5-6 kriminelë që i bartin pas vetes si truproje.

Edhe një herë e them se jam sulmuar në shenjë hakmarrjeje, duke m’u përmendur gjatë sulmit edhe deklaratat e mia për Albin Kurtin.

Sot, deklaroj publikisht, edhe më përpara më kanë dërguar letra kërcënuese, më kanë përcjellë e kanë tentuar të më sulmojnë, më kanë lënë, stupca bejsbolli para derës së shtëpisë, por këto nuk i kam bërë publike. Nuk i kam bërë publike për të mos nxitur konflikt. Nuk kam dashur t’ua plotësoj skenarin e vëllavrasjes në Kosovë, që është duke e kërkuar Lëvizja “Vetëvendosje”. E tëra kjo u bë pse unë e demaskova Albin Kurtin për bashkëpunimin e tij me shërbimin serb. Kush të dojë le të shkojë në Stacionin e Policisë në Klinë dhe ta shohë takimin e Albinit me BIA-n. Se Albin Kurti ka pranuar zarf nga Beogradi, nuk ka dilemë. Këtë e kanë pohuar edhe deputetët e tij, Rexhep Selimi e Florin Krasniqi, të cilët para dy muajve, në Slloveni, në praninë edhe të dëshmitarëve të tjerë, kanë pohuar e vërtetuar se Albin Kurti ka pranuar zarf nga Beogradi. Tani le ta tregojnë përmbajtjen e zarfit!

Sot jam në politikë. E them me mburrje se deri në vitin 2008 kam qenë pjesë e Shërbimit Informativ të Kosovës, një institucion që jo rrallë po atakohet, shumicën e herëve nga njerëz që kanë kryer gjëra kriminale, e që e kanë turpëruar Kosovën. Por, pa merak, populli do ta kuptojë të vërtetën dhe askush nuk do të mund të privohet nga e vërteta e vet. Dhe SHIK-u nuk do të jetë, as nuk ka qenë strehë e atyre kriminelëve që e kanë turpëruar Kosovën.

Të nderuar kolegë,

Unë do të vazhdoj të jem aktiv në politikë, në misionin që e kam nisur në interes të qytetarëve të vendit. E them publikisht këtu lidhur me disa nisma individuale e kanunore. Unë nuk i kam borxh askujt, e as nuk do t'i hakmerrem askujt në mënyrë individuale. Derisa unë jam pjesë e politikës, për mua kjo çështje është e mbyllur. Këtë e bëj për hir të vendit tim dhe të evitimit të vëllavrasjes në Kosovë. E përsëris: Për mua kjo çështje është e mbyllur. Këtë e bëj për hir të vendit tim dhe të evitimit të vëllavrasjes në Kosovë.

Ndërsa kërkoj nga organet e Hetuesisë dhe të Prokurorisë të mos e neglizhojë incidentin dhe të merren seriozisht me të dhe fajtorët t'i vënë para drejtësisë. Njëkohësisht, i siguroj të gjithë votuesit e mi dhe qytetarët e Kosovës se mua nuk mund të më ndalojnë as me kërcënime...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ka kaluar koha. Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi, në emër të Grupit.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

E di që opinioni, qytetarët dhe Kuvendi i Kosovës pret nga unë të shpreh ndjenjën e keqardhjes për gjithë atë çfarë ndodhi javën e kaluar në hapësirat e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Do ta bëj këtë, por jo para se t'i them nja dy-tri fjalë paraprakisht.

Me përfundimin e luftës, në vitin 1999, përkatësisht 2000, një grup njerëzish që po përgatiteshin për politikë dhe për të përfituar edhe politikisht nga ajo luftë që lamë pas, duke u thirrur pikërisht në emër dhe në vlerat e asaj lufte, e dhanë UÇK-në. Ata hoqën dorë nga UÇK-ja, hoqën dorë lehtë nga betimi i ushtarit, hoqën dorë nga Qeveria e Luftës, madje sot hoqën dorë edhe nga flamuri me të cilin luftuam, por kurrë nuk hoqën dorë nga SHIK-u.

Pra, e çarmatosën UÇK-në dhe e shujtën, e armatosën SHIK-un dhe e ruajtën.

Prandaj, ishte vetëm ky rrjet spiunazhi i quajtur SHIK, i cili pa asnjë bazë ligjore e vazhdoi veprimtarinë e tij subversive edhe pas janarit të vitit 2000, kur edhe u shuan të gjitha institucionet e përkohshme, bashkë me Qeverinë e dalë nga lufta.

Por, megjithatë, populli i Kosovës e meriton dhe ka të drejtë ta dijë se kush ishte dhe kush është kjo organizatë që e mban nën presion opinionin. Ne, megjithëse bëmë pyetje, asnjëherë deri më tani nuk morëm përgjigje. Pra, pse nuk përgjigjen?

Nëse jo ata, pse nuk flet Kuvendi? Pse nuk flasin të zgjedhurit e popullit? Pse nuk flet Qeveria? Pse nuk përgjigjet askush?

Së paku, pse nuk flet asnjëri nga deputetët e Partisë Demokratike, të cilët nuk kanë të bëjnë me SHIK-un? Ata i inkurajoj të distancohen nga ky klan brenda tyre para se ta marrin përgjegjësinë që e kanë marrë tash me SHIK-un.

Ne, si Grup Parlamentar, i falënderojmë të gjithë deputetët, të cilët e kanë përkrahur dhe nënshkruar iniciativën e deputetit Krasniqi për ta bërë një komision hetimor parlamentar. Thjesht, një komision hetimor parlamentar, pa prejudikuar rezultatet e tij. Po ashtu, presim dhe i inkurajojmë edhe të tjerët që ta nënshkruajnë dhe qytetarëve t'ua kthejmë përgjigjen për të cilën ata kanë drejtë dhe nevojë të dinë.

Duke qenë kjo organizatë e quajtur “Shërbim”, ne thjesht duam ta dimë se kujt i kanë shërbyer dhe kujt i shërben edhe sot.

Duke e ditur se ata e kanë pranuar qenien e vet edhe publikisht, ne duam ta dimë thjesht kush ka qenë struktura?

Duke e ditur se ata vetë e kanë pranuar që kanë vepruar si shërbim informativ, ne duam ta dimë mbi çfarë baze ligjore ata kanë vepruar?

Duke e ditur se ata nuk kanë qenë vullnetarë e as humanitarë, ne duam ta dimë se kush i ka financuar?

Meqë ata janë deklaruar se e kanë ndërprerë aktivitetin e tyre që nga viti 2008, ne duam ta dimë thjesht ku janë arkivat?

Pra, këto përgjigje duan qytetarët nga SHIK-u, para se SHIK-u të marrë përgjigjen nga qytetarët.

Megjithatë, në vend që ata vetë të përgjigjen, provuan ta bëjnë të kundërtën, të heshtin. Ata shkuan edhe më larg, guxuan ta kërkojnë një gjë të tillë edhe nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

Por, ky guxim u doli jo i llogaritur mirë. Ata morën përgjigje në vend që të përgjigjeshin, por kjo nuk i ka bërë të ndihen mirë shumë qytetarë, të cilët presin më shumë nga ne. Presin që të mos biem në provokime të tilla. Prandaj, ndiej keqardhje ndaj atyre që nuk u ndien mirë kur panë lajme të tilla në medie. Por, njëkohësisht, u kërkoj që të na kuptojnë se sa vështirë është t'i durojmë këta njerëz, të cilët vazhdojnë ende me provokime të tilla. Madje, le të na kuptojnë, sepse edhe në të ardhmen asnjëherë nuk do t'i durojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Kjo pikë e rendit të ditës është për të shtruar çështje që janë në interes të publikut. Dhe, po ju njoftoj, pasi është kështu, çdo fjalë në të ardhmen që do të nxisë debat në këtë Kuvend, do të ndërpritet. Grupet parlamentare dhe deputetët kanë të drejtë të ngrenë çështje, e se si bëhet kërkesa për debat është e përcaktuar mirë në Rregulloren e Punës së

Kuvendit. Le të kërkojnë debat dhe le të zhvillohet debati. Por, për këtë pikë të rendit të ditës, e cila nuk parasheh as replikë, të gjitha çështjet që ngrenë debat do të ndërpriten menjëherë. Ta keni parasysh, ose përcaktojeni më mirë këtë çështje, por çështjet që ngrenë debat nuk janë për pikën e rendit të ditës: Koha për deklarime jashtë rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë që pika - Koha për deklarime jashtë rendit të ditës duhet të jetë për interesa dhe shqetësime që i kanë qytetarët e Republikës së Kosovës, por ka edhe debate që nuk bëhen jorastësisht, kryesisht për të shpërqendruar vëmendjen e qytetarëve nga problemet jetike që i kanë, e kjo nuk bëhet pa qëllim, e aktorët tashmë po dihen.

Çështjen që unë do ta theksoj sot ka të bëjë me pyjet e Bjeshkëve të Dukagjinit, konkretisht duke filluar nga Bjeshkët e Rugovës, e deri atje lart në Koshare, ku po bëhet një krim ndaj natyrës, të cilën Zoti ia dhuroj kësaj pjese të Republikës së Kosovës.

Konkretisht, pyjet e Deçanit janë duke u shkatërruar tërësisht nga tenderët, të cilët tashmë kanë adresë në komunën përkatëse, por edhe në Ministrinë për Bujqësi, e cila kishte dhënë këtu premtime që me këto çështje do të merret shumë seriozisht.

Pyjet janë zhveshur nga bimësia, është krijua peizazh i trishtueshëm, që është dëshmi e rrënimin që ka sjellë ky aktivitet i paligjshëm në Alpet Shqiptare.

Autoritetet lokale e pranojnë se prerja e paligjshme e pyjeve është bërë një problem dhe ata thonë se janë duke punuar fort që ta ndalojnë këtë. Madje krenohen edhe me disa suksese. Po të njëjtën gjë e atribuon edhe vetë Ministria në fjalë.

Shumë herë është thënë që do të ashpërsohen masat ligjore, jo vetëm ndaj keqpërdoruesve operatorë, por edhe ndaj prerësve ilegalë të pyjeve. Por, kjo nuk ka ndodhur fare. Sot shihen çdo ditë dhjetëra makina të rënda, të ngarkuara me dru sapo të prerë që zbresin poshtë shpateve të pyjeve të Deçanit, por edhe komplet Rrafshit të Dukagjinit, në emër të pastrimit të pyjeve, në emër të mirëmbajtjeve dhe të gjitha janë ilegale. Këtë pasojë janë duke e vuajtur qytetarët deçanas, janë duke e vuajtur qytetarët e Rrafshit të Dukagjinit dhe mendoj se për këtë fajin e ka Ministria, sepse deri tash Komuna nuk ka mundur ta shpëtojë, ndërkaq problemi ka mbetur jetim. Kryesorja në këtë aspekt janë Prokuroria dhe Gjykata, të cilat, jo vetëm që nuk kanë mundur t'i kryejnë detyrat e veta, por së bashku edhe me Policinë janë përgjegjësit kryesorë në këtë strukturë kriminale që po u bëhet pyjeve të Deçanit.

Prandaj, unë e ftoj ministrin e Bujqësisë, që bashkërisht me strukturat lokale ta marrë seriozisht këtë çështje, sepse do të bëhet vonë dhe pasojat për biodiversitet dhe për jetë të qëndrueshme në atë pjesë të Dukagjinit do t'i vuajnë konkretisht qytetarët e Pejës, të Deçanit, por edhe pjesa më e madhe e qytetarëve të Gjakovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu. Mirë, fjalën në emër të Grupit e ka deputetja Donika Kada-Bujupi.

DONIKA KADA BUJUPI: Po, si duket është dashur të lajmërohem paraprakisht.

I nderuar kryetar,

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Dje, kryeministri dhe ministrja e Integritetit u panë shumë entuziastë në kërkesat për përmbushjen e obligimeve nga udhërrëfyesi në raport me komunat me liberalizimin e vizave.

Dhe, një ndër pikat shumë të rëndësishme që u përmend edhe nga vetë kryeministri ishte lufta dhe qasja më e drejtpërdrejtë në luftimin e krimit dhe të korrupsionit, rrjedhimisht fuqizimin e zbatimit të ligjit.

Me qëllim të kontributit në këtë drejtim, si deputete e Kuvendit, më duhet të tërheq vëmendjen, sepse është një përpjekje e përbashkët e të gjitha instancave që sa më shpejt të arrihet ky liberalizim, që në dikaster të caktuar të kësaj Qeverie po vazhdojmë të shohim shkelje të jashtëzakonshme të ligjit, në mungesë të zbatimit të tij.

Sot, përsëri, do ta rikthej vëmendjen në shkeljet dhe vendimet arbitrare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, të cilat nuk po kanë të ndalur edhe pas skandalit “Sharrcem”, i cili po vazhdon.

Do të ndalem te një autorizim i radhës për procedurat e vlerësimit të konformitetit, do të thotë në sektorin e naftës, i cili u besua një kompanie të huaj, “Saybolt Pan Adriatika”, e cila, bazuar në dokumentet e paraqitura nga vetë kompania, dokumentet që unë i kam marrë këtu, nuk ka akreditim sipas standardeve të parapara.

Bazuar në dokumentin e kompanisë, është e akredituar për cilësi, sasi dhe marrje të mostrës, por jo për njohje dhe pranim të dokumenteve. Dhe, kjo është në kundërshtim me Ligjin për kërkesat teknike, për produkte dhe vlerësim të konformitetit, respektivisht nenit 15, e sidomos nenit 17, dhe këtu me vete e kam ligjin. Mund ta verifikoni.

Si pasojë e kësaj shkeljeje, kompanitë vendore, trupi inspektues vendor, i cili këtë shërbim deri para dy muajve e ka kryer për çmimin 58 euro, është zëvendësuar me kompani të huaj, e cila shërbimin e njëjtë po e kryen për çmimin 109 euro.

“Saybolt Pan Adriatika” nuk e ka të akredituar procedurën e njohjes dhe të pranimit të dokumenteve as në Kroaci, kurse e kryen këtë shërbim në Kosovë. Dhe, po ashtu, vetë e lëshon certifikatën në prodhim dhe vetë e njehtë dokumentin e vet në Kosovë, domethënë ka konflikt interesi, sepse ka mbi 50% të aksioneve në OKTA.

Dikush mund të thotë, ‘po bëhen edhe shkelje më të mëdha’, por shkelja si kjo, që duket procedurale, na kushton me miliona euro si Kosovë, e këto veprime të koordinuara ndërmjet MTI-së, kompanive dhe grupeve të caktuara të interesit, në dëm të kompanive të tjera, në këtë rast të vendit, kompanive vendore dhe në kundërshtim me ligjet në Evropë dhe në botë, trajtohen si veprim i organizuar në mënyrë hierarkike, me qëllim të

përfitimeve nëpërmjet veprimeve kriminale të paligjshme, e kjo e ka edhe një kosto shtesë që po e paguan qytetari i Kosovës.

Ai studenti, tek i cili ministrja Mimoza, në këtë rast, ka premtuar zhvillim, punësim, prosperitet, lëvizje të lirë në të gjitha ato takime të shumta parazgjedhore, e pret kot liberalizimin për të mundur të udhëtojë.

Prandaj, për kryeministrin, duke e vlerësuar dhe respektuar angazhimin e tij në përpjekje për liberalizim dhe domosdoshmërisë për t'iu qasur gjithë bashkë si institucione, si Kuvend, Qeveri, komuna, e kisha ftuar që para se të fillojë të kërkojë përgjegjësi nga të tjerët, ta pastrojë shtëpinë e vetë, sepse po kundërmon. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Petar Miletiq.

PETAR MILETIĆ: Poštovani predsedniče Skupštine,
Poštovani predsedniče Vlade, zameniče predsednike Vlade, ministri,
Koleginice i kolege poslanici,

Tačno pre dve godine, na današnji dan, sam krenuo na sednicu Skupštine Kosova, na dnevnom redu je bilo rebalanc budžeta i razmišljao sam noć pre toga kako da izrazim protest pre dve godine zbog ubistva doktora Mesuda Đekovića, koji je 3 dana pre toga ubijen na očigled oko 300-400 građana i oko 50 policajaca, kada je na masu bačena bomba, i o te ručne bombe doktor Đeković je poginuo.

Razmišljajući o tome, silazeći kroz stepenice, došao sam do svoka auta, krenuo da ga otključam, i začuo pucnje. Pogoden sam sa dva metka u gornji deo nogu. Jedan je prošao kroz levu nogu, i ušao u desnu, i taj metak mi je još uvek u desnoj nozi, a drugi je prošao kroz desnu nogu. Nisam uspeo taj dan da dođem u poslanički klub, i sa svojim kolegama raspravim na koji način da izrazimo protest zbog ubistva doktora Džekovića, koji je bio jedan od najomiljenijih lekara u Mitrovici, a kada kažem Mitrovica mislim I na njen i severni i južni deo.

Od tog dana kažem prošlo je dve godine, i ja i moja politička partija, Samostalna Liberalna Stranka, nikada nismo zloupotrebljavali ono što še meni tada desilo. I nikada nismo pokušavali da na tome dobijemo jeftine političke poena. To ne želim i danas. Želim samo da ukažem da dve godine nakon tog događaja, mi neznam koji to uradio, neznam koje je ubio doktora Đekovića, i ako je to se odigralo pred stotinama ljudi i policajaca, i neznamo koje pokušao da ubije poslanika ove Skupštine. Razmislite, koleginice i kolege poslanici, ministri u Vladi, kao politička elita Kosova, da danas je moguće na Kosovu pucati u narodnu poslanika, a da se ne zna koji je to uradio, usred bela dana, u 8:00 sati ujutru.

Šta me motivisalo danas da govorim o tome? Motivisala me odlučnost policajaca na Vidovdan ove godine kada sam video s kolko odlučnosti skidaju majice građanima koji su krenuli na Gazimestanu tog dana na pravoslavni praznik. Motivisalo me to kada sam video s koliko odlučnosti policija hapsi poštara, koji nosi račune za total TV. Kada bi policija radila...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të Grupit e ka fjalën.

... tako odlučno na ovim slučajevima, na ova dva slučaja, kao što je sa odlučnošću skidala majice i slala ljude na jedan hrišćanski obred polugole, ja mislim da bi ovi slučajevi bili rešeni. Zato apelujem danas na sve nas, uključujući i sebe, da razmislimo o tome. Nemojte nas terati da pomislimo da Policija Kosova radi po etničkom principu, da ima dvostruke standarde. Mi to ne želimo, mi želimo policiju koja kriminalce šalje u zatvor, koja kriminalce hapsi, a koja pošteni svet ostavlja da odlazi i da ispoštuje svoj pravoslavni obred, kako su to želeli ljudi koji su odlazili na Vidovdan.

Ja želim da verujem da će ministar unutrašnjih poslova i direktor policije obaviti istragu da li je bilo prekomerne upotrebe sile na Vidovdan ove godine. Televizijski snimci govore da je bilo. Molim ministra, molim sve članove Vlade da okrenu istragu, i da vide ko je naredio da se ljudima skidaju majice, ali ne samo skidaju majice, neki su bili pretučeni. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar,
I nderuari kryeministër,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë dhe ju kolege deputete,
Pasi është 30-minutëshi i rendi të ditës ku ne mund të ngremë çështje që i preokupojnë qytetarët dhe për shqetësimet, unë do të ngre një çështje lidhur me 85 punëtorët e “Ferronikelit”, të cilët padrejtësisht u dëbuan nga puna, pa asnjë paralajmërim.

Si deputete e Parlamentit të Kosovës, dua të solidarizohem me fatin e këtyre punëtorëve dhe përshëndes njëherësh edhe kryetarin e Komunës së Drenasit, i cili u është gjetur pranë dhe ka kërkuar nga Inspektorati i Komunës që këtë problem ta inspektojnë dhe të dalin me një raport. Prandaj, kërkoj nga të gjitha organet përgjegjëse që problemi i këtyre punëtorëve dhe fati i shumë punëtorëve tjerë në Kosovë, të cilët padrejtësisht maltreohen edhe keqtrajtohen në vendet e punës, të përfundojë kjo praktikë, e cila po e dëmton shumë imazhin e Kosovës, në përgjithësi, dhe po e rëndon edhe më tepër varfërinë e Kosovës.

Edhe një herë dua të solidarizohem me të gjithë punëtorët dhe kërkoj që kjo dramë të përfundojë sa më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Faleminderit, kryetar!
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të sjell vëmendjen tuaj lidhur me një projekt të investuar nga Shoqata Mbretërore Norvegjeze “Norges Vel”, në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Komunën e Lipjanit në shkollën e mesme “Adem Gllavica”, në Lipjan.

“Norges Vel” ka investuar rreth 7 milionë euro, duke punësuar mbi 30 punëtorë dhe e ka krijuar një fond mjaft të begatshëm të aseteve në blegtori, pemëtari dhe degë të tjera të bujqësisë pranë kësaj shkolle, në një fermë, e cila ka shërbyer në nivel të vendit, jo vetëm për komunën e Lipjanit.

Kjo shkollë ishte bërë pikë referimi për edukim dhe trajnim praktik të kuadrove nga të gjitha degët e bujqësisë. Këtu është investuar në krijimin e objekteve, aseteve, pajisjeve dhe infrastrukturës për kultivimin, ruajtjen, përpunimin dhe shitjen e produkteve finale bujqësore dhe blegtorale.

Në dhjetor të vitit 2010 është nënshkruar një kontratë ndërmjet “Norges Vel”, pra investitorit, dhe Komunës së Lipjanit për transferimin e projektit tek autoritetet komunale. Po ç’po ndodh tani me këtë investim, prej kohës kur menaxhimi ka kaluar në kompetencë të autoriteteve vendore.

Fatkeqësisht, pas kalimit të kompetencave nga “Norges Vel”, pra investitori, tek autoritetet komunale, tek autoritetet vendore, aty po ndodh një tranzicion i vështirë, për të mos thënë po shkatërrohet gradualisht, duke u zvogëluar asetet dhe duke e tjetërsuar vlerën e një pasurie milionëshe, të ndërtuar gjatë 7-8 vjetëve të fundit.

Gati një vit nuk janë dhënë as pagat e punëtorëve. Nga 30 punëtorë, sa kishte në momentin e bartjes së kompetencave tek autoritet vendore, për momentin aty punojnë 3-4 punëtorë. Kjo për shkak të mosplanifikimit dhe për shkak të mosharmonizimit të politikave zhvillimore dhe financiare nga autoritetet komunale me autoritetet qendrore, dhe si pasojë i gjithë ky projekt është vënë pikëpyetje dhe po rrezikohet të dështojë.

Është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit që sa më parë t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në bashkëpunim me autoritet komunale dhe Ministrinë e Financave për ta krijuar mundësinë financiare për vazhdimin e funksionimit të këtij projekti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja ime sot ka të bëjë me rikualifikimin e mësimeve.

Duhet që Ministria e Arsimit, bashkë me Rektoratin, urgjentisht të hartojë programe, në mënyrë që të përfshijë të gjithë kandidatët që e kanë të përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike. E përsëris, pa diskriminim, t’i përfshijë të gjithë kandidatët që e kanë të përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike, edhe në qoftë se nuk punojnë, sepse nuk është faj i tyre që nuk punojnë. Ata nuk janë fajtorë dhe nuk ishin fajtorë që e përfunduan Shkollën e Lartë Pedagogjike në kohën kur Universiteti i Prishtinës ishte universitet që

shquhej, kurse sot mundësitë janë të ndryshme. Pra, edhe një herë, urgjentisht të hartohen programe për t'u përfshirë të gjithë kandidatët pa diskriminim.

Kurse çështja tjetër ka të bëjë me pensionimin e profesorëve universitarë. Është për t'u përshëndetur hapja e universiteteve të reja, por duhet të rregullohet sa më parë çështja e pensionimit të profesorëve universitarë.

Në tërë rajonin, edhe në universitetet evropiane, profesorët e rregullt universitarë pensionohen në moshën 70-vjeçare. Domethënë, profesorët e universiteteve me grada doktor i shkencave pensionohen në moshën 70-vjeçare. Te ne nuk veprohet kështu, ndonëse disa herë është diskutuar dhe madje ekziston edhe një qëndrim i nënshkruar nga kryeministri që edhe në universitetet tona profesorët të punojnë me të gjitha të drejtat deri në moshën e përmendur.

Më intereson, pse nuk rregullohet kjo çështje? Këtë e shtroj për diskutim nga fakti se në Universitetin e Prizrenit japin mësim mësimdhënës pa asnjë gradë shkencore, pa asnjë punim të botuar. Kjo është e vërtetë. Kështu degradohet edhe emri universitet. Kjo ngjet në mungesë të profesorëve me grada përkatëse shkencore. Kush duhet të ligjërojë nesër në Universitetin e Pejës, apo edhe në universitete tjera?

Duhet së paku 30 vjet për ta pasur një profesor me titull profesor ordiner ose profesor i rregullt, siç quhet sot. Edhe me punime e vepra të nivelit ndërkombëtar. Askund nuk ndodh që këta profesorë të këtij formati të pensionohen në moshën 65-vjeçare, si një punonjës administrativ.

Si Parlament, na takon të kërkojmë që kjo çështje të rregullohet sa më parë dhe të hyjë në fuqi zbatimi i saj, sepse Universiteti i Prishtinës dhe sidomos universitetet e reja që po themelohen, dhe unë e përshëndes këtë zgjerim universitar, janë në deficit të stafit akademik dhe me kompetencë shkencore. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Rada Trajković.

RADA TRAJKOVIĆ: Gospodo poslanici, Imam želju da vam se obratim i da vas informišem i normalno da dobijem podršku svih vas za korektno, ljudsko, principijelno ponašanje ne po etničkom principu Kosovske policije, jer ono što smo videli na Vidovdan zaista govori da unutar Ministarstvo Unutrašnjih Poslova postoji paralelna komanda koja je dominantno Albanska, nažalost pokazalo se i verski opredeljena protiv vernika Srpske pravoslavne crkve.

Hoću da kažem da li je morala Kosovska policija da navijaće iz Vučitrna vozi prema Merdaru, da li je bilo praktičnije bolje, bliže da su se vratili prema Leposaviću i izbacili sa prostora Kosova i Metohije, a da se ne inicira ono što se inače delilo na Merdare, i da taj sukob pokrije sramotu koja se desila na Gazimestanu, gde su nažalost vernici Srpske pravoslavne crkve polugoli išli pred patriarhom i bili učesnici u parastasu. Dali niko ne kontroliše, ne obaveštava da su školski autobusi sa decom napadnuti molotovljevim koktelima, kamenje, gde 16 dece lakše i teže povređeno. Htela sam posle sat vremena da

snimam mesto gde se to desilo u centru Prištine. Nikada efikasnije institucije Kosova i Metohije nisu bile. Sve je bilo očišćeno, videla se samo jedan deo trave koja je gorela.

Želim da pitam i želim da znam, da li je ministar Unutrašnjih Poslova sa ovakvim scenarijem koja me podsećao u stvari na 17 mart 2004, godine s cenom u Merdare ili incidentom u Merdare, hteo da prekrije glavni cilj, a to je šikaniranje Srba po enklavama koji žive i da institucionalnim aktom teroristički koji se desio u centru Prištine bacanjem molotovljevog koktela na verenike zaplaši Srbe po enklavama? Da li uopšte vi želite i mislite da vam je cilj sever, ili je strateški cilj ove Vlade da suštinski protera i očisti enklave? Možda gospodin Bajram Redžepi nije ništa kriv, možda...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Ministra,

Kolegë të nderuar,

Është e udhës që sot, edhe në këtë pjesë të Kuvendit, të përshëndetet ajo që ka ndodhur më 2 korrik rreth Kosovës. Jo për të bërë propagandë, jo për të bërë festë, por për t'i theksuar rezultatet dhe të dhënat.

Është një sukses për Republikën e Kosovës, e cila ka kaluar 22 vjet të rënda dhe të vështira ndërmjet 2 korrikëve. E kam parasysh 2 korrikun e vitit 1990, ku forcat e organizuara politike të shqiptarëve dhe të rezistencës, edhe në nivel institucional, e shpallën Deklaratën e Republikës së Kosovës. Kjo natyrisht ndiqet në mënyrë institucionale me një Kushtetutë, që duhet të konsiderohet moderne edhe sot, të 7 Shtatorit, dhe me një referendum për pavarësinë e Kosovës, të shtatorit tjetër, më 1991. Duhet të them që ekziston një histori konstitucionale e Kosovës për pavarësinë dhe sovranitetin e saj. Ashtu siç ekziston një histori e qëndresës institucionale, e tolerancës nacionale dhe sociale, e marrëveshjes politike për lëvizjen e Kosovës kah liria dhe pavarësia dhe natyrisht dhe një luftë për gjithë këto. Dhe, tutje, një punë e fortë institucionale, që Kosova të bëhet shtet dhe të bëhet shtet demokratik, i pavarur, dhe shtet sovran. Të gjitha këto janë epitete të mira që i duan të gjithë, por ju e dini që nuk janë punë e kryer, meqë kërkohet punë ende.

2 korriku i këtij viti është një etapë e kësaj pune që na thotë ne të bëjmë ligje të mira si Kuvend dhe që e thërrasin Ekzekutivin t'i zbatojë ato ligje, sepse nuk ka as pavarësi, as zhvillim, as sovranitet në një vend ku nuk zbatohet ligji, ku nuk sundon ligji, që i bie - deliktet nuk mund të mos ndodhin një shoqëri, por aty ku sundon e drejta, ato dënohen dhe ajo është shoqëri e drejtë.

Edhe një herë po them: Është për t'i kujtuar këta 2 korrikë, që janë faza të ndërtimit institucional...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Jo, është harxhuar koha për këtë pikë të rendit të ditës. Fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi. Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Krasniqi,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
Kabinet qeveritar,
Zëvendëskryeministra,
Tashmë, siç edhe jeni të informuar, më 2 korrik 2012, Grupi Drejtues Ndërkombëtar në Vjenë e sollti një vendim historik për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës. Ky është vendim i rëndësishëm dhe historik për shtetin dhe qytetarët e Kosovës.
Kjo ditë dëshmon se sa rrugë të gjatë kemi bërë, sa shumë sakrifica dhe dhimbje, por edhe krenari kanë pasur dhe kanë qytetarët e Kosovës në këtë rrugëtim 22-vjeçar; 2 korrik 1990 - 2 korrik 2012.

Ky është vendim ndërkombëtar, por edhe besim i fuqishëm ndërkombëtar për të sotmen dhe të ardhmen e shtetit të Kosovës.

Qytetarët tanë çdo herë kanë pasur besim të fuqishëm, shpresë dhe optimizëm për Kosovën e lirë dhe të pavarur. Mbi të gjitha, për këtë sukses, merita më e madhe u shkon atyre njerëzve që sakrifkuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, i shkon çdo qytetari të Kosovës, që jeton në Kosovë dhe Diasporë. Prandaj, u jemi mirënjohës.

Dua të shpreh edhe një herë, të nderuar deputetë, konsideratën time të lartë për punën e madhe që ka bërë Zyra Ndërkombëtare Civile në zbatimin e planit gjithëpërfshirës, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Dëshiroj t'i falënderoj edhe një herë Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e fuqishme, vendet e Bashkimit Evropian dhe të gjitha vendet tjera pjesëmarrëse dhe aktive në Grupin Drejtues Ndërkombëtar.

Konsideroj se bashkërisht, të gjithë e kemi bërë një punë të shkëlqyeshme, e cila e ka bërë Kosovën shtet të respektuar në rajon dhe më gjerë.

Të nderuar të pranishëm,
Jam shumë i vetëdijshëm se kemi edhe shumë punë për të bërë. Ne duhet ta forcojmë sundimin e ligjit dhe ta rritim mirëbesimin e qytetarëve. Ne duhet ta rritim shkallën e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve tanë. Ne duhet ta realizojmë potencialin tonë të plotë të reformimit të pushtetit lokal dhe të sigurojmë qytetarët tanë se Qeveria e tyre, institucionet e tyre, janë përgjegjëse për nevojat për t'u shërbyer atyre.

Për më tepër, unë dua ta ritheksoj zotimin tonë për të rritur përfshirjen tonë në raport me të gjitha komunitetet në Kosovë, e në mënyrë të veçantë për komunitetin serb, që jeton në

veri të vendit, i cili e meriton t'i gëzojë të gjithat të drejtat që janë të përcaktuara me planin gjithëpërfshirës, me Kushtetutën dhe me ligjet e Kosovës.

Dua të jeni të sigurt se Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet thellësisht e përcaktuar në forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit.

Të nderuar deputetë,

Në këtë aspekt, ne jemi zotuar që ta gjejmë edhe bazën adekuate ligjore për të mundësuar vazhdimin e butë të mandatit të Misionit të EULEX-it deri në qershor të vitit 2014 dhe pres që për këtë qasje ta japë fjalën edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Agjenda qeveritare do të vazhdojë me një serë objektivash tjera gjatë këtij viti, kur do të krijohen të gjitha mundësitë ligjore në një ambient i favorshëm për jetë të qetë, me të drejta të plota, bazuar në planin gjithëpërfshirës, në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Përmbyllja e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës po shoqërohet edhe me ndryshimet e domosdoshme në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Unë jam i bindur se Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës me përkushtim po e bëjnë punën e tyre. Tani mbetet që bashkërisht të lëvizim drejt realizimit të qëllimit të vizionit tonë të përbashkët, anëtarësimi i Kosovës në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Edhe një herë, të nderuar deputetë, dëshiroj të ju falënderoj ju të gjithëve, por t'i falënderoj, para së gjithash, qytetarët e Kosovës për durimin dhe besimin që kanë treguar në angazhimet tona, kur ndonjëherë kemi marrë edhe vendime që nuk kanë qenë edhe aq fort të duartrokitura, por që kanë hapur edhe debate dhe kritika në adresa të ndërsjella, por kanë qenë të domosdoshme për të ardhur në këtë ditë të përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur.

Prandaj, disa vendime që merren nganjëherë po dëshmojnë se janë vendime në interes të shtetit, jo në interes të partive, jo në interes të një partie të vetme, jo në interes të një mandati qeverisës dhe jo në interes të politikës ditore.

Të nderuar deputetë,

Unë ju njoftoj se gjithçka ka filluar dhe do të përmbillet në Prishtinë. Prandaj, edhe takimi përmbyllës i Grupit Ndërkombëtar Drejtues do të mbahet në Prishtinë, në muajin shtator, kur do ta festojmë fundin e pavarësisë së mbikëqyrur, si dhe fillimin e një epoke të re të integritit të Kosovës në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Ne do ta festojmë jo largimin ndërkombëtar nga Kosova, por suksesin e Kosovës që do të vazhdojë me mbështetje të fuqishme ndërkombëtare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër! Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare të deputetëve është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët mund të parashtrojnë më së shumti dy pyetje parlamentare në një seancë.

Sot i kemi gjithsej 3 pyetje parlamentare. Pyetjen e parë e ka bërë deputeti Fikrim Damka për ministrin Fehmi Mujota. Deputet, e ke fjalën.

FIKRIM DAMKA:

Teşekkür ederim sayın Meclis Başkanı, sayın bakan,

Kosova Diller Kullanım Yasası'na göre Prizren ve Mamuşa'da Türkçe, diğer resmi dillerle eşit statüdedir. Kosova kanunlarına göre Türkler kendi anadillerinde eğitim, yazışma ve bilgi alma hakkına sahiptir. Uluslararası hukuka dayanarak her bireyin kendi anadilinde bilgi alma hakkını da göz önünde bulundurmuş olursak, bugün Kosova'da 18 yaşını doldurmuş gençlerimiz, kendi bilgisiyle ehliyet alabilmesi imkansız. Bunun nedeni de ehliyet testlerinin kendi anadilinde yani Türkçe olmasıdır. Bakanlık olarak bu testlerin Türkçe yapılması ne zaman başlayacaktır?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA:

I nderuari kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Fikrim Damka,

Bazuar në pyetjet që i keni adresuar në Ministrinë e Infrastrukturës, ju njoftoj se kjo ministri menaxhon me realizimin e projektit nacional të autostradës VII Vërmicë-Merdar. Realizimi i këtij projekti po bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të kontratës dhe të standardeve ndërkombëtare.

Tabelat e emërtimeve në udhëkryqet e autostradës janë të vendosura sipas Ligjit mbi përdorimin e gjuhës zyrtare në Kosovë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Ndërsa në të gjitha daljet e autostradës është përdorur edhe gjuha angleze.

Në të gjitha udhëkryqet e autostradës janë të vendosura shenjat e komunikacionit me emërtimet e qendrave kryesore brenda territorit të Republikës së Kosovës, lokacione ku janë daljet si dhe të gjitha emërtimet e qyteteve kryesore të shteteve fqinje që lidhen me korridorin e autostradës.

Duke pasur parasysh brengën tuaj, dëshiroj të ju informoj se emri i komunës së Mamushës figuron në tabelat e drejtimeve rrugore në rrugën nacionale dhe rajonale që kalojnë përgjatë territorit të komunës së Mamushës.

Autostrada është një korridor ndërkombëtar dhe ne jemi të obliguar të zbatojmë praktika ndërkombëtare sa i përket madhësisë së shenjave dhe shkronjat të cilat përdoren në shenja të komunikacionit. Në qoftë se ndërkohë hetohet ndonjë lëshim teknik, i cili mund të përmirësohet dhe i shkon përshtati kërkesës tuaj, sigurisht që është e realizuar, por gjithmonë duhet t'i përmbahemi Kushtetutës dhe ligjeve për përdorimin e gjuhës zyrtare në Kosovë.

Lidhur me pyetjen tuaj të dytë, ju njoftoj se momentalisht testet për testim të kandidatëve dhe për shofer hartohen sipas Ligjit për gjuhët vetëm në gjuhën shqipe dhe serbe. Sipas kërkesës për kandidatët në gjuhët tjera, testimi u mundësohet me përkthyes, pasi të ketë paraqitur kërkesë me shkrim kandidati i mundshëm.

Konkretisht në Prizren ka qenë i punësuar një pyetës i nacionalitetit turk për nevojat e kandidatëve, të cilët e kanë amtare gjuhën turke. Për fat të keq, ky zyrtar para pak ditësh ka ndërruar jetë dhe për momentin ky vend është i zbrazët, e ndërkohë ne jemi duke bërë përpjekje që të gjejmë format, që të kemi teste edhe në gjuhën turke dhe në gjuhën angleze, sepse kërkesat janë në shtim e sipër, ndërkaq që shpresojmë se deri në fund të vitit të arrijmë ta përmbushim edhe këtë obligim, por edhe këtë realizim të të drejtave të qytetarëve tanë për të pasur testim në gjuhën e tyre amtare. Ne e mirëpresim kontributin tuaj dhe të gjithë atyre që mund të ndihmojnë në këtë drejtim.

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit! Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Deputete, e ke fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Pelegrinazhi i qytetarëve të Serbisë më 28 qershor gjatë rrugës dhe në Obiliq është shoqëruar me provokime të rënda për qytetarët e Kosovës. Ata kanë lëshuar thirrje nacionaliste dhe kanë bartur në duar fotografitë e Milosheviqit dhe të Sheshelit, dy kasapëve dhe shkaktarëve të luftërave në Ballkan, kur u vranë qindra dhe mijëra njerëz, më shumë se 250 mijë. Ndërsa në Kosovë, si pasojë e dhunës së Milosheviqit, vetëm gjatë luftës u vranë rreth 15 mijë shqiptarë. Neni 40, pika 2 e Kushtetutës, thotë: “Liria e shprehjes mund të kufizohet kur kjo është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësisë në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike dhe fetare”.

Prandaj, zoti ministër, përse Ju dhe Policia që ju e drejtoni nuk e keni respektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet që rrjedhin prej saj dhe keni lejuar që më 28 qershor në territorin e Kosovës të futen grupe njerëzish, të cilët nxisin dhe provokojnë urrejtje etnike dhe fetare, duke rrezikuar kështu seriozisht sigurinë e vendit?

KRYETARI: Ministër Rexhepi, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
E nderuara deputete Alma,

Policia e Kosovës e ka përgatitur me kohë planin operativ për menaxhimin e situatës së sigurisë gjatë pelegrinazhit më 28 qershor.

Në bazë të raporteve të Policisë së Kosovës, rreth 2 000 pjesëmarrës pelegrinë në mënyrë të organizuar kanë marrë pjesë në Graçanicë dhe në Gazimestan të rajonit të Prishtinës me rastin e festës me karakter religjioz, Vidovdani.

Karakteristikë që duhet veçuar me rastin e realizimit të planit policor është një planifikim me kohë, i udhëhequr nga Policia e Kosovës, i cili është bazuar në kërkesat e parashtruara me kohë organeve vendimmarrëse për lejimin e hyrjes së delegacioneve në Republikën e Kosovës nëpërmjet vendkalimeve të ndryshme kufitare që ndërlidhen me Republikën e Serbisë.

Policia e Kosovës me vigjilencë dhe profesionalizëm e ka ofruar shërbimin e vet të sigurimit të pelegrinëve dhe të qytetarëve, në përgjithësi, duke siguruar një qarkullim të lirë, sipas agjendave dhe planeve të parapara.

Gjatë kohës së manifestimit janë raportuar disa incidente të vogla, të cilat nuk kanë ndikuar në sigurinë e përgjithshme, si rasti në Merdar, ku nga gjuajtja me gurë dhe gjësende të forta nga grupi i huliganëve serbë drejt zyrtarëve policorë janë lënduar gjithsej 35 zyrtarë policorë, kryesisht lëndime të lehta.

Një incident tjetër ka ndodhur në Graçanicë te varrezat e serbëve, në rrugën për Sushicë, ku disa të rinj serbë e kanë gjuajtur me gurë një autobus që qarkullon në linjë të rregullt në atë relacion.

Lidhur me këtë rast, Policia ka dalë në vend të ngjarjes, me ç'rast i ka arrestuar 3 persona të dyshuar si të përfshirë në këtë rast.

Policia e ka pranuar një informatë nëpërmjet linjës telefonike se në rrugën Prishtinë, në drejtim të Vetërnikut, te semaforët, afër vendit të hoteli "Victory", disa autobusë janë gjuajtur me gurë nga persona të panjohur dhe me një koktej molotovi. Të njëjtit kanë informuar po ashtu nëpërmjet linjës telefonike se e kanë vazhduar rrugën për në Llapnasellë, ku edhe kanë kërkuar trajtim mjekësor në ambulancën e atjeshëm.

Njësitët policore kanë dalë në vendngjarje për verifikim të informacionit dhe për veprimet e mëtutjeshme policore.

Në rajonin e Prishtinës, Policia e ka ndaluar një person të dyshuar të nacionalitetit serb, te i cili gjatë kontrollit të i njëjti janë gjetur dy radiolidhje, një palë dylbi dhe materiale tjera. Pas kontrollit të shtëpisë së personit të dyshuar në fshatin Korotishtë të komunës së Artanës, Policia ka konfiskuar dy armë zjarri - revole.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë? Regjia, fjalën deputetes Alma Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti ministër!

Informacionet që ju na i paraqitët këtu i kemi lexuar edhe nëpër medie në lidhje me planin e Policisë. Por, pyetja ime ishte pse nuk është respektuar Kushtetuta e Kosovës, në të cilën thuhet shprehimisht që nxitja e urrejtjes etnike fetare e të tjerë çon në kufizimin e këtyre lirive. Kjo vlen për qytetarët e Kosovës, mirëpo në një situatë kur qytetarët e tjerë nga një shtet tjetër hyjnë në Kosovë besoj që do të duhej të ishte edhe më e lehtë, sepse vijnë për të provokuar. Nuk besoj që ka qenë risi për ju dhe për Policinë që pelegrinazhet e tilla çdo 28 qershor janë provokime politike. Janë pelegrinazhe politike. Kjo ka ndodhur vjet, kjo ka ndodhur parvjet, domethënë ka nja 10 a 15 vjet që ndodh e njëjta gjë. Kështu që kjo nuk përbën kurrfarë risie. Përse lejohen qytetarë të tillë që vijnë dhe provokojnë dhunë këtu në Kosovë të hyjnë në territorin e Kosovës? Kjo është pyetja ime.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ne edhe më herët kemi kërkuar që grupe të caktuara, që janë të njohura për provokime dhe huliganizëm, të mos u lejohet hyrja. Kanë depërtuar nëpërmjet pjesës veriore, ku s'ka pasur gatishmëri të të tjerëve që të ndihmojnë në këtë proces.

E dini se është ndaluar hyrja për ish-ministrin për "Kosovë e Metohi", Bogdanoviq. Po ashtu, e dini që autobusi me huliganë të klubit "Crvena Zvezda" është deportuar dhe çdo njëri që ka bërë provokime, Policia ka vepruar në bazë të standardeve profesionale. Policia nuk vepron në mënyrë impulsive dhe hysterike.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Lutfi Haziri, nuk është këtu. Nuk kemi pyetje tjera.

Të pranishëm i kemi 64 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 28 qershor 2012

A ka vërejtje në procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 28 qershor?

Fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për të gjithë.

Në arsyetimin e Projektligjit për ndryshim-plotësimin për letërnjoftimin e kam bërë një lapsus, prandaj ju kisha lutur për korrigjim. Në vend të fjalës "pasaportë" të shkruhet "letërnjoftim".

KRYETARI: E do dikush tjetër fjalën? Me këtë korrigjim, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 28 qershor.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë sërish do të përqipem ta fus në rend të ditës miratimin e Projektligjit për heqjen e neneve 37, 38 dhe 39, të cilin në mbledhjen e fundit në Komisionin për Legjislacion e kemi shqyrtuar dhe në parim e kemi aprovuar. Konsideroj se kjo temë me të vërtetë është konsumuar mjaft. Konsideroj se në aspektin praktik nuk kemi nevojë ta zgjasim shumë për arsye se kemi për të dhënë përgjigje në një pyetje: t'i heqim këto nene, apo të mos heqim, ndërkohë që është shpenzuar debati në të gjitha dimensionet e tij të mundshme.

Konsideroj se sa më shumë që ta zgjasim, aq më shumë i bëjmë dëm vendit, për arsye se ky projektligj, përkatësisht Kodi Penal është i lidhur edhe me procesin e integriteteve euroatlantike dhe sigurisht që çfarëdo lloj raporti lidhur me këtë çështje do të dalë jo i mirë për ne.

Mendoj se ka ardhur koha që ta heqim këtë çështje, ta miratojmë në parim dhe nëse ka amendamente pastaj ta amendatojmë, gjë për të cilën edhe unë mendoj se duhet të amendamentohet sidomos emërtimi, meqë duhet të jetë projektligj për heqjen e neneve, e jo për shfuqizim.

Prandaj, propozoj që sot të futet në pikën e 9-të të rendit të ditës - Shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit për heqjen e neneve 37, 38 dhe 39, dhe shpresoj shumë se sot do ta kem përkrahjen për këtë propozim. Besoj që edhe përfaqësuesit e Komisionit për Legjislacion, sidomos kryetari, ka çfarë të thotë për këtë çështje. Ne e kemi pasur një vullnet të mirë politik në mbledhjen e fundit dhe madje i kemi sugjeruar Kryesisë që kjo të futet në rend të ditës. Së paku kështu është diskutuar dhe ka qenë edhe në procesverbal. Mund të mos jetë në atë dokumentin përfundimtar të rekomandimeve, por besoj që në procesverbal është kështu siç po them unë.

Prandaj, ju ftoj që ta pranoni propozimin që të futet në rend të ditës Projektligji për heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 në seancën e sotme. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë ligj dhe ju e dini se edhe herën e kaluar është tentuar të futet jashtë rendit të ditës, me ftesën që të bëhet shkelje e Rregullores së Punës. Ne si deputetë nuk kemi pranuar dhe kjo nuk ka kaluar. Mirëpo, janë përdorur procedura tjera, dhe procedura e mëtutjeshme që është përdorur është propozuar në mbledhjen e Komisionit jashtë rendit të ditës dhe me shumicë votash është vendosur të hyjë jashtë rendit të ditës dhe të trajtohet. Komisioni e ka trajtuar dhe ka vërejtur disa defekte. Mirëpo, ia ka drejtuar seancës për lexim të parë. Defektet janë te emërtimi i ligjit - Ligji për shfuqizimit e neneve 37, 38 dhe 39, ndërkohë që ligji ende nuk ka hyrë në fuqi. Prandaj, Komisioni mendon se duhet të amendamentohet titulli dhe përmbajtja e ligjit, mirëpo duhet t'i kemi parasysh edhe disa elemente.

Elementi i parë që duhet ta kemi parasysh të gjithë është edhe nëse ne e trajtojmë, me gjithë tendencën që të trajtohet me urgjencë ky ligj, për mendimin tim, nuk ka nevojë ta futim në rend të ditës, pos nëse seanca vendos, sepse tashmë janë plotësuar disa kriterë, mirëpo urgjencë nuk ka. E para, problemi kryesor është që edhe nëse e trajtojmë sot, nenet automatikisht nuk i heqim, se është lexim i parë, është ligj i ri. Është ligj për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Kodin Penal të Republikës së Kosovës, i cili hyn në fuqi më 1 janar të vitit 2013. Kjo nuk do të thotë që hiqen automatikisht nenet 37, 38 dhe 39, sepse ju e dini që mund të bëhen amendamente dhe do të bëhen amendamente. Amendamentet prapë votohen dhe prapë mund të mos hiqen nenet 37, 38 dhe 39, nëse nuk ekziston vullneti politik i deputetëve në Kuvendin e Kosovës.

Prandaj, duhet të jemi të qartë se çka po kërkojmë, duhet të jemi të qartë se qysh po procedojmë dhe duhet të jemi të qartë dhe se çfarë rezultati po prodhojmë. Unë nuk mendoj që prodhojmë ndonjë rezultat direkt për Raportin e Progresit, mirëpo nëse vlerësohet që Raporti i Progresit po u varka prej këtij projektligji, i cili po kalon sot në leximin e parë, duhet të kalojë në leximin e parë, sepse vullneti politik ekziston prej të gjitha partive, në përjashtim të PDK-së, ekziston që nenet 37, 38 dhe 39 të hiqen dhe pastaj tjerat janë çështje procedurale.

Mirëpo, çfarë desha të them është që automatikisht kjo nuk nënkupton heqjen e neneve 37, 38 dhe 39, nënkupton kalimin në leximin e parë të Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39, sepse mund të dalë dikush që propozon, supozojmë, të mos hiqet neni 39, ose të mos hiqet neni 38, bën amendament, propozohet, kalon amendamenti i tij dhe prapë jemi në situatën ku kemi qenë.

Prandaj, kjo ishte më shumë për sqarim për deputetët dhe për opinionin publik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit të LDK-së, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju e dini që LDK-ja e ka thënë qëndrimin e saj vazhdimisht për heqjen e këtyre tri neneve të kontestuara dhe po ashtu e di opinioni që herën e kaluar nuk kemi qenë që të bëhet ajo çfarë kërkonte të bëhet nga PDK-ja. Arsyeja ka qenë shumë e thjeshtë, sepse ata vetë na kanë prurë në këtë gjendje, po kjo parti e ka miratuar në Qeveri, ashtu siç e ka miratuar, e ka sjellë këtu, e ka kundërshtuar dhe ajo herën e kaluar ishte një tendencë, ose një tentim për t'u shfajësuar për diçka që s'mund të shfajësohen. Sidoqoftë, nuk do të kthehen pas, ne nuk kemi qenë, po ashtu po them edhe një herë, në seancën e kaluar që kjo të ndodhë në mënyrën si është tentuar, por e kemi thënë dhe i mbajmë fjalët tona. Si qëndrim të Grupit Parlamentar, e kemi thënë në seancën e kaluar, që po që se respektohen procedurat, ne si Lidhje Demokratike e Kosovës nuk kemi asgjë kundër që kjo të futet në rend të ditës, sikundër që e kemi thënë po ashtu që kur të vijë koha, kuptohet pas debateve, ne do të përkrahim edhe heqjen e këtyre tri neneve. Dhe, konform kësaj edhe e paraqes qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, përkundër faktit që është thënë disa herë që më 1 janar 2013 hyn në fuqi e tjera, e tjera, sidoqoftë nuk dëshirojmë që t'i japim

dikujt adutin që tash të thuhet se ja që LDK-ja nuk po e mban, ose është kundër asaj që e ka thënë më herët.

Së këndejmi, ne e përkrahim dhe do ta votojmë që të futet në rend të ditës dhe pastaj, sipas procedurave, do të japim sigurisht kontributin që në leximin e dytë, pikërisht atë që u tha edhe më herët, vetë titulli e tjera të ndryshohet, sepse nuk përkon ashtu siç do të duhej të ishte edhe i propozuar. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Deputeti, kryetari i Grupit të “Vetëvendosjes”, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” mendon se ky ligj bën të hyjë sot në rend të ditës, që të jemi korrekt, ne jemi marrë vesh në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, që po qe se i kalon procedurat nëpër Komisionin për Legjislacion, ky ligj të futet në rend dite dhe unë nuk e kuptova pse të vijë kjo kërkesë nga Grupi Parlamentar i PDK-së, kur ashtu ka qenë marrëveshje. Pra, kjo ka dashur të jetë pjesë e rendit të ditës, por sidoqoftë ne e përkrahim që të hyjë në rend dite dhe të trajtohet ky ligj i cili do t'i heqë edhe tri nenet problematike.

Tërë angazhimi kundër këtyre neneve, prej fillimit ka qenë i Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe ne prej fillimit e kemi kundërshtuar në një projekt-kod me këto nene për të cilat pastaj, u pajtuan të gjithë që janë problematike dhe janë të dëmshme. Ne po ashtu edhe e kemi dërguar në Gjykatën Kushtetuese, këtë lëndë, pra me këto tri nene, për të kërkuar edhe mendimin e Gjykatës Kushtetuese për kushtetutshmërinë e neneve të tilla dhe tash është këtu, ata që e kanë krijuar këtë problem, faktikisht, dhe të cilët e kanë mbrojtur këtë problem me këmbëngulje – që është Qeveria dhe Grupi Parlamentar i PDK-së, tash sikurse janë vetëdijesuar dhe po kërkojnë që të hiqen këto nene. Kjo është kërkesë të cilën ne e përkrahim dhe do të votojmë për ligjin.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

E kemi mbështetur herën e kaluar, e mbështesim prapë futjen në rend dite të këtij projektligji dhe sikur të ishte dëgjuar Aleanca, nuk kishim folur për këtë projektligj katër herë, pasi është miratuar në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarja e Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Qeverinë dhe deputetët.

Duke marrë parasysh se kaloi në monotoni kjo çështja e këtij projektligji, ne e kemi përkrahur edhe në seancën e parë, kur nuk e ka arritur qëllimin e vet, mirëpo e përkrahim edhe tash pasi ka dhënë rekomandim Komisioni Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit 6+, kryetari Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Qeveri e nderuar,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah këtë propozim që ky projektligj të futet në këtë seancë, gjegjësisht në rendin e ditës dhe është për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, nuk ka të lajmëruar.

Pra, votojmë. Ju e dini që të pranishëm janë 82 deputetë dhe duhet të votojnë për 55 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me numrin 74 plotësohet edhe kriteri i shmangies. Faleminderit! 74 deputetë, prej 82 deputetëve, do të thotë, plotësohet edhe kriteri i shmangies dhe ligji hyn në rend të ditës. Unë e pata atë dhe e votuan, po edhe kriteri i shmangies, thashë plotësohet. Lexoni nenin 56 dhe e shihni.

Vazhdojmë, atëherë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Interpelanca e ministrit Besim Beqaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me procesin e privatizimit, të Shpërndarjes dhe të Furnizimit të KEK-ut

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesën për të ftuar në interpelancë ministrin Besim Beqaj.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjatë deri në tri orë.

Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje prej 10 minutash dhe për përmbylljen e debatit deri në 5 minuta, neni 47, pika 7 e Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, ministri Beqaj paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash.

Koha e ndarë për diskutim, sipas grupeve parlamentare dhe të deputetëve në grupe parlamentare, është si vijon:

- Partia Demokratike, 50 minuta;
- Lidhja Demokratike, 40 minuta;
- Vetëvendosja, 18 minuta;
- Grupi i AAK-së, 18 minuta;
- Koalicioni për Kosovë të Re, 11 minuta;
- Grupi i SLS, 13 minuta;
- Grupi 6+, 7 minuta;
- Dhe deputetët, pa grupe parlamentare, 16 minuta.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri që ta marrë fjalën. Kohën e ke 10 minuta, deputet.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Privatizimi i shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, kompani kjo që po quhet Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, duhet të ndalet.

Propozimi i Komitetit Qeveritar të Privatizimit, pasi që i kishin hapur ofertat për këtë privatizim, që duhet vazhduar me procesin e privatizimit të kësaj kompanie, dhe miratimi që Qeveria ia bëri këtij propozimi, nuk ka as logjikë ekonomike dhe është jashtëzakonisht i dëmshëm në aspektin strategjik.

Distribucioni i energjisë elektrike, ku përfshihet rrjeti, por edhe tregu i saj, janë pasuri publike e Kosovës. Ato duhet të mbeten të tilla për shkak se furnizimi me energji elektrike është i domosdoshëm dhe e drejtë që secili qytetar duhet ta gëzojë.

Drejtësinë dhe domosdoshmërinë nuk na e përmbush dot tregu, por institucionet publike-shtetërore, të cilat janë të popullit dhe i japin atij llogari.

Qasja në energji elektrike na cenohet atëherë kur mbizotëron logjika e tregut në këtë sektor. Pra, po na cenohet pikërisht nga politikat e Qeverisë së Hashim Thaçit, të cilat tërë sektorin e energjisë po e dizajnojnë sipas logjikës së tregut dhe profitit privat.

Është e vërtetë se sot jetojmë në kushte të shpërdorimit të skajshëm të postit dhe institucionit publik nga Qeveria dhe partia në pushtet, mirëpo privatizimi i ndërmarrjeve publike është humbje e mundësisë së kontrollit demokratik mbi këto ndërmarrje edhe nesër.

Privatizimi i Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, është proces që nuk ka legjitimitet institucional. Kjo është një kompani publike e cila është inkorporuar, pra themeluar, më 24 gusht të vitit 2009 dhe pastaj është regjistruar, më 11 shtator të të njëjtit vit.

Vendimi i Qeverisë për privatizimin e kompanisë, është marrë më 2 tetor të vitit 2008, pra plot një vit para themelimit të kompanisë. Si mund të vendoset për ta shitur një

kompani të cilën nuk e ka krijuar ende? Madje, ky vendim i përçudshëm edhe e thotë këtë në pikën 1 të tij, e cila planifikon shitjen e aksioneve: “kurdo që është e mundur pas themelimit”, siç thotë vendimi i Qeverisë.

Një vendim të tillë të Qeverisë, Kuvendi e miratoi në parim, duke e mbështetur nismën e procesit të privatizimit, mirëpo, në vendimin e Kuvendit të datës 12 dhjetor 2008 edhe ky para themelimit të kompanisë, thuhet shprehimisht se së pari duhet realizuar plotësisht transformimi i KEK-ut, pra që kompania që do të privatizohet të ndahet plotësisht nga KEK-u, nga korporata. Një gjë e tillë ende nuk ka përfunduar.

Pasqyrat financiare të KEK-ut për vitin 2011 përfshijnë edhe KKDFE-n. Bordi i drejtorëve të KEK-ut është edhe i kësaj kompanie. Drejtori menaxhues i KEK-ut është edhe i drejtor menaxhues i KKDFE-së. Punëtorët janë të KEK-ut, asetet konsiderohen të jenë të KEK-ut.

Ende nuk është e qartë se çfarë po shitet, së paku jo për Kuvendin, nga i cili, të paktën në këtë legjislaturë të katërt, ky proces ka qenë tërësisht i fshehur.

Çështja e dytë domethënëse në vendimin e Kuvendit, është ajo në pikën 4 të tij, e cila e kushtëzon nisjen e privatizimit me një studim paraprak të fizibilitetit dhe me prioritizim të privatizimit të një njësie të caktuar. Vendimi i Qeverisë thirret në Ligjin për ndërmarrjet publike, përkatësisht në nenin 9 të këtij ligji, prandaj atëbotë i është proceduar Kuvendit, meqenëse ishte vendim për privatizimin e një kompanie publike.

Mirëpo, as në vendimin e Qeverisë dhe as në atë Kuvendit, askund nuk përmendet një fakt tejet i rëndësishëm dhe konkret për privatizimin, e ai është- përqindja e aksioneve që do të privatizohen.

Neni 9 e thotë shprehimisht se Qeveria ka të drejtë t’i shesë aksionet e një kompanie publike me kusht që një vendim të tillë ta miratojë Kuvendi. Por, si mund ta miratojë Kuvendi vendimin, po qe se nuk e di se sa për qind të aksioneve do të shiten? Pra, a nuk është kjo një informatë shumë e rëndësishme para se ta marrë vendimin?

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, do t’ia shtroj një pyetje të thjeshtë ministrit përgjegjës- A do ta sillni këtë vendim për privatizim në Kuvend për miratim, se ky proces i udhëhequr kështu siç e keni bërë ju, është jo legjitim? Sa për kuriozitet, një vendim të tillë të Qeverisë nuk e keni vendosur as në faqen e Zyrës së Kryeministrit, ku i keni të gjitha vendimet tjera nga mbledhjet e Qeverisë. Kjo pra, për hir të transparencës së kësaj Qeverie.

Çështja e dytë problematike në procedurat e ndjekura, është kushti formal i dy ofertuesve që parashihet me rregullat e prokurimit. Sa ofertues të interesuar realisht kanë qenë në këtë proces? Fillimisht e dimë të gjithë, ishin parakualifikuar 4 sosh, pastaj u zgjat periudha e tenderimit, me kërkesë të kompanive, për t’ua mundësuar atyre bashkimin në dy konsorciume.

Nga kjo, doli vetëm një konsorcium ndërmjet “Çalik Holding & Limak Holding”, meqenëse TAIB nga Bahreini u tërhoq tërësisht nga procesi, ndërkohë që edhe “Elsewedy Electric”, formalisht mbeti pjesë e garës. Por, as në fillim dhe as në vazhdimin e afatit për ofertim, kjo kompani egjiptiane asnjëherë nuk shprehu interesim për kompaninë që garonte për ta blinte.

E kemi ngritur këtë çështje edhe më herët këtu në Kuvend, asnjëherë këta nuk sollën ndonjë ekip profesional vlerësues në Kosovë. Është e dyshimtë madje nëse edhe dokumentet e tenderimit i kanë pasur të gjitha në rregull.

Infrastruktura e shpërndarjes së energjisë është monopol natyror. Nuk ka logjikë që secili ofruer i energjisë elektrike ta ndërtojë rrjetin e vet të shpërndarjes. Monopoli privat në asnjë mënyrë nuk mund të jetë i mirë për ekonominë e as për qytetarët, për shkak se kontrolli i tij përmby sektorin e energjisë, është absolut. E kontrolli mbi energjinë është kontroll mbi shtetin, ekonominë dhe shoqërinë. Energjia dhe infrastruktura e shpërndarjes së saj është çështje sovraniteti, ajo prek politikën shtetërore, por edhe popullin kolektivisht dhe secilin qytetar veç e veç. T’ia lëmë këtë në dorë një kompanie private, pa kurrfarë rëndësie se kush është ajo dhe prej nga vjen, është t’ia lëmë në dorë shtetin tonë, mundësinë tonë për zhvillim dhe mirëqenien tonë si qytetarë. Kjo mënyrë e privatizimit të KKDFE-së është në kundërshtim të plotë me rregullativën për shthurje dhe liberalizim të BE-së. Është thënë se po privatizohet rrjeti i tensionit 35 kilovoltë dhe linjat më poshtë. Shthurja e mëtejme i është lënë kompanisë. Ky është monopolizim në duart e kapitalit privat, dhimbjen nga i cili do ta ndiejnë qytetarët e Kosovës në lëkurën e vet.

Mirëpo, çka po shitet? A ka ndonjë vlerësim të pronës së kompanisë, e cila po shitet? Cili është ai dhe si është bërë vlerësimi? Për shembull, që nga viti 2003, në rrjetin e shpërndarjes janë investuar gjithsej 95 milionë euro nga paratë publike të Kosovës, dhe ndoshta ndonjë prej tyre edhe nga donacionet. Kjo si shtesë në atë që deri atëherë ekzistonte, një rrjet i shtrirë i shpërndarjes në tërë territorin e Kosovës, më mijëra kilometra kablo e shtylla, me mijëra trafostacione.

Sot ky rrjet përbëhet nga 18 mijë e 898 kilometra kablo, nga 1.500 trafo-stacione të tensionit të ulët dhe më tepër 300 trafostacione të tensioneve deri në 40 kilovoltë, vlera e të cilave nuk potencohet askund.

Të gjitha këto janë ndërtuar me paratë e qytetarëve të Kosovës, me kontribute të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Shtylla e trafostacione të shumta janë blerë drejtpërdrejt nga qytetarët. Shumë shtylla të energjisë elektrike janë të vendosura në prona private të qytetarëve të Kosovës. I tërë ky kontribut i bërë nga publiku është bërë për të mirën e publikut dhe i është bërë kompanisë publike, për shkak se qytetarët janë pjesë e publikes e tash, Qeveria ka vendosur ta shesë tërë këtë. Ku e merr të drejtën kjo Qeveri ta privatizojë pronën, e cila tashmë është private?

Njëri prej problemeve që është përmendur shumë, është edhe çështja e çmimit. Nuk ka kurrfarë informate se si dhe sa janë vlerësuar asetet e kompanisë që po shitet. Për shembull, Qeveria duhet të na e tregojë këtë informatë, para se ta kuptojmë se cili do të kishte qenë një çmim i volitshëm për një shitje të tillë.

Qeveria duhet të na tregojë se sa ka qenë vlerësimi i dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, si pjesë e arsytimit për kërkesën e rritjes së fundit të çmimit të energjisë? A ka qenë ky vlerësim i dorëzuar në ZRRE mbi 60 milionë euro? Nëse po, atëherë si u bë që brenda javëve vlerësimi të bjerë në 26.3 milionë euro?

Çështje tjetër që lidhet me çmimin, është tregu. Për shkak se KKDFE-ja nuk po shitet vetëm si asete, por edhe si kompani afariste në treg të garantuar prej 416 mijë konsumatorëve.

Vetëm sa për krahasim, i kisha marrë dy raste të cilat janë këtu në rajon, meqenëse politikat, Qeveria për privatizimin, zakonisht i arsyeton me ndodhi që po ndodhin në rajon, në Malin e Zi, Kompania e Distribucionit ia ka shitur 46.7% të aksioneve në vitin 2009, kompanisë italiane, A2A , për 463 milionë euro, me marrëveshjen që Kompania A2A do ta menaxhojë këtë deri në vitin 2014, dhe po ashtu do të ketë mundësinë që pas një periudhe, ose ta blejë pjesën tjetër kontrolluese, e ose Qeveria e Malit të Zi t'i blejë aksionet nga kjo kompani. Në vitin 2011, të dyja vullnetarisht hoqën dorë nga opsioni. A2A nuk do të blejë aksione shtesë e as Qeveria e Malit të Zi nuk do të blejë aksione nga ta.

Ose në Maqedoni, ADESM, Kompania e Distribucionit u shit për 225 milionë euro, 90% e kompanisë dhe jo qind për qind, siç po shitet në Kosovë, me zotim për 96 milionë euro investime, në një shtet ku janë 700 mijë konsumatorë.

Pyetje shtesë për Qeverinë në këtë drejtim, janë këto.

- Pse nuk i bën publike marrëveshjet të cilat do të nënshkruhen me rastin e privatizimit? Pra, marrëveshja për shitjen e kompanisë, ajo për implementim, marrëveshja për shitje me shumicë të rrymës elektrike e tjera.

- Si do të rregullohet pastaj çështja e importit të rrymës elektrike?

- Nëse kompania private KKDFE e ka monopolin për furnizim me energji elektrike dhe këtë rrymë do ta marrë nga KEK-u, më saktësisht nga gjenerimi, atëherë çfarë do të ndodhë në momente kur nuk do të ketë rrymë të mjaftueshme për ta përmbushur kërkesën?

- A do të importojë Qeveria me paratë publike përmes KOSTI-t? Nëse po, kush do ta paguajë dallimin në çmim, se dallim në çmim gjithsesi do të ketë? A do ta paguajnë qytetarët drejtpërdrejt, përmes faturës, apo do ta paguajnë qytetarët në mënyrë indirekte, përmes buxhetit?

Pastaj, çka do të ndodhë me borxhin...?

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e shtruar në interpelancë. I keni 15 minuta, zoti ministër.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Qeveria e Kosovës, konform Kushtetutës së Republikës dhe në harmoni me vizionin e saj për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, është e përcaktuar për reforma strukturale-ekonomike, për funksionalizim të ekonomisë së tregut, për fuqizim të sektorit privat, për vendosje të normave të larta profesionale dhe institucionale dhe gjithmonë këtë në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Qeveria është e përkushtuar për zhvillim të sektorit energjetik, sektor i cili duhet t'i zbatojë tri synimet themelore, të cilat Qeveria ia ka dhënë vetës, e ato janë: furnizim i rregullt me energji elektrike; prodhim i energjisë me kosto të përballeshme për qytetarët dhe zbatim i standardeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së ambientit.

Parimi i transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë, diskutimit të hapur me të gjithë aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë, puna profesionale, valorizimi maksimal i resurseve natyrore, ruajtja e plotë e interesit të punëtorëve, investimet afatgjate të cilat përmirësojnë infrastrukturën e furnizimit, eliminimi i garancive shtetërore, eliminimi i subvencionimit për mos inkasim, reduktimi i humbjeve komerciale dhe atyre teknike, janë parimet bazë, të cilat e kanë përcjellë këtë transaksion.

Ky transaksion është vazhduar në bazë të vendimeve të cilat Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka marrë dhe në bazë të dokumenteve të cilat unë do t'i përmend, në harmoni me Kushtetutën e plotë të Republikës së Kosovës, me Ligjin për ndërmarrje publike, i cili mundëson transformim struktural të ekonomisë, me Ligjin për partneritet publiko-privat për procedurat e aplikuar, në harmoni të plotë me strategjinë e Republikës së Kosovës për energji dhe cila është aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, vendimin e Kuvendit numër 03/5-074 dhe në harmoni me kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Për të hartuar një proces të mirëfilltë, transparent, kemi ndërtuar një strukturë menaxhuese dhe këshilluese të projektit. Kjo strukturë përbëhet nga mekanizmat në vijim. Komisioni qeveritar i privatizimit, i cili përbëhet nga 5 ministra dhe ka pasur për detyrë zbatimin plotësisht të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për proces transparent, të konkurrueshëm, për funksionalizim të ekonomisë së tregut.

Më shumë se 20 takime janë mbajtur deri më tani dhe gjithmonë këto takime kanë qenë takime në të cilat janë ftuar edhe mekanizma vendorë e ndërkombëtarë, duke përfshirë KEK-un, KOSTI-n, Zyrën e Rregullatorit, Kavda Beli-un, ICO-n, Bankën Botërore, Komisionin Evropian dhe USAID-in.

Çdo vendim, i cili është marrë në këtë komision qeveritar, ka qenë në harmoni të plotë me Grupin qeveritar, i cili ka qenë grup teknik, që i ka përfaqësuar të gjithë mekanizmat relevantë institucional shtetëror, të cilët kanë pasur mundësi për t'i trajtuar në aspektin teknik të gjitha përgatitjet e dokumentacioneve dhe vendimet janë marrë në harmoni të plotë. Njëkohësisht, vendimet janë marrë pas rekomandimeve të këshilltarit të transaksionit dhe në harmoni me aktorin tjetër, që është këshilltari strategjik, që në këtë rast ka qenë një angazhim jashtëzakonisht i fuqishëm i USAID-it nëpërmjet njësisë së saj, në këtë rast të kontraktuar - "Deloitte".

Ky transaksion dhe këshilltari i transaksionit, e kanë filluar punën duke e analizuar tregun, duke e analizuar gjendjen në kompani dhe duke analizuar mundësitë më të mira të mundshme për të dalë në proces të privatizimit.

Të gjitha dokumentet të cilat janë aprovuar nga Komisioni qeveritar, janë përgatitur nga EVS-i, me ndihmën e "Deloitte" dhe Njësinë për Implementim dhe po ashtu kanë kaluar edhe grupet, siç e thashë, teknike.

Procesi ka qenë i tillë i ndërtuar, sipas mekanizmave dhe standardeve më të larta ndërkombëtare dhe ato kanë qenë që duhet të kemi një proces parakualifikues dhe një proces të hartimit dhe marrjes së ofertave, të cilën ne e kemi bërë.

Procesi i para kualifikimit është bërë pas hulumtimit të gjerë të tregut. AVS-i dhe Deloitte kanë qenë të angazhuara në mënyrë konsistente për t'i analizuar përvojat e mira në rajon, përvojat e mira në Evropë dhe parimet e ekonomisë së tregut për të marrë një vendim të tillë.

Prandaj, në janar të vitit 2011, Komisioni qeveritar ka lëshuar procesin e parakualifikimit dhe këtë proces të parakualifikimit e ka bërë në media ndërkombëtare dhe ato vendore, duke botuar dhe duke bërë ftesë për para kualifikim në UK Economist, Financiel Teims, Info Theksen General dhe në gjitha gazetata lokale në Republikën e Kosovës.

Krahas këtij publikimi ndërkombëtar dhe hulumtimet e tregut, në cilësinë e kryesuesit së bashku me këshilltarët, kemi vizituar edhe investitorë potencial në Londër, Vjenë dhe Stamboll, për të siguruar një proces sa më konkurrues. Në mars të vitit 2011, katër kompani i kanë dorëzuar, realisht 6 kompani kanë paraqitur kërkesën, por 4 kompani janë parakualifikuar dhe në harmoni me standardet dhe dokumentet të cilat neve i kemi përgatitur para veti.

Pas procesit të parakualifikimit, në nëntor të vitit 2011, Komisioni qeveritar ka autorizuar lëshimin e draft-kërkesës për propozime, e cila ka definuar të gjitha obligimet kontraktuale, dhe ajo është marrëveshja për shitblerje të aksioneve, marrëveshja për furnizim me energji elektrike, marrëveshja për import, marrëveshja për implementim, marrëveshja për inkasim të borxheve të vjetra, marrëveshja për transfer, këtu përfshin transferin e punëtorëve, të aseteve dhe kontratave të Distribucionit dhe marrëveshjen për shërbime të përbashkëta.

Pas një periudhe të komentimit nga investitorët e parakualifikuar, KQP në muajin janar 2012 i aprovon dokumentet finale dhe skemën e transferim si pjesë e pakos tenderuese, prandaj më 21 maj 2012, është paraqitur edhe data finale për dorëzimin e ofertave.

Për t'i plotësuar standardet dhe transparencën e plotë, KQP, së bashku me këshilltarët e transaksionit, ka formuar Dhomën e të Dhënave, e cila ka qenë edhe dhomë publike ku të gjithë aktorët kryesorë, të cilët kanë dashur të marrin pjesë me informacione të detajuara rreth procesit, kanë mund t'i vizitojnë dhe janë dy dhoma, është Dhoma Fizike e të Dhënave, e cila ka qenë e vendosur në distribucionin e KEK-ut dhe Dhoma Virtuale e të Dhënave, e cila është përgatitur nga KEK-u dhe është menaxhuar nga ICO-ja.

Këto dy dhoma të informacioneve u kanë dhënë informata të nevojshme të gjithë aktorëve dhe njëkohësisht u kanë mundësuar që qasje të barabartë të kenë të gjithë ata aktorë, por edhe palët e interesuara në Republikën e Kosovës.

Në bazë të rregullave të ofertimit dhe të protokollit, të ofertimit, KQP ka emëruar dy komisione dhe ai është Komisioni për pranim dhe hapjen e ofertave dhe Komisionin për vlerësim të ofertave, me nga një përfaqësues nga secila ministri, anëtarë të komitetit dhe në cilësinë e vëzhguesve në dy komisione janë emëruar edhe përfaqësues të USAID-it, "Deloitte", ICO-s dhe normalisht edhe KEK-u, KOST-i dhe Zyra për Rregullator.

Janë bërë vlerësime teknike të ofertave dhe pas vlerësimit të ofertave teknike është vazhduar me procedimin dhe autorizimin e hapjeve të ofertës financiare. Dua t'ju bëj me dije se kriteri i vetëm në këtë proces ka qenë përcaktimi i çmimit dhe çmimi ka qenë kriteri themelor pas analizimit të ofertave dhe mundësisë teknike.

Hapja e ofertave është bërë në një seancë të veçantë publike, ku kanë qenë të përfaqësuar dhe të ftuar për përfaqësim të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile, komiteti i biznesit, përfaqësuesit diplomatikë dhe është bërë në mënyrë publike ku kanë qenë pothuajse një prezencë jashtëzakonisht e madhe, me një transparencë maksimale.

Dy oferta, të cilat i kemi marrë, janë konsorciumi "Çalik & Limak" dhe kompania "El Sewedy", në shumën prej 26.3 milionë dhe në shumën prej 22.8 milionë. Dhe, normalisht, në propozim të KQP-së, në bazë të rregullave të ekonomisë së tregut, në bazë të rregullave ndërkombëtare, vendimi i KQP-së është shqyrtuar në mbledhjen e Qeverisë dhe është marrë vendim për shpalljen e konsorciumit "Çalik & Limak", me ofertë prej 26,3 milionë, fitues i preferuar në procesin e privatizimit të Distribucionit.

Edhe një herë, dua të ndalem pak te transparenca, e cila është zhvilluar sipas standardeve më të larta dhe në bazë të Ligjit për qasje në dokumentet publike. Më lejoni t'ju them se përfaqësues nga Federata e Sindikatave në sektorin i cili po privatizohet, kanë pasur takime të shumta me Komisionin, por edhe me mua si ministër dhe janë të informuar në mënyrë të detajuar për rrjedhën e procesit të privatizimit. Bile, së voni kemi nënshkruar edhe një komunikatë të përbashkët ku realisht Sindikata e Distribucionit e ka përkrahur këtë proces.

Edhe një herë po them se secili qytetar apo i interesuar në proces, ka mund të ketë qasje në informatat bazë dhe rrjedhat e privatizimit gjatë gjithë procesit, përmes Dhomës së Informimit Publik. Kjo dhomë është vizituar jo vetëm në herë, por nga shumë pjesëtarë të shoqërisë civile, individë të ndryshëm, profesionistë të sektorit të energjisë, punëtorë të KEK-ut, zyrtarë nga misionet ndërkombëtare, përfaqësues të mediave vendore dhe atyre ndërkombëtare dhe sidomos në mënyrë të rregullt është vizituar nga Sindikata e Distribucionit të Furnizimit të KEK-ut.

Normalisht se kemi pasur raste edhe kur kemi pasur ankesa nga shoqëria civile, lidhur me transparencën dhe ne nganjëherë nuk kemi mundur që këto t'i trajtojmë me objektivitet të plotë, për shkak se në këto raste, shoqëria civile ka kërkuar që të jetë pjesë e vendimmarrjes dhe jo, do të thotë, të jetë e njoftuar për procesin dhe normalisht në bazë të Kushtetutës dhe rregullave normale në çfarëdo shteti demokratik, shoqëria civile mund të merr pjesë në debate, në diskutime, por jo edhe në vendimmarrje, sepse është një proces i rregullimit të vendimmarrjes.

Zyrtarët e Qeverisë dhe këshilltarët e angazhuar në proces të privatizimit kanë marrë pjesë në secilin debat publik, të ftuar lidhur me çështjet energjetike, ashtu edhe në debate mediatike dhe asnjëherë nuk ka munguar prezenca e tyre vetëm e vetëm për t'i ofruar publikut transparencë dhe informim të drejtë për procesin e privatizimit.

Ky proces i privatizimit duhet të kuptohet që Qeveria, në këtë rast, Komisioni ministror nuk ka pasur mandat për të diskutuar për çmimin, por Zyra e Rregullatorit është ajo e cila ka krijuar bazën rregullative në bazë të autorizimeve që ka nga ky vend dhe në këtë drejtim dua t'ju njoftoj se baza rregullative është në bazë të Ligjit për energji, Ligjit për energji elektrike dhe Ligjit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, prandaj Kompania e Distribucionit sot i ka dy licenca, ajo është për furnizim të publikut dhe licenca për distribuim. Për derisa distribuimi është monopol natyror, pjesa e furnizimit është monopol ligjor dhe në bazë të obligimeve ndaj Traktatit të energjisë, ky proces do të liberalizohet në vitin 2015 dhe në bazë të ligjeve këta sektorë janë të rregulluar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë të caktojnë tarifa dhe nivelin e të hyrave nga të gjitha këto aktivitete.

Prandaj, si pjesë e caktimit të hyrave të lejuara, Zyra e Rregullatorit përcakton nivelin e investimeve që lejohen, shpenzimet operative ku përfshihen edhe niveli dhe pagat e punëtorëve.

Nga aspekti rregullativ, nëpërmjet privatizimit është bërë ndërrimi i pronarit të aksioneve dhe me qëllim të harmonizimit me ligjet e energjisë, Zyra e Rregullatorit përgjatë procesit ka përgatitur rregullat e përcaktimit të hyrave të lejuara të cilat, në fjalë më të thjeshta, e përcaktojnë sa mund të fitojë një kompani private në një periudhë të caktuar. Njëkohësisht, deri më tani tarifat kanë qenë të caktuara njëvjeçare dhe me vendim të Zyrës së Rregullatorit tani do të përcaktohen me tarifa pesëvjeçare. Rregullat përcaktojnë kthimin e investimit dhe ekuititetin, i cili i lejohet investitorit.

Investitori, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, nuk mund të krijojë fitime më shumë që lejohet nga Zyra e Rregullatorit e cila, po e përsëris edhe një herë, kontrollohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Sikurse Zyra e Rregullatorit të lejonte nivel më të lartë të fitimit në investim, edhe çmimi i shitjes sigurisht se do të ishte tjetër, prandaj nuk janë korrekte krahasimet të cilat bëhen me shtetet tjera, sepse nuk kanë rregullativë të njëjtë dhe ne, mund të them me kompetencë të plotë, kemi analizuar shumë mirë të gjitha transaksionet në rajon dhe jam me plot bindje të them sot këtu para jush dhe qytetarëve se kemi bërë një transaksion që në aspektin afatgjatë nuk merr obligime shtetërore sikurse ka ndodhur edhe në raste të cilat u përmendën më herët, por edhe në rastin që është përmendur shumë shpesh nëpër media në Shqipëri, ku bëhen krahasime vetëm verbale të numrave, por jo edhe të kontratave, jo edhe të numrit të konsumatorëve.

Dua të them që Rregullatori dhe Qeveria kanë bashkëpunuar në mënyrë që të kemi edhe obligime të theksuara në raport me investitorin për gjashtë vjetët e ardhshme për t'i reduktuar humbjet. Në bazë të vendimit të Zyrës për Rregullator, në tri vjetët e para obligimi është që të kemi reduktim të humbjeve 3% në vit, ndërsa në tri vjetët e ardhshme tjera, 2.5% në vit.

Dhe, ajo çka është jashtëzakonisht e rëndësishme, kompania ka kërkuar nga Zyra e Rregullatorit dhe Rregullatori ka vendosur që në rast se kompania private nuk i arrin këto obligime, asnjë kosto nuk do të bartet nga qytetari, nga Qeveria, por në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kompania private.

Lidhur me obligimet dhe kontratën e cila tani është në proces të diskutimit, Komisioni qeveritar ka qenë i siguarur që të mbrohet interesi publik dhe ky privatizim do të jetë një reformë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe dy minuta, që ta përmbyllni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Kompania edhe më tutje do të punësojë qytetarët e Republikës së Kosovës, përkundër shumë trumbetimeve se nuk do të ketë kontrata, është e obliguar në bazë të kontratës në të cilën do të hyjë, që kontratat e punëtorëve të vazhdojnë për 3 vjet edhe për ato kontrata të cilat kanë qenë afatshkurtra.

Një dallim jashtëzakonisht i madh me të gjitha privatizimet në rajon është se Qeveria dhe Komisioni qeveritar ka marrë një sërë vendimesh dhe ato janë që asetet 110-she, të mos privatizohen, të cilat deri më tani kanë qenë pjesë e Distribucionit, ne i kemi transferuar këto në KOST, për interesa strategjike shtetërore dhe të gjitha privatizimet të cilat ju po i referoheni, të nderuar, i kanë të privatizuar asetet 110-she. Asnjë borxh i vjetër nuk është falur sikurse në shumicën e vendeve të rajonit që ka pasur falje të borxheve të vjetra apo transferim të drejtës së borxheve të vjetra te kompania e privatizuar, por e kemi ruajtur të drejtën që KEK-u do të jetë pronar i këtyre borxheve dhe KEK-u do ta autorizojë me kontratë komerciale mbledhjen e këtyre mjeteve. Asnjë lloj garancie shtetërore nuk e

kemi dhënë, as garanci shtetërore në rast se ndërmarrja do të dështojë. Ne kemi krijuar bazë që Qeveria të hyjë dhe të marrë pronësinë e ndërmarrjes nëse investitori nuk do t'i plotësojë kushtet e kontratës për investime. Janë paraparë investime mbi 200 milionë euro, të cilat janë kontribut i drejtpërdrejt për përmirësimin e infrastrukturës në Distribucion dhe Furnizim me energji elektrike. Dhe, po e them edhe një herë, i tërë ky proces është proces i cili i ka involvuar të gjitha palët e interesit, komunitetin ndërkombëtar, është në harmoni të plotë me bazën legjislative, është në harmoni të plotë me ekonominë e tregut, është në harmoni të plotë me strategjinë e energjisë së Kosovës. Vlera është përcaktuar në bazë të Rregullatorit dhe në bazë të tregut...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Partisë Demokratike të Kosovës të shpreh qëndrimin lidhur me interpelancën ministrit për çështjen e privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit të energjisë.

Fillimisht më lejoni, zoti ministër, t'ju falënderoj për prezantimin tuaj dhe sidomos shpjegimet me këtë rast shtesë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ristrukturimin e sektorit të energjisë e që ne mendojmë që janë në fakt një reformë më e thellë në krejt sektorin e që është në përputhje me strategjinë që kohë më parë ne e kemi aprovuar këtu në Kuvend. Dëshirojmë që ky fillim të jetë i mbarë në gjithë procesin e reformave që duhet t'i bëjë Qeveria në përputhje me strategjinë e miratuar në sektorin e energjisë dhe jo vetëm në sektorin e energjisë.

Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës në periudhën 2009-2018. Strategjia e energjisë konfirmon se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për privatizimin e Distribuimit të KEK-ut e që është duke u kryer përmes privatizimit të Kompanisë Kosovare të Distribuimit dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike.

Arsyeja që Kuvendi i Kosovës e ka përfshirë privatizimin e Distribuimit në strategjinë e energjisë dhe ka marrë vendimin e Kuvendit, është se Kuvendi është i vetëdijshëm për rëndësinë që një sistem eficient i energjisë elektrike ka për mirëqenien ekonomike të vendit tonë. Reduktimi substancial i humbjeve komerciale dhe teknike të energjisë elektrike, është arsyeja primare për privatizimin e Kompanisë Kosovare të Distribuicionit dhe Furnizimit të Energjisë.

Vitin e kaluar 37% e gjithë energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë, apo të importuar, ka humbur si pasojë e humbjeve teknike dhe komerciale. Është nevojë jetike për reduktim të shpejtë të këtyre humbjeve, në mënyrë që tarifat për konsumatorët fundorë të mos jenë të ngarkuar me këto humbje, të cilat paraqesin kosto të panevojshme në sistemin e

energjisë elektrike në Kosovë dhe e ngarkojnë rrjedhimisht konsumatorin me kualitet të dobët të shërbimit.

Investitori i Kompanisë së Distribucionit do të jetë i obliguar t'i reduktojë këto humbje teknike dhe komerciale. Humbjet komerciale që rezultojnë nga vjedhja e energjisë, do të reduktohen në menaxhimin më të mirë, që është i nxitur për t'i reduktuar këto humbje dhe humbjet teknike që rezultojnë prej një sistemi të shpërndarjes së tej ngarkuar, do të reduktohen duke investuar në një sistem - në sistemin e distribucionit.

Buxheti i Kosovës nuk ka mundësi financiare që të investojë. Në strukturën e privatizimit të Kompanisë Kosovare të Distribucionit dhe Furnizimit të Energjisë, rreziku i reduktimit të humbjeve teknike dhe komerciale i është lënë vetë investitorit.

Përpos reduktimeve të humbjeve komerciale dhe teknike, investitori do të jetë i nxitur të rritë inkasimin e energjisë elektrike të faturuar. Edhe pse Kuvendi është i vetëdijshëm që niveli i inkasimit të energjisë elektrike të faturuar është përmirësuar, niveli i humbjeve nga mos inkasimi është ende i lartë, me 10% nga energjia e faturuar, dhe ende 10% nga energjia e faturuar mbetet e painkasuar.

Sipas strukturës së privatizimit, risku për mosinkasim të energjisë elektrike të faturuar mbetet me investitorin e Distribucionit.

Divizionet e distribuimit të furnizimit të kompanisë kosovare për Distribuim dhe Furnizim do të bëhen më eficient si rezultat i reduktimeve në humbjet komerciale e teknike dhe nga përmirësimi i nivelit të inkasimeve. Ky përmirësim do të duhej të rezultojë po ashtu me përmirësimin e gjendjes financiare të vetë kompanisë.

Përmirësimi i gjendjes financiare është shumë e rëndësishme për përmbushjen e kërkesave për siguri të furnizimit me energji elektrike, pra ashtu siç parashihet në strategjinë e energjisë.

Bazuar në këtë strategji, ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese është prioritet kryesor dhe domosdoshmëri për siguri dhe furnizim me energji elektrike në të ardhmen në Kosovë. Ky proces është duke u implementuar nëpërmjet projektit "Kosova e Re" dhe investimeve në energjinë e ripërtërishme.

Investitorët potencialë në gjenerimin e energjisë elektrike do të investojnë vetëm nëse janë të sigurt që energjia elektrike që prodhojnë do të paguhet, pasi që ata do të nënshkruajnë kontratë me kompaninë për shitje të energjisë së prodhuar, ata do të sigurohen po ashtu se kjo kompani ka mundësi për të paguar energjinë e shitur.

Distribucioni do të jetë në gjendje shumë më të mirë për të paguar dhe kështu të mbështesë përfundimin e suksesshëm të projektit "Kosova e Re" dhe të investimeve në energjinë e ripërtërishme, si rezultat i reduktimit të humbjeve komerciale dhe teknike dhe përmirësimeve në nivelin e inkasimit të energjisë së faturuar që do të rezultojë me privatizimin e kësaj kompanie.

Procesi i udhëhequr nga Qeveria e Kosovës me ndihmën e këshilltarit të transaksionit, si pjesë e Bankës Botërore, të angazhuar nga USAID, ashtu sikur që u përmend nga ministri, dhe të gjitha institucioneve tjera në sektorin e energjisë, Rregullatori i Energjisë, KEK-u, KOST-i, për ne duket një proces që është transparent dhe ka për qëllim sigurimin e përfitimeve afatgjate. Ky proces po ashtu ka marrë lëvdata edhe nga institucionet ndërkombëtare për profesionalizëm, transparencë dhe trajtim të barabartë.

Fokusi në këtë proces nuk ka qenë vetëm në sigurimin e një çmimi sa më të lartë, fokusi ka qenë po ashtu në tërheqjen e investitorëve që do të modernizojnë sistemin e distribucionit të furnizimit nëpërmjet investimeve të menaxhimit më efikas, si dhe eliminimit të ekspozimit të buxhetit të Kosovës ndaj këtij sektori.

Qeveria e Kosovës nuk ka ofruar garanci shtetërore dhe nuk ka ofruar subvencione për kompaninë private. Njëkohësisht është ruajtur interesi shtetëror duke garantuar punësimin për tri vjet, asetet 110 kilovatë, ashtu siç shpjegoi ministri dhe mbajtjen e pronësisë në borxhet e vjetra.

Duke marrë parasysh rolin të cilin e ka Zyra e Rregullatorit të Energjisë për caktimin e të hyrave të kompanisë së privatizuar nga ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i mëtejshëm i këtij institucioni, ne shpresojmë se do të mbetet një nga prioritetet për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit të energjisë.

Po ashtu, zoti ministër, shfrytëzoj rastin që në emër të Grupit ne t'ju inkurajojmë ju që së shpejti, po ashtu të shikoni mundësinë edhe të rishikimit të strategjisë për energjinë, të pasurohet kjo strategji, duke pasur parasysh po ashtu edhe kapacitetet, rrethanat e reja, teknologjitë e reja në botë, në mënyrë që të shikohet mundësia e shfrytëzimit sa më të mirë, sa më efikas dhe sa më të madh të gjitha kapaciteteve që ka vendi ynë për shfrytëzimin edhe të energjisë së ripërtërishme, por edhe energjinë që vjen nga shfrytëzimi i pasurive që i ka vendi ynë.

Po ashtu duke qenë që jemi në fillim të këtij procesi, pa dëshiruar që ta gjykojmë përfundimisht këtë proces, ne inkurajojmë Qeverinë dhe investitorin dhe po ashtu edhe gjithë investitorët tjerë që në vendin tonë të jenë më të sigurt për shkak se po bëhen reforma në sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht i inkurajojmë të gjithë investitorët për investime të reja në Kosovë.

Bazuar në programin e arritur në këtë proces të privatizimit, përfundimisht Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, shpreh mbështetjen e plotë ndaj Qeverisë për përmbylljen e suksesshme të këtij procesi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kush e do fjalën? Fjalën e ka Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: I nderuar kryesues,

Qeveri,

Të nderuar deputetë,

Kur flitet për Distribucionin e energjisë, mendohet për një pasuri të shtetit, komplet infrastrukturën e ndërtuar për gjenerata e vite. Mendohet për një pasuri kombëtare, e cila

përmban prona të shumta si toka, trafostacione, pajisje, kapacitete njerëzore, makineri të shumta, kablllo që shtrihen në çdo kënd të Kosovës.

Në vazhdim janë vetëm disa të dhëna që Distribucioni i ka në pronësi. Në rrjetin 35 kilovoltë, i ka 675 kilometra, në rrjetin 10 – 20 kilovoltë, gjatësia është 445 kilometra, në rrjetin 10 kilovoltë, kemi gjatësi 5.863 kilometra, në 6 kilovoltë, 46, ndërsa në rrjetin 0,4 kilovoltë, gjatësia është 11.870 kilometra. Të kujt janë këto prona, janë të KEK-ut, apo janë të Distribucionit?

Ky divizion ka në pronësi prej 6.200 trafostacioneve, të cilat janë në tërë rrjetin, ka një numër shumë të madh të trafostacioneve, deri në 10, 20 që transformohet në 0,4 kilovoltë.

Kjo strukturë mirëmban një rrjet të shtrirë në tërë Kosovën me 400.000 konsumatorë, të ndarë në grupe tarifore deri në nivelin 0,4 kilovoltë. Distribucioni dhe Furnizimi përbëhen nga njësitë regjionale: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj dhe Gjilan.

Në anën tjetër, kur flitet për Distribucionin, flitet për një monopol të pakontestuar. Me privatizimin e Distribucionit, ky monopol do të jetë në pronësi të një ndërmarrjeje, e cila do të duhej të lejonte shpërndarjen e energjisë elektrike, jo vetëm të prodhuar nga ajo vetë, pasi i ka të dyja licencat, edhe për furnizim edhe për distribucion, por edhe nga operatorët tjerë, do të duhej të jetë në gjendje t'u siguronte kushte të barabarta sikur vetes. A është kjo e paraparë në gjithë këtë proces?

Vendimi për shitjen e këtij aseti shtetëror për vetëm 26,3 milionë euro, më së paku që mund të themi është nënçmues, është jashtë logjikës së shëndoshë ekonomike.

Pasi ofertuesi menjëherë merr 400.000 konsumatorë, 400.000 blerës të sigurt, tregun e sigurt, asetet e sigurta, pse nuk ka pasur ndonjë çmim minimal të bazuar në vlerësimin e pasurisë së Distribucionit? Në rajon distribucionet janë shitur përmbi dhjetëfishin e çmimit të ofruar në Kosovë dhe atë jo qind për qind të aksioneve, por këto shtete në fakt funksionojnë me të vërtetë si duhet dhe para vetes e kanë si prioritet zhvillimin ekonomik dhe interesin e shtetit dhe të qytetarit.

Shtrenjtimi i rrymës, të cilin e ka kërkuar përmes Qeverisë dhe KEK-ut në ZRRE, a ishte kërkesë për kompensim të subvencioneve, a është pjesë e obligimeve të cilat janë marrë nga Qeveria për t'i ndihmuar ofertuesit?

Nga përvoja e rajonit, pas privatizimit të distribucioneve, ka pasur ngritje jo të vogël të energjisë elektrike. A do të thotë kjo që së shpejti do të kemi edhe ngritje tjera të energjisë?

E gjithë kjo kërkon prej nesh që të jemi me të vërtetë të vëmendshëm në procesin e privatizimit, pasi pasojat janë afatgjate dhe shpresojmë që të mos jenë pasoja të dëmshme.

Sa i përket transparencës, ministri fjalën më së shumti që e përmendi, ishte transparenca, por procesi i privatizimit të Distribucionit prej fillimit nuk ishte i mbuluar me transparencë, por me mungesë të transparencës. Në termat e referencës, në obligimet të cilat i merr blerësi, në subjektin e kontratës, në bashkimin e dy subjekteve konkurruese, në konsorcium dhe në një abstinencë të subjektit të tretë, LSVD elektrik nga të drejtat e tij për informim, për dërgim të ekspertëve dhe prej interesimeve tjera.

Nuk e kemi të qartë se çfarë obligime dhe investime do të bëjë kandidati për privatizimin e Distribucionit, a janë të përfshirë, shpresojmë dhe njehsorët elektrikë, komandimi automatik, qasja edhe shumë të tjera?

Sot prej ministrit dëgjuam shumë gjëra, po mendoj që e gjithë kjo do të duhej që të përcillet jo vetëm me bisedë këtu, por edhe me dokumente të cilat do të duhej të ishin në Kuvend më herët.

A është pjesë e tenderit, pjesa veriore e Kosovës, e cila sot nuk menaxhohet nga sistemi energjetik i Kosovës? Si do të menaxhohen subvencionet për familje që janë me asistencë sociale? Të gjitha këto japin mesazhe se në këtë proces ka shumë gjëra të cilat jo rastësisht janë mbajtur nën hije dhe nuk i janë servuar publikut dhe institucioneve. Dhe, pikërisht mungesa e transparencës jep indikacione se vazhdon mënyra e njohur e funksionimit të Qeverisë e cila kritikohet në çdo Raport të Progresit.

LDK, si parti e qendrës së djathtë, përkrah privatizimin si koncept, por privatizimin si proces transparent, të planifikuar mirë në dobi të qytetarit dhe shtetit të Kosovës, si proces i cili nuk krijon monopole, por krijon hapësirë për konkurrencë të shëndoshë dhe treg të lirë.

Distribucioni i sistemit energjetik të Kosovës, paraqet një pasuri kombëtare dhe kërkon trajtim adekuat në çdo instancë. Duke pasur parasysh se ky proces prej fillimit ishte i mbuluar me mungesë të transparencës, kërkojmë që para vazhdimit të kërkohet, si vijon, do të thotë ky është mocion për votim.

1. Kërkojmë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të sjellë në Kuvend kopjen e kontratës në Kuvend, ose së paku në Komisionin Funkcional.
2. Vlerësimin e pronave të Distribucionit, tokat, ndërtesat, trafostacionet dhe pronat tjera.
3. Shtrirjen e linjave, vlerësimin teknik dhe financiar.
4. Investimet që prej vitit 2000 deri më sot janë bërë në rrjetin e Distribucionit.
5. Vlerën e borxheve të vjetra dhe planin e menaxhimit.

Dëgjuam prej ministrit sot që foli, por do të kishte qenë mirë që këto të jenë të shkruara dhe të dërguara në Kuvend.

- Planin e veprimit, të investimeve nga ana e ofertuesit, menaxhimin me resurse njerëzore, me punëtorë e tjera.

- Mundësinë e hapjes për operatorë të rinj, për furnitorë të rinj të energjisë që është planifikuar ashtu si dëgjuam për vitin 2015.

- Përgjigjen se a është veriu i Kosovës pjesë e tenderit dhe si do të menaxhohet ajo pjesë? Cila do të jetë politika sociale dhe a do të ketë subvencione për këtë?

- Kërkojmë që të silllet raporti i këshilltarit të transaksionit.

-Pas shqyrtimit të dokumentacionit që do të silllet, Kuvendi i Kosovës mund të marrë qëndrim për përkrahjen e privatizimit të Distribucionit, ose të kërkojë rishqyrtimin e tij.

Tekstin e mocionit tash do t'ua shpërndajmë edhe deputetëve të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zoti Krasniqi e ka fjalën.

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit!

Gjithë privatizimit në Kosovë nuk i janë dhënë përgjigjet e duhura në pyetjet që i bëhen në çdo shitje. Çka do të shitet, kur do të shitet, pse do të shitet, si do të shitet, sa do të shitet dhe kujt do t'i shitet?

Në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", do të përpiqem t'i jap disa përgjigje, ose të shtroj më shumë pyetje për këtë proces.

Këtu po flasim për shitjen e Distribucionit të KEK-ut. Kur do të shitet ky distribucion, pse ky distribucion nuk u shit kur merrte më shumë se 10 e nganjëherë edhe 20% të buxhetit të Kosovës dhe e absorbonte? Pse tash po shitet, pse bash tash kur KEK-u po pavarësohet ekonomikisht?

A mos është ky një obligim i Qeverisë tonë ndaj Qeverisë turke për ndërhyrjen në zgjedhjet e kaluara? A mos është ky një premtim që Qeveria jonë ia ka bërë Qeverisë turke gjatë fushatës zgjedhore që ajo pruri autobusë e aeroplanë për mbështetjen e militantëve të Partisë Demokratike? Deri kur do të paguajmë ne për këtë premtim? Autostradën tri herë më shtrenjtë, ia falëm Aeroportin, po ia falim edhe Distribucionin.

Çka tjetër i kemi borxh? Pse po privatizohet ky aset? Kujt po i pengon aseti publik? Në qoftë se aseti publik po ecë në këmbë të veta, pse nuk detyrohen pagesit e energjisë ta paguajnë energjinë? Pse nuk dënohen keqbërësit, pse nuk dënohen ata që e vjedhin energjinë? Për çka ky proces në këtë kohë, si do të shitet, pse në këtë mënyrë? Pse ne nuk mësuam prej përvojës së mirë të Malit të Zi, por mësuam prej përvojës së keqe të Shqipërisë?

A është e vërtetë se ne gjithmonë po e paguajmë faturën për rajonin, edhe ekonomikisht, shqiptarët në përgjithësi? Pse të gjitha asetet tona u shitën më pak se vetëm një fabrikë e autopjesëve në Serbi? Pse? Në këto pyetje nuk ka përgjigje.

Sa ka vlerë kjo kompani? Ministri nuk na e tha sa ka vlerë. Disa vlera të përafërta. Patundshmëria e kësaj kompanie, ne të gjithë e dimë dhe qytetarët e Kosovës e dinë, se të gjitha objektet e KEK-ut janë në qendra të qytetit.

Unë mendoj se patundshmëria e kësaj kompanie, me bindje të plotë e me konsultim me ekspertë, i ka 150 milionë patundshmëri.

Një fakt tjetër, sikur kjo kompani do të shitej për bakrin, aluminin, çelikun e metale tjera, i ka vlerë 50 milionë euro, e ne po e shesim për 26 milionë euro, pak më shumë.

Ministri përmendi inkorporimin në këtë proces të shoqërisë civile dhe të ekspertëve. Unë e kam përcjellë me vëmendje këtë proces.

Me përjashtim të militantëve të partisë dhe të grupeve të interesit, asnjë ekspert i mirëfilltë e asnjë prej shoqërisë civile nuk e ka përkrahur këtë proces, as vetëm një. Këtu bëjnë dallim prapë militantët partiakë dhe ata grupet e interesit.

Po pse po i shitet “Limak & Çalikut”? Pse mu këtyre? Unë e kam ngrehur këtë çështje, në një rën prej pikave jashtë rendit të ditës, dhe iu kam thënë një gjë. Një aset kombëtar, që kushton më shumë se 300 milionë euro, do të shitet për më pak se 30 milionë euro.

Unë ju këqyri në sy juve, i këqyri në sy qytetarët e Kosovës, e ju them, një gjë mbajeni në mend. Sot pesë vjet, qytetarët e Kosovës, votuesit tuaj, kanë për të paguar 200% të rrymës. Mbajeni mend, 200% të rrymës. E prapë do të ketë militantë partiakë, e gjysmë të verbër që kanë për të dalë e të thënë - këtë e bëjmë për zhvillimin ekonomik, këtë e bëjmë për të mirën e vendit. Kjo nuk është për të mirën e vendit.

Andaj, unë, në emër të Grupit “Vetëvendosje”, në emër të qytetarëve që na kanë votuar dhe prur këtu, e ftoj firmën “Limak & Çalik” që të tërhiqet menjëherë nga ky tenderim, nga ky plan, ky proces që është ilegal dhe kriminal. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ministër,

Mendoj se edhe pa hyrë fare në detaje, të cilat i kemi marrë, mostransparenca është shkelje e Kushtetutës dhe e ligjit. Dhe, këtu mund kushdo e çkado të na thotë se procesi ka qenë transparent, por nuk ka qenë transparent ndaj Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës.

Çka na intereson neve, ndaj cilave agjenci ndërkombëtare ka qenë transparent procesi. Çka duhet të na interesojë neve cilat janë agjenci mbështetëse të Qeverisë, të cilat e kanë ditur çka po ndodh, kur Kuvendi nuk e ka ditur, populli nuk e ka ditur?

Edhe vetëm nëse një detaj i fshehur prej Kuvendit, sado i vogël, procesi është krejt jotransparent. Domethënë, një transparencë, e vetëm një mostransparençë, për vetëm një

detaj, e bën krejt procesin jo transparent, e lëre më që ne kemi shumë pyetje këtu të cilat nuk i dimë, e unë do t'ua referohem disa pyetjeve. Por, fillimisht dua të ju them se Aleanca mendon se Qeveria nuk duhet të udhëheqë me biznese. Kjo është logjikë e djathtë. Ne mendojmë se bizneset duhet të udhëhiqen nga njerëz të biznesit, Qeveria duhet të udhëheqë me politika, Qeveria duhet të udhëheqë përmes Kuvendit me rregullatorë e çështje tjera të cilat i dimë, domethënë edhe nuk kam nevojë t'ua shpjegoj se çka mendojmë në aspektin e djathtë, por po, mendojmë se privatizimi është proces i cili duhet të ndodhë në Kosovë. Po u tha këtu më përpara, jo kështu.

Unë mendoj se është gati fyese, skandaloze, domethënë, Kuvendi i Kosovës të mos ketë ide çka po ndodh me asetet publike? Shihni çka ka ndodhur me Aeroportin. Çka dimë ne çka ka në kontratë për komercializimin e Aeroportit? Çka di Kuvendi? Ndoshta ka individë që dinë, përmes lidhjeve tjera, por jo për shkak se janë përfaqësues të popullit të Kosovës. Nuk e dimë. Nuk e dimë ne çfarë klauzolash ka në kontratë për Aeroportin, shembull ta marrim, po e bëj një ... në bisedë kështu, vetëm sa për ta shpjeguar dhe tani prapë ne nuk e dimë çka po përgatitet në kontratë, meqenëse ata që ofertojnë e kanë një ide të parakontratës, nuk e bëjnë një ofertë pa pasur fare ide se çka ka të ndodhë në fund me kontratën. Domethënë, Qeveria e di çka ka në kontratë. Kompania e cila e ka fituar, ose e cila është përzgjedhur si fitues potencial i këtij procesi të privatizimit të Distribuimit, edhe ata e dinë çka ka në kontratë, ne nuk e dimë. Lidhje s'kemi.

Tani, këtu u përmendën disa çështje prej ministrit dhe njëres prej tyre do t'i rikthehem shumë shpejt, është margaritar, shembull ta marrim, e cila nga ana e ministrit u prezantua si diçka pozitive. Por, fundi i fundit do ta vërtetoj atë që u tha nga parafolësi, se çmimi do të rritet diku 200% për një kohë shumë të shkurtër.

Shihni, që shumë vite, Qeveria e Kosovës nuk ka folur aq shumë për humbje teknike dhe komerciale, tash po flet. Po çka i intereson Qeverisë tash cilat janë humbjet teknike dhe komerciale? Duhet t'i interesojë atij që e blen. Punë e tij është, nuk është punë e Qeverisë më. E ka shitur këtë biznes.

Shembull ta marrim, në momentin kur shitet. Pse është prioritet i Qeverisë tash Qeveria të merret me humbjet teknike dhe komerciale, kur biznesin e ka lëshuar prej duarve të veta? Çfarë logjike ka? E deri tash nuk është marrë me këtë punë, u tha edhe më përpara këtu.

Po thotë që nuk është falur asnjë borxh, nuk do të falet, krejt në rregull. KEK-u do t'i inkasojë borxhet në emër të Qeverisë së Kosovës, shembull ta marrim, për shembull edhe do ta angazhojë kompaninë e re, e cila e blen distribuicionin, që domethënë se ajo kompani kryen një shërbim KEK-ut edhe kompanitë private nuk i bëjnë shërbimet falas. Domethënë, ne efektivisht, borxhin nuk e ka blerë KEK-u, borxhin, efektivisht, me profit të atij borxhi po e blen kompania e re.

Pse po na thonë që KEK-u e ka blerë? KEK-u e ka marrë përsipër të jetë përgjegjës për atë borxh, por nuk e ka blerë borxhin efektivisht.

Një çështje tjetër, që u përmend këtu, edhe atje do të kthehem te katër pika interesante, nuk do të ju mbaj shumë gjatë, është garanca e profitit, u përmend nga ministri. Domethënë, Rregullatori e garanton profitin e kompanisë dhe në dukje të parë kjo thotë se Rregullatori është në rregull, se nuk e len kompaninë të bëjë shumë profit, që do të thotë në njëfarë forme ndoshta edhe e cakton njëfarë kulmi të çmimit. Por shihni, profiti është diferenca në mes të çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes. Kurrkush nuk e garanton, kurrfarë rregullatori nuk e garanton çmimin e blerjes. Nuk ka rregullator, që ia cakton koston KEK-ut, ose ndonjë kompanie jashtë Kosovës, që domethënë ata e rrisin çmimin barabarësisht me, siç thonë ata, koston e gjenerimit. Tani, nëse kostoja e gjenerimit rritet, e atë ne nuk e kontrollojmë, koston e gjenerimit nuk e kontrollojnë Rregullatori, as çmimin e blerjes prej Bullgarisë ose Serbisë, ose kujtdo qoftë. Këta garantojnë profitin, por nëse rritet kostoja e gjenerimit, ose kostoja e blerjes, se këta kanë licencë edhe për furnizim, domethënë për blerje, domethënë çmimi do të rritet, se këta duhen t'ia garantojnë profitin. Domethënë, Rregullatori do të jetë i detyruar t'i rritë çmimet e energjisë në vazhdimësi, domethënë çmimet disa herë, për shkak se duhet t'ia garantojë profitin kompanisë së re, që është në kushte logjike krejt në rregull.

Tani, kjo është pyetja e dytë imja, por po e ndërlihdh, a i nënshtrohet kompania 100% ekonomisë së tregut, ligjeve të ekonomisë së tregut?

A duhen këta, shembull ta marrim, të blejnë energji vetëm në KEK, apo nëse e shet më lirë Bullgaria, të thotë unë e kam profitin më të madh ta blejë në Bullgari edhe t'ia thotë KEK-ut, prodho sa të duash, po s'kam çka të bëjë, shembull ta marrim?

Ne nuk e dimë çka ka në këtë kontratë, A është kjo pjesë ose a është ky element i kontratës?

Çështje tjetër, këtu u përmend nga ministri, klauzola e nacionalizimit. Tani, pse po flas për nacionalizim? Kur shitet një aset publik monopol, se ne nuk i kemi dy rrjete të furnizimit të distribuimit, atëherë kompania që e ka blerë, nuk duhet te ketë të drejtë t'ia shesë dikujt të tretë atë biznes. Domethënë, kjo rregullohet, këto çështje janë të rregulluara. Nuk mundet ai sot ta blejë dhe nesër ta shesë nja 50 milionë më shtrenjtë, se s'guxon të bëjë ashtu. Tash, nëse nuk guxon ta shesë, çka bën Kosova nëse kompania nuk i kryen shërbimet me rregull, ose nëse bankroton, shembull ta marrim, shkon mbyllet, s'ekziston më, humb- ajo kompani komerciale? A ka të drejtë ta nacionalizojë Qeveria e Kosovës? Gjithsesi se duhet të ketë. Po, nëse ka, çfarë klauzole ka? Sa na kushton neve nacionalizimi? A mund të ndodhë, shembull ta marrim, që në klauzolë të nacionalizimit thotë: e kemi ble për 26.3 milionë euro, po nëse doni me na e marrë, se na nuk e kryem punën mirë, duam të na paguani 400 milionë euro, shembull ta marrim? Ne nuk e dimë, po ka edhe këso klauzola.

Çështje e tretë është garanca e pagesës, u përmend këtu. Çka garanton Qeveria e Kosovës, nëse gjyqet nuk punojnë, nëse njerëzit i qesin çengelat nëpër kablllo, qysh i qesin edhe sot, cila o garanca, çka garanton Qeveria, cilat janë obligimet e Qeverisë? Ne nuk e dimë! E këto duhet të jenë pjesë e kontratës.

Dhe, në fund, po flas pak për çmimin. U tha më përpara, unë veç desha t' ju them se vlera e metalit të shkrirë të aseteve të Distribuimit është dy herë më e madhe se vlera me të cilën po shitet ndërmarrja publike. Nuk e rregullon vetëm ekonomia e tregut këtë çështje, nuk e rregullon vetëm tregu i lirë këtë çështje. Është skandaloze!

Nuk po flas për pronat e paluajtshme, për të cilat ne ende nuk e dimë cilat shiten, se ne nuk e dimë as çka po shesim, Kuvendi nuk e din çka po shet. Mund të them që Aleanca nuk mund ta mbështetë këtë proces.

Do të bëjmë çmos ta pengojmë këtë proces, është i dëmshëm për Kosovën, është jashtëzakonisht i dëmshëm për Kosovën. Do të provojmë që Kosova të fitojë nga ky proces dhe në fund të fundit, do të provojmë që të mos dënohemi edhe njëherë në vitet që vijnë.

Edhe një çështje tjetër duhet ta përmend, është shumë problematike, kur kemi mocione, të cilat kanë elemente ideologjike. Nuk mund ne si Kuvend në total t'i mbështesim mocionet. Tani ne jemi në dilemë. Nuk po duam të shkojë kështu privatizimi, po nuk po mund ta mbështetësin mocionin që na ka ardhur, për shkak se nuk është konform bindjeve tona ideologjike. Ka elemente, të cilat nuk janë konform bindjeve tona. Ne do ta abstenojmë mocionin, dy mocionet që kanë ardhur, se nuk është mirë kështu. Kuvendi veç po flet sot. Me dy mocione nuk mund të shkojmë. Nuk ka pasur mocion të harmonizuar. Do të abstenojmë, edhe një herë po ju them, po do të kërkojmë që ky proces në vazhdimësi të ndalet, të jetë transparent. Edhe njëherë po ju them, mostransparenca është fyerje për Kuvendin, është fyerje për popullin e Kosovës.

Edhe një gjë tjetër është tepër me rëndësi ta përmend. Mendoj se po shitet një aset jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe është e dhimbshme se si nuk ka zgjuar interes më të madh edhe të deputetëve edhe të publikut! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e Grupit Parlamentar, Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Duke falënderuar ndoshta edhe Grupin Parlamentar të Vetëvendosjes dhe deklaratimet e ministrit për privatizimin e Distribuicionit dhe Furnizimit, unë mendoj se është e rrugës, që ministri me një seancë paraprake kishte qenë mirë të kishte një debat dhe të mos vinte deri te ky mocion për interpelancë, për arsye se zhvillimi i sektorit të energjisë është i dobishëm, për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe për të gjitha partitë politike.

Dhe, në rast se nisemi në bazë të strategjisë së energjisë, e cila ka kaluar në vitin 2009 – 2018, shihet mjaftë mirë, se Kuvendi i atëhershëm i ka dhënë përkrahje Qeverisë, për privatizimin e Distribuicionit dhe Furnizimit dhe aprovimin e Ligjit për partneritet publiko-privat i ka dhënë mundësi, që në kompaninë KEK të hyjnë investimet.

Mirëpo, duke marrë parasysh se edhe me ligjet e pakos së presidentit Ahtisari, domethënë për Ligjin për ndërmarrjet publike, Qeveria ka pasur mundësinë e privatizimit të

ndërmarrjeve publike, është parë rasti i Aeroportit, tash edhe rasti i Distribucionit dhe Furnizimit. Në rast se shohim objektivat, me të cilat është nisur privatizimi, kaq i rëndësishëm i Distribucionit dhe i Furnizimit, atëherë shihet se Qeveria e Kosovës nuk ka mundësi më të subvencionojë edhe në Distribucion dhe Furnizim, për arsye se dihet që Distribucioni dhe Furnizimi, 40 vjet nuk është investuar në to.

Dhe, në rast se nuk është investuar 40 vjet, atëherë edhe i gjithë buxheti i Kosovës shkon në këtë investim, është e pamundur që të arrihet ai nivel i standardeve, çfarë duhet të jetë.

A ka pasur bazë ligjore Qeveria, që të hyjë në privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit, atëherë mund të themi, se ka pasur bazë ligjore, duke marrë parasysh se ka Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për partneritetet publiko-privat dhe dhënie me koncesione dhe Strategjinë e energjisë, e cila jep mundësi. Mirëpo, Qeveria e Kosovës është e obliguar edhe në bazë të Traktatit të Komitetit të Energjisë së Evropës Juglindore, që sektori i energjisë të jetë në përputhje me këto kërkesa, ku ne mjaft mirë e dimë se në mandatin e kaluar kemi amendamentuar dhe kemi punuar 3 ligje të energjisë, të cilat janë në direktiva të Bashkimit Evropian dhe për këtë arsye Qeveria është e obliguar t'i përmbushë këto standarde.

Në rast se shohim nevojën e investimeve, unë prapëseprapë them se nuk është çështja vetëm e humbjeve komerciale, po është çështja e shumë pajisjeve të tjera, të cilat janë shumë të vjetruara dhe nuk mund që ne të investojmë në to.

Ministri e tha, se është një përparësi e këtij privatizimi, se 110 kilovoltëshi ka kaluar në KOST, mirëpo, unë në bazë të informacioneve që i kam nga privatizimi i Distribucionit dhe Furnizimit, mund të them se përparësia është këtu, se nuk është marrë modeli i Shqipërisë.

Kjo që unë kam kërkuar edhe nga ministri i Financave në procesin e buxhetit të vitit 2012, kam kërkuar që ministri i Financave të mos marrë modelin e Shqipërisë, për arsye se ne nuk kemi mundësi të subvencionojmë më asnjë kompani publike, se Buxheti i Kosovës nuk mund të japë subvencione për ndërtim të projekteve kapitale. Duhet të hyjë biznesi privat. Dhe, mjaftë mirë edhe Kushtetuta e thotë, se Kosova është për ekonomi të lirë të tregut dhe në ekonomi të lirë të tregut Qeveria dhe Kuvendi, janë të obliguar të bëjnë ligje, ndërsa bizneset të udhëheqin.

Çka do të kërkoja nga ministri, në këtë rast dhe Kabineti Qeveritar për arsye se kryeministri është këtu me ministrat, të cilët janë në këtë proces të privatizimit:

- Që procesi i privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit është dashtë të bëhet paralel me ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re,
- Që deri tash kemi humbur shumë investitorë dhe kemi humbur shumë kohë,
- Që të bëhet riparimi i Termocentralit "Kosova B" me investime të partneritetit publiko-privat, ndaras nga "Kosova e Re",
- Të fillohet riparimi i Bllokut të Termocentralit "Kosova A", për arsye që të mos kemi më import, se është çështja se duhet të japim subvencione nga taksat e qytetarëve të Kosovës, dhe

- Kërkoj nga Qeveria, në këtë rast, edhe nga miqtë ndërkombëtar, që të bëhet presion dhe të realizohet projekti i linjës 400 kV me Shqipërinë, për arsye se është mundësia e vetme, që Kosova të realizojë 20%-shin që të jetë pjesë e BE-së, se ne nuk kemi pasuri natyrore tjera, që t'i plotësojmë standardet e BE-së.

Ministër, në këtë rast kërkoj, si njeri i ekzekutivit dhe person, i cili ke marrë votën e qytetarëve të Kosovës, që shumë shpejt të realizohen këto sugjerime nga Koalicioni për Kosovë të Re. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS-ja nuk është paraqitur. "6+"-i nuk është paraqitur. Fjalën e ka deputetja Sala Berisha. Nuk është. Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Të nderuara deputete dhe të nderuar deputetë,

Unë jam përpjekur që t'i shoh disa aspekte të kësaj çështjeje dhe të kësaj teme dhe do të paraqes disa impresione dhe angazhime të miat këtu para jush.

Bazuar në Ligjin për ndërmarrjet publike, Qeveria ka udhëhequr këtë proces të privatizimit me transparencë të plotë dhe në bazë të standardeve më të larta ndërkombëtare.

Në një proces të tillë janë disa grupe të ndryshme të interesit dhe Qeveria ka bërë maksimumin, që të sigurojë transparencë të plotë ndaj të gjitha këtyre grupeve. Këto grupe përfshijnë: publikun e gjerë, shoqërinë civile, institucione vendore dhe ndërkombëtare, investitorë dhe punëtorë.

Përveç aspekteve ligjore, më ka interesuar edhe transparenca e këtij procesi dhe këtu kam konstatuar se transparenca ndaj publikut është zhvilluar sipas standardeve më të larta ndërkombëtare dhe sipas ligjeve për qasje në dokumentet publike.

Secili qytetar apo i interesuar në proces, ka pasur qasje në informata bazë dhe në rrjedhat e privatizimit gjatë gjithë procesit, përmes themelimit të Dhomës për Informim Publik.

Kjo Dhomë ka shërbyer për t' informuar të gjithë me rrjedhat dhe vendimet, e cila ka rezultuar si e suksesshme, sepse është vizituar pothuajse nga gjithë palët dhe pjesëtarët e shoqërisë. Në raste të veçanta, jo vetëm nga njëherë, por edhe disa herë, siç jam informuar, si nga pjesëtarë të shoqërisë civile, individë, nga biznesi privat, nga sektori i energjisë, punëtorë të KEK-ut, zyrtarë nga misionet ndërkombëtare në Kosovë dhe përfaqësues nga mediat e vendit dhe ato ndërkombëtare dhe sidomos, përfaqësues nga Federata e Sindikatës së Distribucionit dhe e Furnizimit të KEK-ut - Elektrokosova.

Siç jam i informuar zyrtarisht, të gjithëve u është ofruar qasje në informata lidhur me rrjedhat e privatizimit të KKDF-së. Proceset dhe vendimet që i prek ky privatizim e sidomos me çështjet sociale, si pjesa më senzitive e këtij procesi. Gjithashtu, jam pajisur me të dhëna se zyrtarë të Qeverisë dhe këshilltarët e angazhuar në procesin e privatizimit kanë marrë pjesë në secilin debat publik të ftuar lidhur me çështjet në energjetikë, ashtu

edhe në debatet mediale dhe asnjëherë nuk ka munguar prezenca e tyre, vetëm e vetëm për t'i ofruar publikut transparencë dhe informim të drejtë lidhur me procesin e privatizimit.

Njëkohësisht, Qeveria, siç kam informata po ashtu edhe me vetiniciativë, ka organizuar debate me shoqërinë civile dhe palët e interesit, mirëpo fatkeqësisht niveli i pjesëmarrjes, siç më është thënë, ka rezultuar i ulët.

Po ashtu, është për të vlerësuar edhe një aspekt, që është me interes për publikun. Sipas konstatimit tim, vendimet e KQP-së gjithmonë janë marrë në prezencën e vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë qenë të pranishëm në çdo takim zyrtar.

Vëzhguesit e ftuar në takimet e KQP-së kanë qenë: Banka Botërore, ICO, Komisioni Evropian, USAID-i; ndërsa ata vendorë: KEK, ZRRE, KOST dhe të gjithë kanë vlerësuar transparencë në projekt.

Sipas të dhënave që posedoj, skepticizmin tim në këtë proces e kanë ndryshuar pikërisht marrëveshjet e përpiluara për realizimin e këtij privatizimi dhe janë bërë me transparencë të plotë para ekspertëve vendorë të energjetikës dhe përfaqësues e ekspertë nga sektori i energjetikës, si nga KEK, ZRRO, KOST dhe përfaqësues të Ministrisë. Përfaqësuesit e këtyre institucioneve kanë marrë pjesë në seancat e grupit teknik për përpilimin dhe plotësimin e këtyre dokumenteve, sugjerimet e të cilave janë inkorporuar në versionet finale të këtyre dokumenteve dhe marrëveshjeve, që janë pjesë e rëndësishme e procesit të privatizimit të KEK-ut.

Para se të përcaktohesha për të folur, më ka interesuar se çfarë ka bërë Ministria me punëtorët dhe Federatën e Sindikatave të sektorit që po privatizohet dhe nga të dhënat që unë kam marrë, jam bindur se kanë qenë të informuar lidhur me këtë proces, përmes takimeve direkt me zyrtarë të Qeverisë si dhe vizitës në Dhomën e Informimit.

Kërkesat e parashtruara, gjithmonë nga ata, kanë marrë konsideratë të veçantë nga Qeveria. Disa prej tyre, ligjërisht nuk janë lejuar, për shembull një pjesë e aksioneve t'u jepen punëtorëve, mirëpo Qeveria është kujdesur, siç unë jam bindur, që të sigurojë punësimin e tyre përmes një periudhe trevjeçare. Si rezultat i marrjes së këtyre vendimeve nga KQP-ja dhe transparencës në informim të ofruar për ta, pothuajse të gjithë kanë nënshkruar kalimin e tyre dhe kontratat e tyre nga KKDFE, në subjektin privat.

Ekipi profesional, i angazhuar në këtë proces, ka përgatitur një strategji mjaft joshëse për investitorët, që përmes krijimit të Dhomës Fizike të Dhënave dhe Dhomës Virtuale të Dhënave, është siguruar qasje e barabartë dhe e plotë e të gjithë investitorëve në të gjithë dokumentacionin relevant.

Përveç ofertuesit të preferuar dhe ofertuesit të dytë, që është deklaruar se ky ka qenë një proces shumë transparent. Nuk kam qenë indiferent, sikur edhe gjithë grupi ynë parlamentar, si edhe në çështje të tjera të rëndësishme të zhvillimit të vendit dhe jemi informuar se ka pasur raste kur Qeveria ka pranuar ankesa nga shoqëria civile, të cilat

nuk ka qenë e mundur të trajtohen me objektivitet. Dhe, kjo është ngritur me mjaft interesim në grupin tonë parlamentar.

Jemi informuar nga disa pjesëtarë të shoqërisë civile dhe nga partitë opozitare që kanë kërkuar transparencë në kuptimin e plotë të fjalës, por është kërkuar për të marrë pjesë në vendimmarrje lidhur me procesin e privatizimit. Dhe, këtu kemi të bëjmë me një përplasje konceptuale politike për zhvillimin e vendit, që dallojmë konceptualisht dhe sheshazi.

Pjesëmarrja në vendimmarrje bëhet përmes mënyrës demokratike - zgjedhjeve dhe dihet si ndërtohet dhe si funksionon ekzekutivi. Andaj, këto kërkesa të ardhura nga adresat e një pjese të shoqërisë civile, duken më shumë se kanë pasur agjendë të veçantë politike dhe motivime të tilla e jo dëshirë të sinqertë, që si pjesë e shoqërisë civile t'i ndihmojë dhe të kontribuojë procesit. Ato janë trajtuar në përputhje me Ligjin për qasje në dokumentet publike, të aprovuara në Parlamentin e Kosovës.

Këtu dëshiroj të njoftoj publikun e nderuar, se procedurat e rëndësishme me theks të veçantë dëshiroj të cek, se Qeveria na informon se çdo marrëveshje e procesit të privatizimit, pas finalizimit do të bëhet publike.

Kjo do të ndodhë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës midis Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë, që po e privatizon dhe do t'u mundësojë të gjithëve së bashku të monitorojmë dhe të sigurojmë implementimin e duhur të këtij privatizimi.

Nga të gjitha informacionet që kam përmbledhur, ato janë mjaft inkurajuese, të paktën ato që unë i posedoj dhe që deri më tani i kam analizuar. Transparenca e procesit ka marrë urimet më të mira nga pjesëtarët e sektorit të logjistikës në vend, si: KOST-i, KEK, ZRRE dhe vëzhguesit në proces, si: USAID-i, Banka Botërore, ISO, Komisioni Evropian, e tjera, të cilët gjatë gjithë procesit kanë qenë pjesëmarrës në cilësi të vëzhguesit dhe janë njoftuar me rrjedhat dhe vendimet e procesit të privatizimit të KKDFE-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit,

I nderuar kryesues,

Përfaqësues të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Mënyra e privatizimit të distribucionit është shkelja e radhës e kësaj Qeverie. Mungesa e transparencës e ka përcjellë këtë proces që nga fillimi i ditës së parë.

U tha këtu shumë, u fol për Dhomën e të Dhënave Fizike dhe atyre virtuale, mirëpo mos të harrojmë se nga të gjitha grupet parlamentare, përpos Grupit të Partisë Demokratike të Kosovës, iu parashtruan një varg pyetjesh ministrit, i cili nuk u përgjigj në asnjërën nga këto pyetje.

- Sa është vlera e aseteve të Distribucionit?

- A mendon Partia Demokratike e Kosovës, se vlera reale e Distribucionit është 26,3 milionë euro?
- A është rrjeti i Distribucionit në veriun e Kosovës, pjesë e ofertës?

Nuk morëm asnjë përgjigje, sepse nëse kjo ndahet, atëherë kjo do të ketë konsekuenca të rënda.

Nuk morëm përgjigje se çka do të ndodhë me furnizimin, do të thotë, ne po bëjmë krijimin e një monopoli të dyfishtë dhe shumë pyetje të tjera.

Ne kërkojmë, për hir të transparencës, që ministri të përgjigjet në të gjitha pyetjet e grupeve parlamentare. Ky transaksion më së paku mund të quhet privatizim apo shitje, sepse nuk po paguhet as 1/20-ta e vlerës reale dhe kjo është plaçkitje klasike dhe jo nga blerësit, po nga shitësit, që në këtë rast është Qeveria Thaçi.

Ka pasur reagime të qytetarëve në forma të ndryshme, këto ditë dhe thirrjet janë drejtuar pikërisht Kuvendit të Kosovës. Qytetarët e Kosovës mendojnë, duke filluar nga ekspertët, se vetëm telat e aluminit të shiteshin me kilogramë, vlera e Distribucionit do të ishte më e lartë se 26,3 milionë euro dhe kjo u tha edhe nga kolegët deputetë, që folën paraprakisht.

Kjo mund të duket banale, por është komplet e pakontestueshme, sepse vetëm pjesa metalike po të shitej, ne do të kishim fituar një çmim shumë më të lartë se sa çmimi i ofruar nga konsorciumi “Limak & Çalik”.

Çmimi ka qenë befasi, por jo fituesi, sepse ekspertë dhe analistë që e kanë përcjellë nga afër këtë sektor, na kanë bërë me dije shtatë muaj më herët, se pikërisht kjo kompani do ta fitojë këtë tender. Kjo ndodhë sepse në një vend ku lulëzon korrupsioni, së pari gjendet blerësi apo blerësi gjen Qeverinë, blerësi identifikon asetin që dëshiron ta blejë, pastaj Qeveria vë në shitje asetin sipas kushteve të blerësit dhe jo kushteve të veta.

Por, sigurisht blerësi duhet të ketë lidhjet e forta me Qeverinë, si në rastin konkret, ku blerësi rastis të jetë dhëndër i mikut të ngushtë të kryeministrit të Kosovës. Kjo kompani nuk ka asnjë ditë përvojë në sektorin e energjisë, por ja që Qeveria e Kosovës, në një çmim fare simbolik, i jep rastin kompanisë në fjalë, që të provojë fatin e vet edhe në këtë sektor, bile, edhe po e përgatit terrenin duke e rritur çmimin e rrymës elektrike.

Përpos çmimit tepër të ulët, ky transaksion në vete ka edhe anomali të tjera, siç është vendosja e monopolit. Distribucioni i energjisë elektrike është një monopol i llojit të vet, që u tha edhe më herët, për nga natyra sepse nuk ka si të jetë ndryshe.

Por shteti, asnjëherë nuk duhet që monopole të tilla t’i privatizojë në tërësi, sepse këto janë asete strategjike dhe shteti duhet gjithmonë të mbajë për vete një pjesë të aksioneve, ose t’u japë asetin kompanive private në shfrytëzim për kohë të caktuar siç përmendëm, u elaborua më herët rasti i Malit të Zi. Por, të gjitha këto nuk janë pjesë e procesit, për të cilin ne flasim sot. Në rastin tonë, bashkë me Distribucionin po jepet edhe Furnizimi për energjinë elektrike, duke monopolizuar kështu edhe shitjen e energjisë elektrike.

Në plot vende, të cilat punojnë mirë e mbarë, edhe pse kemi vetëm një distribucion, qytetarët prapë mund të zgjedhin se prej kujt mund të blejnë rrymë elektrike. Kjo është e drejtë e qytetarëve. Por, ja që këtë të drejtë qytetarëve të Kosovës, Qeveria e bartë nga qytetarët tek konsorciumi “Limak & Çalik”, të cilët tash e tutje do të vendosin se prej kujt qytetarët e Kosovës të blejnë rrymë.

Qeveria Thaçi, si duket, e ka keqkuptuar komplet konceptin e ekonomisë së tregut të lirë. Ekonomia e tregut nuk promovohet me krijimin e monopoleve, siç janë ky i Distribucionit dhe ai i “Sharrcemit”, por monopolet janë pikërisht e kundërta e ekonomisë së tregut. Privatizimi pa liberalizim të tregut do të thotë plaçkitje.

Pse Kosovës po i ndodhin të gjitha këto, sepse Kosova po udhëhiqet nga njerëz, që në pushtet kanë ardhur me vota të manipuluar? Kjo Qeveri u krijua nga manipulimet dhe keqpërdorimi i vullnetit të lirë të qytetarëve, pazaret më bizare që njeh historia dhe të tilla janë frytet e saj.

Në fund, prapë ne kërkojmë përgjigjet, që u parashtruan nga të gjitha grupet parlamentare dhe nuk po i përsëris më tepër. Dhe, kërkojmë që Qeveria të jetë më syçelë dhe të shikojë përtej xhepave të vet kur bëhet fjalë për të ardhmen e një sektori që ka rëndësi kaq vitale. Të mendojë jo vetëm për ardhmërinë e fëmijëve të vet, por për ardhmërinë edhe të atyre që nuk i kanë prindërit në Qeverinë më “glomaze” në rajon dhe të atyre që nuk kanë prindër fare, sepse janë flijuar pikërisht për të ardhmen e fëmijëve të tyre.

Mos e shkatërroni ardhmërinë! Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar kryeministri i Kosovës, zoti Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit!

I nderuar kryesues, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Unë nuk desha që të humbas kohë fare as ministrit, as ju, në këtë interpelancë, por si do që të jetë, moskorrektësia në disa qasje, që po prezantohen këtu më detyruan që t'i drejtohem përsëri opinionit publik dhe juve.

Këtu u dëgjuan britma prej atyre që e kanë mallkuar edhe vendimin për ndërtimin e Autostradës prej Vërmicës në drejtim të Merdarit. Gjithashtu britma, të paargumentuara fare për koncesionimin e Aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”. Natyrisht, se tash pasi që autostrada Vërmicë-Merdar është në vllugun më të madh të punëve dhe qytetari i Kosovës e sheh dhe po e përjeton çdo ditë, kjo çështje e dështuar së shari, e së akuzuari, është harruar dhe tash pretendohet me britma dhe mllefe të njëjta, të bartet në çështje të tjera. Vetëm sa për informatë, edhe pesëkilometërshi tjetër i Autostradës Vermicë-Prishtinë, përfundon këtë të hënë apo të martë, pra bëhet inaugurimi tjetër, ndërsa deri në Orllat përfundon më 27 nëntor, deri në Prishtinë. Dhe, është autostrada prej më moderneve në rajon dhe do të përfundojë në Mërdare.

Sa i përket Autostradës, unë besoj që nuk do të ketë britma të çoroditura, të paargumentuara tash për fillimin e ndërtimit të autostradës tjetër Prishtinë-Ferizaj-Kaçanik-Hani i Elezit, sepse kemi pajtueshmëri të plotë edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar edhe me Bankën Botërore edhe me Komisionin Evropian, kështu që është një periudhë e ndërtimit të autostradave dhe shkëputjes prej së kaluarës jo vetëm fizike të rrugëve dhe aeroporteve, por në të njëjtën kohë, kërkohet edhe një shkëputje në mentalitet nga mendimi monist, sepse vetëm ai që ka mendim monist, pretendon të ndërtojë edhe monopole. E nderuara profesoreshë, aq sa e di që jeni kandidate e shkencave, por sot nuk e argumentove.

Në anën tjetër, sa i përket gjithashtu Aeroportit, unë ju informoj se është në vllugun më të madh të punëve dhe në periudhën e paraparë do të investohen të gjitha ato mjete, që janë të planifikuara me marrëveshjen e Qeverisë së Kosovës me konsorciumin francezo-turk dhe do të jetë aeroporti më modern i mundshëm në rajon.

Të qenët e djathtë nuk nënkupton vetëm lakmia për të qenë i djathtë apo në kuptimin pse disa njerëz duan, por prioritetet duhet t'i kesh të djathta, që të jesh i djathtë jo vetëm në aspektin ideologjik apo në kuptimin e perceptcionit. Jo të jesh në letër i djathtë e në krye tipik ultra-majtist, e nderuara profesoreshë.

Ndërsa, sa i përket edhe projektit në fjalë, për çka është sot e thirrur kjo interpelancë, unë mund t'ju them se i gjithë procesi ka qenë plotësisht në përputhshmëri me vendimet që i ka marrë Kuvendi i Republikës së Kosovës, me transparencë të plotë, tash dikush e merr transparencën e kupton ndryshe, dikush ndryshe, por transparenca është një. Ndërsa, aty ku ka konkurrencë nuk ka monopol dhe çmimin nuk e përcakton kjo apo ajo parti, kjo apo ajo Qeveri, por e përcakton tregu i lirë, pra konkurrenca dhe tregu i lirë.

Ka pasur transparencë, ka pasur konkurrencë dhe në përputhshmëri me tregun e lirë. Dhe, edhe ky projekt është përshëndetur dhe ka ndodhur në transparencën e plotë, të gjithë mekanizmave ndërkombëtarë prezentë në Kosovë, ndërsa, sa i përket mlllefeve tjera, sa i përket anës ligjore dhe joligjore, janë autoritetet kompetente, që e bëjnë interpretimin dhe jo një parti politike. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë, zonja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryeministër!

Nuk të pyeta për autostradën, por meqë po do me dalë tek utostrada, kam shumë pyetje edhe për autostradën.

Nuk e kam mallkuar asnjëherë, bile autostrada ka qenë projekt i LDK-së dhe këtë e dinë krejt Kosova, krejt qytetarët e Kosovës.

Dhe, pyetjet për autostradën janë :

- Si ka mundësi që një kilometër autostradë kushtoi 10 milionë euro?

- Pse ka ndërruar traseja, që është votuar në Kuvend?

- Si po shpronësohen tokat, ato të cilat u privatizuan nga procesi i privatizimit, ato të cilat u privatizuan nga procesi i privatizimit nga AKP-ja me njëzet euro për ari, tash shpronësohen me 4.000 euro për ari?

- Në të kujt xhepa po shkojnë këto para të Buxhetit të Kosovës?

Sa i përket privatizimit të Distribucionit, për të cilin ne po flasim sot, se pa marrë parasysh çka flasim, duhet të dalim te autostrada, ne patëm pyetje dhe ju lutem na përgjigjeni. Çka po shitet, sa po shitet, sa mendoni ju, që e ka vlerën?

Edhe dhënia e dy licencave “Limak & Çalik” dhënia e licencës së Distribucionit dhe dhënia e licencës së furnizimit, na tregoni, a nuk paraqet monopol për juve? Sepse, ne e kuptojmë si monopol, të gjithë qytetarët e Kosovës e kuptojnë si monopol. Urdhëro, parashtro argumentet dhe na trego, që nuk është monopol! Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e ka fjalën edhe një herë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: OK, vazhdojmë për autostradën. Edhe Vërmicë-Merdar edhe për Ferizaj, qysh të keni qejf, s’është asnjë problem hiç. Faleminderit e nderuara deputete, për pyetjet tuaja.

(Ndërhyrje)

Deputetja juaj e parashtrori pyetjet dhe unë ndjej obligim moral, qytetar kushtetues dhe ligjor, t’i përgjigjem. Prandaj, e nderuara deputete, ju parashtruat pyetje për autostradën. Unë nuk i mohoj, në asnjë rrethanë zhvillimet e mëhershme, që kanë ndodhur, nuk i mohoj në asnjë rrethanë se kush ka folur për ndërtimin e autostradës, ka pasur rrugë edhe historikisht në atë pjesë, po tash nuk dëshiroj të merrem me histori, por ju e dini se në vitin 2007, për herë të parë në fushatën elektorale, kam prezantuar projektet e ndërtimit të autostradave në Republikën e Kosovës, projekte këto, konkrete dhe jo vetëm si ide.

Prandaj, pikërisht duke u nisur nga kjo, në një afat rekord kemi filluar ndërtimin e autostradës dhe do të përmbyllet në një afat. Unë veç i përgëzoj qytetarët e Kosovës, për këtë projekt të rëndësishëm të munguar dhe një projekt i ëndrrave të qytetarëve të Kosovës. Sa u përket partive që i përmend e nderuara deputete, profesoreshë e nderuar, meqenëse je vonë në Parlament dhe disa gjëra, me siguri të kanë munguar, ose po të mungojnë, ose nuk je e informuar. Ju ftoj që grupi juaj të të informojë... Te partitë, edhe përmend edhe presidentin Rugova. Kurrë juve LDK-së, nuk iu ka shkuar ndërmend ta emëroni apo të emërtoni diçka të tillë me emrin e Presidentit. Unë e kam propozuar dhe e kam emërtuar, e nderuara deputete.

Prandaj, sa i përket trasesë, ndryshimi i drejtimit të ndërtimit të autostradës, po, po, ndryshimi i drejtimit të autostradës, ka kursyer rreth 300 milionë euro, e gjithashtu edhe emërtimi ka ardhur si ide imja edhe për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, ka zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Nocion për Rregullore, e kam të drejtën...

Falemnderit, zoti kryesues!

Të dëgjoja, the le të flitet çkado. E ke gabim. Është vërejtje në zbatim të Rregullores dhe me Rregullore e ke sekretarin aty përbri, sa rrinë, nëse s'e di le të tregojë, që kur rrëshqitet nga tema themelore, udhëheqësi e ka për detyrë të bëjë vërejtje, nëse nuk ndalet folësi, t'i thuhet kthehu në temë ose ta ndalojë.

Kështu shkruan Rregullorja me germë dhe me frymë. Nuk është kurrfarë demokracie, përkundrazi është anarki e të folurit në Kuvend, nëse njerëzit flasin si thatë ju, çka të kenë qejf. Falemnderit shumë!

KRYESUESI: Të falemnderit! Edhe ti, edhe ata që flasin, i harxhojnë minutat e Grupit të vet, kështu që nuk ka ndonjë problem.

Fjalën e ka zoti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Falemnderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës duke u bazuar në strategjinë e energjisë, për vitet 2009-2018, e cila është miratuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës, ka iniciuar një sërë reformash në sektorin e energjisë, duke përfshirë këtu edhe privatizimin e operatorit të Distribuimit të energjisë elektrike.

Dihet se hartimi i kësaj strategjie ka për qëllim zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit energjetik, në përputhje me standardet evropiane, të bazuar kryesisht në shfrytëzimin racional dhe efektiv të burimeve energjetike, për të siguruar së pari një furnizim stabil dhe kualitativ të konsumatorëve, pastaj përdorim eficient të energjisë dhe duke u kujdesur njëherësh edhe për ruajtjen e mjedisit.

Ndërkaq, qëllimi kryesor është, pa dyshim, shpejtimi i zhvillimit ekonomik të vendit tonë në përgjithësi. Prandaj, bazuar në këto, si dhe fakte e arsye tjera, konsideroj që aspektet kryesore, të cilat duhet pasur parasysh e që kanë efekt në këtë projekt, janë marrë parasysh nga ana e Qeverisë së Kosovës, siç janë: - Legjislacioni dhe rregulloret në fuqi, për këtë sektor,

- Ekonomia në rritje dhe rritja e kërkesës për energji,

- Humbjet teknike dhe komerciale në rrjetin e shpërndarjes,

- Numri aktual i të punësuarve dhe garantimi i kontratave të tyre,

- Mundësitë e disponueshme financiare në tregun global për investime në energjinë elektrike dhe

- Teknologjia e rrjetit të shpërndarjes dhe infrastruktura.

Përveç kësaj Kosova është nënshkruese e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore, i cili ka hyrë në fuqi më 1 korrik të vitit 2006.

Në këtë kontekst Qeveria e Kosovës është e angazhuar substancialisht, për të zhvilluar sektorin e energjisë në përputhje me kërkesat e këtij traktati. Po ashtu, ky traktat obligon implementimin e aquis komunitare të BE-së nga ana e secilës palë kontraktuese sipas një kalendari për zbatim të reformave të kërkuara.

Edhe për Kosovën, si nënshkruese e këtij traktati, si obligim primar është lehtësimi i kushteve për pjesëmarrje të sektorit privat në këtë sektor.

Prandaj, krijimi i kushteve për një treg pa monopol të energjisë elektrike në Kosovë, në përputhje edhe me detyrimet që rrjedhin nga ky traktat, përbën qasjen e Qeverisë për tërheqje të investimeve, për të siguruar çmime sa më të favorshme të energjisë, për konsumatorët.

Në këtë kontekst avancimi i mëtutjeshëm dhe investimet e reja janë të domosdoshme në rrjetin e shpërndarjes, për të zvogëluar humbjet, ndërkohë që duhet të ndërmerren veprime edhe për rritjen e eficiencës së energjisë elektrike, për të ndihmuar kështu në kontrollin e kërkesës.

Investimet e fokusuara do të përmirësojnë besueshmërinë e sistemit të shpërndarjes, do të ndihmojnë në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe do të përmirësojnë shërbimet dhe besueshmërinë.

Investimet më urgjente në rrjetin e shpërndarjes lidhen me asetet e njësitit në nivel të nënstacioneve dhe njësitit të sigurt në nivel të përdoruesve fundor.

Një element tjetër, që vlen të theksohet, është transparenca e këtij procesi. Transparenca ndaj publikut është zhvilluar sipas standardeve më të larta ndërkombëtare dhe sipas Ligjit për qasje në dokumentet publike. Secili qytetar apo i interesuar për këtë proces ka mund të ketë qasje në informatat bazë dhe rrjedhat e privatizimit gjatë gjithë procesit, që është mundësuar me themelimin e Dhomës për Informim Publik.

Të gjithë ofertuesit kanë pasur mundësinë të konkurrojnë sipas kritereve identike dhe sipas marrëveshjes identike të paracaktuar për shitblerje. Për këtë arsye procesi është mbështetur fuqimisht edhe nga komuniteti i donatorëve, si USAID-i, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian, të cilët kanë marrë pjesë në takimet e komitetit Qeveritar për privatizim, si vëzhgues të këtij procesi.

Të nderuar deputetë, ne besojmë fuqishëm që pjesëmarrja e sektorit privat në KEK pritet të përmirësojë dhe zgjerojë rrjetin e shpërndarjes, t'i shtojë faturimin dhe inkasimet, të zvogëlojë humbjet e energjisë dhe të përmirësojë sigurinë e furnizimit dhe cilësinë e gjithmbarshme të shërbimeve për konsumatorët.

Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në krijimin e një klime të favorshme për investime potenciale jo vetëm në sektorin e energjisë, por në gjithë ekonominë e vendit, por të stimuluar zhvillimin ekonomik dhe ngritje të standardit social, në krijimin e vendeve të reja të punës në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Me shitjen e Distribucionit të KEK-ut, korporatave “Çalik & Limak” po u jepen asetet e KEK-ut, potenciali i KEK-ut, monopoli në tregun e Kosovës si dhe punëtorët e KEK-ut.

Nëse supozojmë që këto janë shitur në mënyrë të barabartë, pra çereku i shumës prej 26 milionë euro, për secilën prej këtyre kategorive, atëherë del që:

E para, të gjitha asetet e Distribucionit, mijëra kilometra pra, të rrjetit elektrik kabllor dhe ajror, mijëra trafostacione dhe stabilimente të ndryshme dhe ato dhjetëra ndërtesa shumëkatëshe anekënd Kosovës, janë shitur për vetëm 6 milionë e gjysmë euro.

Nën dy, potenciali zhvillimor dhe i rritjes së KEK-ut është shitur po ashtu, vetëm për 6 milionë e gjysmë euro. Pra, komplet e ardhmja e pafundme, gjithçka që do të mund të bëhet në të ardhmen, është shitur për 6 milionë e gjysmë euro.

Nën tre, tregu prej mbi 400 mijë konsumatorësh, është shitur për 6.500.000 euro, që do të thotë se një konsumator kosovar, komercial apo privat, korporatat “Çalik & Limak” e kanë blerë vetëm për 15 euro. 15 euro e kanë blerë konsumatorin tonë.

Dhe e katërta, 2 mijë e 454 punëtorë të KEK-ut u shitën për 6.500.000 euro, e që i bie afër 2 mijë e 650 euro për punëtor.

Le ta dinë punëtorët e KEK-ut, që kontributin e deritanishëm, jetën aktuale dhe vitet e mbetura të punës, Qeveria ua shiti kaq. Pra, 2 mijë e 650 euro për kokë punëtori.

Krejt çfarë kanë bërë dhe do të bëjnë këta punëtorë, vetëm kaq pra, vlejné për këtë Qeveri. 2.650 uro, që bëjnë më pak edhe se paga mesatare vjetore në Kosovë.

Sigurisht, që shumë punëtorë do ta humbin punën, disa së shpejti e disa pak më vonë. Nuk mund të presësh që këto dy korporata turke, të kujdesen për punëtorët e Kosovës, përderisa Qeveria e Kosovës i shiti ata dhe ndërmarrjen e tyre, tamam siç shiteshin dikur skllëverit nga një pronar te një pronar tjetër.

Njerëzit po vihen në funksion të pronës. Shitet prona dhe bashkë me të edhe njerëzit që punojné në atë pronë. Trajtimi, që Qeveria e Kosovës po ia bën Distribucionit të KEK-ut, kur po e shet atë, do të përkthehet në trajtimin që “Çalik & Limak” do t’ua bëjnë punëtorëve të KEK-ut.

Shfrytëzimi i punëtorëve do të rritet shumë, privati synon superprofit dhe kjo do të reflektohet prej pagave e orarit të punës deri te rreziku në vendin e punës.

Premtimet për punëtorë se do të mbahen edhe tri vjet në punë, janë tepër pak dhe tepër vonë, përveçse janë vetëm premtime.

Për më keq se kaq, ato nuk po bëhen për të mirën e punëtorëve dhe të shoqërisë, por për rehatinë e Qeverisë, me besimin se punëtorët do të heshtin, sepse secili prej tyre do të shpresojë se do ta përfshijnë atë punëtor individualisht.

KEK-u është kontribut i madh i brezave të shumtë. Vitin e ardhshëm mbushen 50 vjet, prejse është bërë elektrifikimi në Kosovë. Ka njerëz që tërë jetën kanë punuar në KEK dhe tash janë në pension. E gjithë djersa e tyre po shitet shpejt e shpejt dhe shumë lirë.

Qindra-mijëra njerëz, në forma të ndryshme e kanë ndërtuar KEK-un. Miliona njerëz do të varen prej tij në të ardhmen. As ata që kontribuan si punëtorë, as ata që varen prej KEK-ut, si konsumatorë, nuk u pyetën për këtë vendim makabër të kryeministrit Thaçi dhe ministrit të tij Beqaj.

Shitja e Distribucionit të KEK-ut dhe shtet ndërtimi nuk shkojnë bashkë. Qytetarëve tonë ua çel derën mysafiri dhe inkasanti i KEK-ut. Pra, miqtë dhe shteti, por tash e tutje miqtë do të vijnë, kurse shteti vjen i privatizuar, shteti vjen i shitur prej njerëzve të shitur, sepse kaq keq dhe kaq lirë KEK-un mund ta shesin vetëm njerëz të shitur. Këta njerëz të shitur nuk e kanë vendin në Qeveri, por e kanë vendin në burg për krimin që ia bënë shoqërisë dhe pronës publike.

Kryeministri Thaçi dhe ministri Beqaj janë “paçavra” në duar të huaja, të cilët tashmë më shumë fëlliqin se sa pastrojnë, për shkak të ndyrësisë që i ka mbuluar...

KRYESUESI: Është mirë të mos ofendosh më, Albin.

ALBIN KURTI: Ne i bëjmë thirrje edhe njëherë korporatave “Çalik & Limak”, që të mos e blejnë Distribucionin e KEK-ut që të tërhiqen të mos e keqpërdorin Kosovën duke përfituar nga kjo Qeveri e korruptuar. Ata mund t’i kenë marrëdhëniet e mira me këto dy “paçavra”, por jo me Lëvizjen “Vetëvendosje”, jo me punëtorët e KEK-ut dhe jo me popullin e Kosovës. Këtë privatizim do ta luftojmë pa pushim, pa kursim dhe përgjithmonë.

KRYESUESI: Për Parlamentin fjalët “paçavra”, për të emërtuar njerëz, në qoftë se ka gabime, ka mekanizma, ka rrugë tjera. Nuk është mirë, që të fyhemi. Është mirë që t’i arsyetojmë problemet, të kritikojmë dhe të kërkojmë llogari, për ata që duhet të japin llogari, por jo me fjalë fyese.

Fjalën e ka Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Faleminderit!

Kryeministri shkoi, se mbeta borxh t’ i them që nuk e vë në dyshim që asfalti do të vazhdojë, se çimenton e keni siguruar prej “Titanit” edhe tjetër gjë s’po dini çka të bëni , por të bëni çimento. Por, qytetarët e Kosovës nuk hanë asfalt dhe Kosova vazhdon të jetë vendi i 9-të më i varfër në botë derisa ju po lavdëroheni me të arriturat.

Po dua të kthehem te Distribucioni. Distribucioni ka rrjetin e shpërndarjes, me një gjatësi prej 18 mijë e 898 kilometra. Veç telin po ta kishim shitur, ka më shumë vlerë se krejt Distribucionin, veç telin, telat që i shohim ne.

Me këtë shitje të Distribucionit, Qeveria Thaçi edhe njëherë ka dëshmuar që s'ka kapacitet negocues, ose po e humb krejt kapacitetin negocues, kredibilitetin dhe integritetin duke negociuar për veti e mbasandaj në mbrëmje po bën "aksham pazar" me resurset publike.

Distribucioni ka mbi 6.200 copë transformatorë të nivelit 10/04 kV. Ka rreth 20 trafostacione 35-kilovoltëshe, që kanë vlerën dukshëm më të madhe se sa është shitë Distribucioni. Në qendër, ndërtesa e Elektrokosovës, ka 30 ari tokë dhe rreth 15.000 m² hapësirë punuese.

Humbjet teknike dhe ato komerciale ende janë shumë të larta, mbi nivelin e rajonit, do të thotë 35% po ky i njëjti ministër, nuk i ka 2-3 javë, që ka dalë qitu edhe ka kundërshtuar, duke thënë që Qeveria Thaçi prej vitit 2007 ka bërë mrekulli në KEK dhe i ka zvogëluar humbjet komerciale dhe humbjet teknike. Tash kjo çka po e thotë sot, po bie në kundërshtim me atë, që e ka thënë dhe e ka replikuar në pyetjet e mia se çka po ndodh në sektorin e energjisë. Rritja e çmimit të energjisë elektrike, të cilën Qeveria Thaçi ia dhuroi qytetarëve në këtë vit, kur Kosova radhitet si vendi i nëntë më i varfër në botë, është bërë për t'i mbuluar deficitin buxhetor dhe humbjet e KEK-ut.

Dhe edhe njëherë për ministrin, që po pretendon që s'është përgjegjësi e Qeverisë, tarifata e energjisë janë rezultat i politikave të Qeverisë, Rregullatori vetëm e bën llogaritjen e politikave të metodologjisë, që ia lejon ligji. Deklarimet që Kuvendi dhe Rregullatori është përgjegjës për ikje nga përgjegjësia, do të thotë është komplet e pavërtetë, është ikje nga përgjegjësia, ose është mungesë e informatave, njohurive, padituri që në këtë rast ministri po tregon.

Distribucioni është shitur për 26.3 milionë euro, derisa inkasimi mujor është rreth 20.000.000 euro. Të bëhen vetëm krahasimet e investimeve një vjeçare me vlerën e shitur, del se më shumë është investuar për një vit, se sa është vlerësuar i tëri dhe unë këtu po dua ta shtroj një pyetje. Përveç taksave të qytetarëve të Kosovës, që janë keqpërdorë dhe po abuzohen nga kjo Qeveri na kemi edhe taksat e donatorëve të huaj edhe po më habit fakti që edhe këto taksa po abuzohen dhe po shiten dhe po i falen dikujt dhe për qëllimet e dikujt tjetër. Kemi taksat e qytetarëve të Evropës duke e ditë që Qeveria gjermane është në mesin e investitorëve më të mëdhenj. Prandaj, po më habit ky fakt.

Përveç shitjes, që është bërë një balon edhe iu është dhënë mediave edhe këtij Kuvendi për t' u marr këtë, çështja e Distribucionit ka edhe implikimet tjera, ka edhe pasoja tjera. Për shembull, arsytimi për nevojën e privatizimit të Distribucionit është bërë mbi bazën e nevojës së investimeve në vlerën rreth 400.000.000 euro që Kosova nuk i paska. Prandaj, duhet të shitet për t'u përmirësuar furnizimi. Në kundërshtim me këtë arsyetim, të gjitha trafostacionet 110 kV, që kanë qenë pronë e KEK-ut, u janë bartur KOST-it.

Prandaj, edhe mirëmbajtja, edhe investimet e gjithë ata edhe ministri këtu, edhe kryeministri e dinë që këtu janë humbjet e mëdha, duhet të mbulohen nga buxheti i Kosovës. Pra, Kosova ka për të vazhduar të subvencionojë edhe më shumë KOST-in, ndërkaq bartja e aseteve prej KEK-ut në KOST e ka zvogëluar vlerën e Distribucionit, mirëpo e ka rritur bazën për subvencionim.

Pra, çmimi i ulët i shitjes është vetëm një element me të cilin po merremi krejt, është balon, por humbjet janë shumë më të mëdha. Po aq të rëndësishme janë edhe çështjet tjera, që nuk lidhen me shitjen, prandaj po dua t'i bëjë disa pyetje që besoj do të marrim përgjigje e s'do të na përgjigjeni për udhërrëfyes.

Gjatë nënshkrimit të kontratës për shitblerje si janë definuar çështjet në vijim:

- Data e dorëzimit të aseteve, sepse investitori mundet ta inkasojë energjinë e faturuar deri atë ditë. Do të thotë, nëse për një muaj e gjysmë e bën këtë inkasim flasim për 30.000.000 euro. Dhe, distribucioni është shit 26.000.000.

- Pastaj, çështja “power purchase agreement”. Kush e bart koston e çmimit më të lartë të importit në raport me PPA-në, në raport me kontratën për furnizim KEK - KED?

- Çështja e investimeve të nevojshme a bëhet në bazë të prioriteteve për zvogëlimin e humbjeve dhe kalimin në nivelin 20/10 kV, si dhe afatin t'i kemi afatet për realizimin e këtyre investimeve, apo do të kemi veç një “make up” si në Shqipëri, e dimë qysh është gjendja energjetike atje?

Çështja “third-party access” në pajtim me direktivat e Unionit Evropian. Po dua t'ua rikujtoj që modeli i tregut të propozuar nga “International Finance Corporation” nuk është aprovuar nga Unioni Evropian. Prandaj, si është trajtuar me rastin e kësaj kontrate?

Çështja e përcaktimit të pikave matëse me KOST-in, bartja e humbjeve teknike të trafave 110kV, dhe padyshim çështja e veriut të vendit. Me theks të veçantë pyetën edhe deputetë tjerë, por na nuk morëm përgjigje. E fundit por jo ma pak e rëndësishme, përkundrazi është çështja e 2400 punonjësve të fushave të ndryshme, të cilët operojnë në KEK. Edhe ju lutem mos thoni që tri vjet e kanë të garantuar punën se atëherë po i leni në ankthin e pritjes se po e shohin çka ka ndodh në Ferronikel me 85 punëtorë, po e shohin çka po ndodh me privatizimet e tjera, por te shohim se çka keni bërë në kontratë shumë saktë. Sepse, këtu kemi edhe një problem tjetër: shumica dërrmuese prej njerëzve që punojnë në KEK, respektivisht në Distribucion nuk kanë vendime për punë. Kanë kontrata afatshkurtra, kanë kontrata 3,6 deri 9 muaj dhe këto kontrata ... do t'ju ndërpriten nëse ju e po dyshoj që e keni bërë ndonjë mbrojtje për ta. Dhe pastaj investitori nuk ka asnjë obligim, sepse ju si Qeveri keni harruar që ata njerëz ekzistojnë, ashtu qysh po i harroni goxha do punë.

Prandaj, pyetja jonë është: Çka do të ndodhë me këta njerëz, sepse aspekti social dhe human në Kosovë është harruar dhe Qeveria që ta mbërrijë ta realizojë qëllimin e grupeve të interesit, sikurse në rastin e “Sharrcemit” është e gatshme me shkel mbi trupat e njerëzve, qysh po veprohet kohët e fundit. E përmenda rastin e “Sharrcemit”, mirëpo nuk po dua ta tërheq vëmendjen, po dua ministrit Beqaj, në pyetjet që bëra besoj keni marrë

shënime, të na përgjigj një nga një dhe mundësisht me na i sjell kontratën sa më parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri Thaçi e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI.

I nderuari zoti Haliti, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Ne sapo dëgjuam edhe opinionin publik, ju deputetë të nderuar, parafolësin para se të fliste e nderuara deputete Kadaj, klithma çoroditëse të mentalitetit të “Elektroprivredes” të viteve të ‘60-ta, të ekspertëve të asaj kompanie energjetike që ka qenë e nostalgjisë jugosllave, për të mos ardhur investitorë në Republikën e Kosovës.

Klithma se ju mund të bëni marrëveshje me shtetin e Kosovës, por jo me ne 4-5 veta. Është fat që bota s’i ka dëgjuar kurrë këto klithma të heshtura, të izoluara dhe me ndikim zero në opinionin publik shqiptar dhe opinion publik ndërkombëtar, miq të Kosovës. Po këta zëra të shterur e klithma të çoroditura kanë bërë thirrje edhe NATO-së që të mos vijë në Kosovë. Po këta zërat e shturur bënë klithma dhe bërtitën edhe kundër Marrëveshjes Ndërkombëtare në Rambuje. Po këta zëra u deklaruan edhe kundër bombardimeve të NATO-s, po këta zëra u deklaruan edhe kundër pranisë së SHBA-ve në Kosovë, vendeve të Bashkimit Evropian dhe prezencës së NATO-s. Po këta zëra ishin edhe kundër marrëveshjes mes Kosovës dhe ndërkombëtarëve për statusin politik të Kosovës, për bërien e Kosovës të pavarur dhe sovranë. Po ky zë shterp, i pa ndikim dhe i shkëputur nga realiteti i Kosovës demokratike dhe evropiane, u deklarua se 17 Shkurti 2008, dita kur Kosova realizoi ëndrrën e vetë historike për shtet të pavarur dhe sovran duke deklaruar pavarësinë, u deklarua se është një vendim i pavlerë. Po këta zëra u deklaruan dhe po deklarohen, dhe përpiqen ta përbuzin shtetin e Kosovës, kudo sot, në Kosovë. Po këta zëra u deklaruan dhe sot heshtin kundër ndërtimit të autostradës që afron dhe lidh si kurrë ndonjëherë në histori, Kosovën me Shqipërinë, ndërsa pretendojnë të flasin për bashkim kombëtar.

Prandaj, dëshiroj edhe të theksoj se është fat që gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallime politike dhe etnike, dhe e gjithë skena politike kosovare, me përjashtim të këtij grupi të shkëputur dhe aksidental në skenën politike kosovare, janë të orientuar dhe punojnë në realizimin e qëllimit jetik, respektimit dhe vullnetit të qytetarit të Kosovës për anëtarësim në NATO dhe Bashkim Evropian. Unë dua t’ju them se në këtë rrugë nuk do të ketë forcë që do ta ndalë popullin e Kosovës.

Dhe, po këta zëra, vetëm tri ditë më herët u deklaruan edhe me rezerva, kur e gjithë bota tregoi besim të patundur në Republikën e Kosovës, kur e gjithë bota në mënyrë unike dhe entuziaste e përkrahu përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, kur e gjithë Kosova kishte festë, këta u deklaruan se është një diçka një e parëndësishme përmbyllja e mbikëqyrjes së pavarësisë. Unë nuk dëshiroj të bëj paralele, por u dëgjuan edhe të tjerë që nuk ishin larg, apo shumë afër me deklaratimet e tyre.

Prandaj, e theksoj edhe një herë, ne do të vazhdojmë, ndërsa sa u përket politikave elektorale, shkoni në Ferizaj, në Kaçanik. Atje e keni marrë përgjigjen, do ta merrni përsëri. Prej popullit, jo prej ndonjë partie. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Sikur të ishim pa ndikim, nuk do ta kishit marrë mundin të përgjigjeshit. Pra, ju e demantoni veten sa herë që flisni, s'ka nevojë të ju demantojë dikush tjetër. Kaq inteligjencë dhe logjikë keni.

U tha që po ju ofendoj. Edhe, mos u zgërdhini! Ju thatë që po ju ofendoj. Po, nuk mund t'ju ofendoj juve, përderisa ju s'keni dinjitet. Ofendimi presupozon që subjekti në anën tjetër ka dinjitet. Unë çfarëdo konstatimi që bëj për juve, kurrë s'mund të ju ofendoj. Prandaj, nëse ju thoni që po ju ofendoj, ju po gënjeni. Nuk jam duke ju ofenduar. Jam duke konstatuar siç jeni, pra "paçavër".

Më tutje, ne nuk e kemi kundërshtuar autostradën, por i kemi kundërshtuar hajnat që po vjedhin në autostradën e kombit, në emër të kombit. Trefishi i çmimit, ju po vidhni në emër të kombit! Kjo s'ka të bëjë me asgjë kombëtare. Njësoj, Aeroportit të Prishtinës ia keni vënë emrin e komandantit Adem Jashari, e keni bërë drejtor të Bordit djalit e Hamzës, për ta shitur më shpejt e më kollaj. Ju edhe në përmendoret e dëshmorëve, vidhni në tenderë. Jeni hajna tipikë. Hajna klasikë. Tjetra: është evidente që qytetarët janë të ofenduar me këtë shitje të Distribucionit të KEK-ut, që po e bëni. Dhe, ky është një krim, për të cilin drejtësia dhe gjyqësia e një shteti të së drejtës nesër do të veprojnë mbi juve.

Kjo është e domosdoshme dhe e pashmangshme. Për këtë, ju duhet të shkoni në burg, sepse ky është krim. Të shitet për 26,3 milionë krejt rrjetin e energjisë elektrike të Kosovës, ky është krim. Prandaj, mos u zgërdhini, por bëhuni njeri serioz, se gjendja është serioze. Mos u zgërdhini, kryeministër! Nuk jeni as serioz, as i sinqertë. Ju nuk mund ta përfaqësoni qytetarin e Kosovës me këtë zgërdhirje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Mua më vjen tepër keq për këtë frustrim tuajin, Albin. Unë nuk kam ndonjë mllef për shfryrje ndaj jush se s'kam asgjë personale. Përkundrazi, ju e dini se unë e respektoj prindin tuaj, por pasi i ke dalë prej dore edhe atij, as unë nuk dua të kem punë me ty.

Unë do t'i kisha bërë disa pyetje, por kur t'i parashtroj unë ato pyetje në raport me ju, nuk do të vini më në Parlament, se nuk do të keni më fytyrë. Po, po ju kursej përsëri. Ani, ani okej! Ok, por mund të theksoj edhe një herë se nuk do të lejojmë rikthim të mentalitetit monist, komunist dhe pretendimeve diktoriale. Diktatorët po përfundojnë, së shpejti edhe në Siri, edhe mentaliteti tjetër kudo do të përfundojë. Prandaj, ne jemi të përcaktuar

për transparencë, për konkurrencë, për ekonomi të lirë të tregut, për sundimin e ligjit, ndërsa mllefet, sharjet, shpifjet e akuzat le të mbeten në ndërgjegjen tuaj, nëse të ka mbetur ende edhe pak.

Ndërsa, e theksova edhe njëherë për hir se kam respekt për babën tuaj, po të kursej. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Kryeministër,

Shumë të nderuar kolegë deputetë,

Po mundohem ta kthejmë diskutimin në temë, sepse mendoj se nëse diskutojmë për një çështje kaq të rëndësishme, vërtet duhet të mundohemi të japim përgjegje lidhur me çështjet që po i diskutojmë dhe nga ky debat të dalim me një vendim sa më të mirë të këtij Kuvendi.

Vetë privatizimi i ndërmarrjeve publike, me të drejtë zgjon interes tek aktorët e shoqërisë lidhur me shumë aspekte, sidomos me ligjshmërinë, me transparencën, me përgjegjësinë, me efektet ekonomike dhe sociale që dalin nga privatizimi. Është pozitive se Kosova e ka filluar procesin e privatizimit dhe format tjera të partneritetit publiko-privat, pasi ky është një kusht i domosdoshëm i ndërtimit të ekonomisë së tregut dhe shoqërisë demokratike. Pa këtë nuk do të mund të ketë demokraci të vërtetë.

Baza ligjore për ta zbatuar privatizimin e ndërmarrjeve publike është elementare. Është një bazë, nuk mund të themi që s'ka. Në dy ligje ekziston baza, por nga kjo bazë e mangët po dalin, jam i bindur, defektet me të cilat ne sot po ballafaqohemi. Me këtë bazë ligjore janë të njëjta dispozitat për privatizimin e ndërmarrjeve që veprojnë në sektorët, që janë shumë të ndryshëm.

Nën dy, Komitetit Ndërministror i janë dhënë kompetenca të hipertorfuara, të tepruara, nën tre Kuvendi i Kosovës e ka një rol jo të duhur, e ka një rol të vogël në procesin e privatizimit ndërmarrjeve publike, gjë që nuk është e mirë. E kemi kundërshtuar edhe atëherë. Ne sot po themi këtu, por me aprovimin e një vendimi gjeneral, Kuvendi e humb të drejtën e ndikimit. Natyrisht që Kuvendi mund ta thërrasë gjithmonë Qeverinë në interpelancë, në mocion, në raport, por Qeveria nuk është e detyruar në mënyrë automatike ta informojë Kuvendin.

Prandaj, është shumë mirë që deputetët të mendojnë kur i aprovojnë ligjet, sepse ligjet që i kemi aprovuar në të vërtetë e kanë sjellë këtë situatë dhe ne vazhdimisht kemi tërhequr vërejtjen se këto ligje nuk e sigurojnë transparencën dhe përgjegjësinë e domosdoshme për privatizimin. Pra, ne duhet të shohim, tash është pak vonë. Por, në qoftë se nuk e konstatojmë këtë problem, nesër mund të bëhet edhe më vonë.

Çështja tjetër shumë e rëndësishme kur i hymë privatizimit është çfarë mjedisi politik, çfarë mjedisi biznesor, çfarë klime investuese, sa është miqësore ajo klimë investuese që po e bëjmë. Nga kjo situatë varet se çfarë investitorësh do të jenë të interesuar të vijnë, varet çfarë konkurrence do të krijohet, varet çfarë çmimi do të arrijmë dhe si do shkojë puna pas privatizimit. Prandaj, nuk është çudi që nga ky mjedis biznesor, që vlerësohet në mënyrë kritike, dhe kjo situatë çfarë e kemi, që kemi pasur vetëm dy konkurrentë. Dhe natyrisht nga dy konkurrentë, pa konkurrencë, vjen një çmim i caktuar, dhe ai çmim me të vërtetë duket joadekuat, duket çmim i vogël.

Në krahasim me investimet që janë bërë deri tash, në krahasim me asetet që janë: ndërtesat, rrjeti, burimet njerëzore, tregu e të mos e përsëritim çka u tha sot këtu. Mirëpo, çmimi është vetëm njëri nga komponentët. Ekzistojnë edhe komponentë tjerë që mund të jenë kosto e kësaj shoqërie, por mund të jenë edhe benefite, përfitime të kësaj shoqërie. Mendoj se krahas kësaj që e thashë, defekti në këtë proces ekziston se nuk po bëhen transparente të gjitha ato që mund të jenë kosto e kësaj shoqërie dhe të gjitha ato që mund të jenë përfitimet e kësaj shoqërie në procesin e privatizimit.

Në këtë drejtim, ju lutem, unë e dëgjova sot ministrin. E kam dëgjuar edhe më herët, por ne nuk e kemi një pasqyrë të qartë. Cilat janë kostot dhe cilat janë përfitimet dhe pse përfitimet janë më të mëdha për këtë shoqëri dhe duhet shkuar në privatizim? Sepse privatizimi është i nevojshëm. Ne kemi thënë: “Duhet shkuar në privatizim, por duhet shkuar në privatizim vetëm në rastet kur përfitimet sociale janë më të mëdha se kostot sociale”. Dhe, kjo është normale. Çdo shoqëri normale, çdo Kuvend normal e aprovon një privatizim vetëm kur përfitimet sociale dhe ekonomike janë më të mëdha se kostot sociale dhe ekonomike. Ne nuk e kemi atë pasqyrë, më falni, por nuk e kemi. Së paku, unë nuk e kam parë.

Kjo duhet të bëhet transparente. Prandaj, Qeveria, natyrisht që nuk e ka obligim ta sjellë në Kuvend, sepse e kemi aprovuar atë ligj. Ne mund ta kërkojmë sot dhe Qeveria duhet t’i sjellë, prandaj unë jam në favor të asaj që të kërkojmë dhe t’i sjellë të gjitha ato. Por, Qeveria është mirë që ta arsyetojë, ta diskutojë vendimin e Këshillit Ndërministror. I propozoj Qeverisë seriozisht që ta diskutojë. Në këtë analizë, si po them unë, del para opinionit edhe thotë: “Ne e aprovojmë privatizimin. Pse? Sepse përfitimet sociale qenkan më të mëdha se kostot sociale”. Edhe duhet të na dokumentojë në qoftë se do përkrahje prej nesh, në qoftë se jo, natyrisht mund të vazhdojë.

Çështja tjetër është: Se çfarë përfitimesh do të kemi prej privatizimit, varet prej fuqisë tonë negociuese të Qeverisë dhe këtij Kuvendi. Natyrisht, ne jemi të lënduar në fuqi negociuese për shkak të situatës ekonomike sociale, tensioneve etj., etj., por fuqia negociuese ndërtohet edhe duke pasur një vlerësim, një studim fizibiliteti. Cila është ajo vlera reale, me atë studim fizibiliteti, ne mund ta matim, që ta mbrojmë interesin publik, ta mbrojmë interesin e investitorit, sepse pa i mbrojtur interesat e investitorëve ata nuk vijnë. Ne e kemi për detyrë t’i mbrojmë. Edhe duhet ta mbrojmë interesin e konsumatorëve dhe të aktorëve tjerë të interesuar.

Në qoftë se Qeveria nuk e ka atë studim, që e tregon fizibilitetin, vlerën edhe përfitimet që mund të vijnë nga ky sistem, ai është i lënduar në negociata me investitorin. Prandaj, kjo duhet të ndodhë patjetër...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Mundesh pa mikrofon. Faleminderit, zoti Mustafa. Unë dua të ju them që koha për grupin tuaj parlamentar është harxhuar dhe dua të ju përkujtoj që shumë pyetje që po ngrihen sot në Parlament, të cilat kanë pasur hapësirë kohore me muaj të tërë të bëhen, nuk janë bërë, e sot kanë qenë vetëm tri pyetje parlamentare, të cilat kanë mundur t'u shtohen shumica e këtyre që janë bërë këtu, në debat dhe kanë mundur edhe ministrat përkatës t'i japin përgjigjet e tyre konform Rregullores.

Më vjen keq që debati shumë herë po participon në fyerje, dua ta përsëris. Mendoj që po përpiqem ta mbajmë një gjendje normale të funksionimit të Parlamentit dhe është mirë të vazhdojmë me funksionimin normal të Parlamentit pa fyerje, por me të drejtën e secilit nga ne edhe të secilit qytetar që të jetë i informuar për çdo gjë dhe të jetë një kontroll i Qeverisë në rrethanat që na jep Kushtetuta, ligji dhe Rregullorja e Parlamentit. Fjalën e ka deputetja Shinik.

MUFERA SINIK:

Sayın Başkan, sayın bakanlar ve milletvekilleri,

Bugün Kosova Meclisi'nde Kosova Elektrik Şirketinin Özelleştirilmesini değerlendirirken Kosova Hükümeti tarafından yürütülen tüm ihale prosedürlerinin harfiyen yerine getirildiğini görmekteyiz.

On yıldır enerji sektöründeki eksiklikleri ve kötü yönetimi çok açık bir şekilde gördük. Bu yüzden global ekonomik koşullarında verimli çalışmaların yürütülmesi, özel sektörün sayesinde gerçekleşir. Kosova'nın bu yolda ilerlemesi, geleceği açısından kaçınılmazdır.

Az önce tartışmacılardan biri Türkiye Cumhuriyeti Hükümeti'nin seçim kampanyasında, Kosova'ya seçim desteği olarak seçmenleri uçakla getirttiğini vurguladı. Bunu söylerken konuşmacı Türkiye Hükümeti'nin savaş öncesi, savaş sonrası, bağımsızlığın tanınması konusunda da en başta olduğunu, hatta Kosova'yı tanımak istemeyen ülkelere tanınması için var gücüyle lobicilik yapmış olduğunu ve karşılıksız olarak her anlamda destek sunduğunu burada hatırlatmış olsaydı, konuşma çok daha fazla değer taşıyacaktı.

Şirketler T.C. Devlet şirketleri değil, hepsi özel Türk şirketleridir. Yersiz ve hırslı konuşan muhalefetin bazı milletvekilleri, çok iyi bilmelidir ki otoyol yapımında Amerika ortaklığı da var, bunu söylememesi hepimizi şüpheye koyuyor. Ya da havaalanı şirketinde Fransız ortaklığının bulunmasına rağmen, sadece Kosova'nın en dost ülkesi olan Türkiye gözüne batıyor olabilir mi?

Bütün ihalelerde sadece Türk şirketleri ilgi gösteriyor ise bizler Kosovalı olarak bundan gurur duymalıyız. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Berisha e ka fjalën.

SALA BERISHA - SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Unë do ta bëj nga një këndvështrim tjetër diskutimin tim të këtij dokumenti.

Roli i institucioneve të pavarura, përkatësisht agjencive që i ka themeluar Kuvendi i Kosovës në lidhje me agjencitë që quhen si rregullatorë ekonomikë, në këtë rast për këtë çështje do të ju sjell në vëmendje edhe opinionit publik, por edhe deputetëve rolin e Zyrës të Rregullatorit të Energjisë. Ligji i energjisë elektrike dhe Ligji i rregullatorit të energjisë, siç është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, e përcakton mandatin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë si një agjenci e pavarur e Republikës së Kosovës.

Ligji i definon fuqitë, detyrat dhe funksionin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, duke përfshirë kushtet për lëshimin e licencave për kryerjen e aktiviteteve të energjisë, kriteret për rregullimin e tarifave që i definojnë të ardhurat e kompanive të licencuara, monitorimin dhe parandalimin e abuzimit të çdo pozicioni dominant dhe praktikave antikonkurruese nga kompanitë e energjisë. Kjo sigurisht do të jetë një përgjigje në pyetjet që i shtruan disa nga deputetët për paragjykimin se do të krijohet një monopol në Kosovë.

KEK-u është kompani që u nënshtrohet rregullave të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Secili divizion i KEK-ut, mihjet, prodhimi, distribucioni dhe furnizimi u nënshtrohet këtyre rregullave. Pas privatizimit, kompania kosovare për Distribucion dhe Furnizim me energji do të vazhdojë të mbetet kompani që duhet t'u nënshtrohet rregullave nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Kjo kompani do t'i përmbajë të dy divizionet: Distribuimin dhe Furnizimin publik. Divizioni i Distribuimit është një monopol natyral, ndërsa Divizioni i Furnizimit publik është monopol ligjor dhe në bazë të obligimeve ndaj traktatit të energjisë do të hapet në janar të vitit 2015.

Secili nga këto divizione do të jetë pjesë e rregullimit nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në pajtueshmëri me Ligjin për rregullatorin e energjisë. Prandaj, nuk ka ndryshime në fuqinë e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për ta rregulluar divizionin e kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji, si rezultat i privatizimit të saj. Privatizimi i KKDFE-së nga perspektiva rregullative vetëm ka rezultuar me ndërrimin e pronarit të aksioneve. Sektori i Distribuimit dhe Furnizimit në Kosovë i përcjell strukturat normale të industrisë që ndërlidhen me distribuimin e energjisë elektrike. Ky sektor kërkon shuma të mëdha të investimeve. Të cilat mund të arrihen me kosto më të ulët nga një kompani private, si investitor serioz. KEK-u aktualisht është i obliguar ta kryejë shpërndarjen e energjisë elektrike te konsumatorët.

Si rezultat i privatizimit, këto të drejta dhe obligime do të transferohen te kompania e Kosovës për distribuim dhe furnizim të energjisë. Kjo kompani do t'u nënshtrohet rregullave të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për të siguruar që kostot e shkaktuara të jenë të arsyeshme dhe të lejuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Zyra e Rregullatorit të Energjisë vendos rregullat e definuara të tarifave për këtë qëllim. Kjo

nënkupton se shuma të cilën do ta investojë kompania në të ardhmen, fillimisht do të arrijë marrëveshje me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, si rregullatorë ekonomik. Njëkohësisht për nivelin e shpenzimeve operative, të cilat do t'i ketë, duhet të pajtohet po ashtu me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe këtu bëjnë pjesë edhe shpenzimet e pagave.

Së fundi, edhe kthimi në investim dhe niveli i fitimit është njëri nga faktorët për të cilin Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të vendosë dhe kompania private është e obliguar gjithsesi ta implementojë këtë vendim. Në përfundim, Divizioni i Distribuimit dhe Shpërndarjes së kompanisë në fjalë do t'u nënshtrohen rregullave të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në të njëjtën mënyrë, sikur i nënshtrohet sot Divizioni i Distribuimit dhe Furnizimit të KEK-ut. Pa marrë parasysh se është kompani publike apo private, fuqitë e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, që e ka themeluar Kuvendi për t'i rregulluar këto divizione, nuk do të ndryshojnë, dhe për këtë arsye brengat se kompania private do të abuzojë me pozitën e saj të monopolit duhet të analizohen nga baza rregullative, të cilën e ka nxjerrë ky Kuvend.

Bazuar në fuqitë, të cilat i ka Zyra e Rregullatorit të Energjisë, mendoj se fuqizimi i mëtejshëm i këtij institucioni, sigurimi i asistencës së vazhdueshme teknike dhe mbikëqyrja e plotë nga Parlamenti i Kosovës janë më se kritike dhe të nevojshme për funksionimin e duhur të sektorit të energjisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu. Një minutë e gjysmë, deputete!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Dihet se njëra ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit, përveç PTK-së, Hekurudhave, është edhe Korporata Energjetike e Kosovës.

Shitja e Distribuicionit të KEK-ut për 10% të vlerës së investimeve, pa e llogaritur vlerën reale, vlerën kontabël, vlerën ekonomike, në të vërtetë është e pakuptueshme. Në këtë privatizim të rrjetit të Distribuicionit dhe Furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës është një tjetër hap i ngutshëm i Qeverisë edhe i njëjti po bëhet në kohë dhe në mënyrë të gabuar, e kjo do ta dëmtojë rëndë ekonominë e vendit. Meqenëse energjia është sektori më i rëndësishëm jetik për vendin dhe qytetarët, mungesa e një ministrie që përkujdeset në mënyrë të veçantë për sektorin energjetik nga Qeveria e Kosovës, tregon se qasja ndaj këtij sektori paraprakisht ka qenë tendencioze.

Me keqardhje mund të konstatojmë se KEK-u nuk e ka pasur mbështetjen e duhur institucionale, sidomos në segmentin e gjykatave, dhe si pasojë borxhi i grumbulluar është marramendës. Si mund të shitet një ndërmarrje me këtë çmim qesharak, kur sipas ekspertëve vetëm ndërtesa kryesore në Prishtinë mund ta mbulojë këtë çmim. Ku janë asetet tjera nëpër Kosovë? Gjatë këtij procesi as që është marrë për bazë problemi tjetër që ka pasur KEK-u dhe institucionet e Kosovës, të cilat asnjëherë nuk kanë arritur ta shtrijnë kontrollin në gjithë territorin e Kosovës. Ku i ka Distribuicioni asetet e veta? Është tepër e çuditshme që ky problem nuk ka qenë shqetësim për investitorin e ri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dua që para se të paraqitet diskutuesi i radhës, të ju kërkoj mundësisht një bashkëpunim ndërmjet kryetarëve të grupeve parlamentare që të bëhemi gati para votimit lidhur me mocionin. Nëse ka mundësi, të harmonizohen qëndrimet. Ne e kemi edhe një mocion që e ka sjellë Grupi Parlamentar i LDK-së, që besoj se mund të diskutohet në një seancë të radhës. Sot po diskutohet për një mocion tjetër.

Fjalën e ka zoti Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit!

I nderuari kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarët që tani duhet ta dinë se do të jenë në mëshirën e investitorit privat sa i përket furnizimit me energji dhe çmimin që do ta paguajnë për energjinë.

Në këtë mënyrë u paralajmërua qytetari dhe Qeveria e Kosovës në një komunikatë të LDK-së, të datës 13 prill 2012. Për pasojat që do ta godasin atë nga procesi i privatizimit të Distribucionit të energjisë elektrike. Kuptohet, nëpërmjet kësaj komunikate, LDK-ja pati kërkuar që privatizimi të stopohet derisa nuk sigurohet transparenca e plotë e këtij procesi në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, duke siguruar që tregu të jetë i hapur për ofertat e të gjithë të interesuarve.

Mirëpo, Qeveria e Kosovës nuk dëgjoi fare për paralajmërimet e opozitës dhe të ekspertëve të energjetikës, por, e shtyrë nga interesat e grupeve të ngushta, në fillim të qershorit e shpalli të përfunduar procesin e privatizimit të një pasurie kombëtare dhe të një shërbimi që nuk lë alternativë tjetër për konsumatorët dhe bizneset kosovare. Me plot të drejtë dominon vlerësimi i përgjithshëm se ky privatizim ishte në kundërshtim me interesat e Kosovës dhe i dëmshëm për qytetarët e saj, sepse është e palogjikshme dhe e pakuptueshme që një aset të jetë vital për popullin e Kosovës, në të cilin vetëm në disa vitet e fundit nga kjo Qeveri, nga paratë e taksapaguesve kosovarë, janë investuar afro 200.000.000 euro, të shitet për vetëm 26.000.000 euro. Se ky proces i privatizimit ishte i dyshimtë, i përcjellë me plot parregullsi dhe jo në pajtim me parimet e ekonomisë së tregut të lirë, tregoi në radhë të parë emri i kompanisë fituese “Limak & Çalik”, për të cilën në tërë Kosovën ishte përfolur pothuajse muaj më parë se do të jetë fituese e këtij tenderi, e më pastaj edhe vetë çmimi i jashtëzakonisht i vogël, që paraqet një befasi të llojit të posaçëm. Pra, vetëm 26.000.000 euro, apo çmim 10 herë më i vogël se sa çmimi i privatizimit të asetit të njëjtë në shtetin e Maqedonisë, ku janë inkasuar për Distribucion 225.000.000 euro.

Pra, kushtimisht thënë, falja e këtij margaritari të çmueshëm për vetëm 26.000.000 euro e paraqet goditjen e parë të rëndë për qytetarin edhe ashtu të varfër kosovar. Goditje të dytë paraqet monopoli që do të krijohet për të gjitha shtresat e popullatës së Kosovës, e sidomos për të varfrit, që përbëjnë thuajse mbi gjysmën e kësaj popullate. Kurse, goditja e tretë ishte njëra prej pasojave të privatizimit, e cila u paraqit 15 ditë pas privatizimit në

formë të shtrenjtimit të rrymës në mënyrë retroaktive për 8,9%, e cila është bërë kryesisht për t'i krijuar favore investitorit privat.

Pra, të gjitha këto veprime po tregojnë se Qeveria nëpërmjet proceseve të privatizimit e ka keqpërdorur pasurinë kombëtare dhe në të njëjtën kohë po i mbulon lëshimet e paraqitura nga planifikimet jo të drejta të buxhetit të saj. Kurse e tërë barra e paaftësisë të kësaj Qeverie bie mbi qytetarët e Kosovës, të cilët, kundër vullnetit të tyre, janë sjellë në një gjendje tejet të rëndë ekonomike, me një papunësi mbi 45% dhe me një varfëri ekstreme, me rreth 18%.

Kjo rritje e çmimit të energjisë elektrike do ta ngarkojë tej mase buxhetin edhe ashtu të stërngarkuar të familjeve kosovare, të cilat me nivel tejet të ulët të të hyrave familjare edhe ashtu mezi janë duke e përballuar pagesën e artikujve të konsumit të gjerë, përfshirë këtu edhe energjinë elektrike. Aq më keq, ekonomia e tregut tregon se rritja e çmimit të rrymës ndikon drejtpërdrejt jo vetëm në rritjen e çmimeve të artikujve tjerë energjetikë, si: drurit, thëngjillit dhe lëndëve tjera djegëse, por ndikon në mënyrë zinxhirore edhe në çmimet e artikujve të tjerë ushqimore, përfshirë këtu edhe bukën, e cila dita-ditës për shumë familje kosovare është duke mbetur artikulli i vetëm me të cilin po ushqehet qytetari i rëndomtë kosovar.

Aq më keq, sipas ekspertëve të ekonomisë, rritja e këtyre çmimeve nuk do të shkojë as në favor të zhvillimit ekonomik, por përkundrazi do të ketë ndikim negativ në ekonominë kosovare, sepse do të sjellë telashe për shumë sektorë të ekonomisë dhe për mirëqenien sociale të popullatës kosovare, në përgjithësi. Pra, nuk ka fije dyshimi se pikërisht çmimi i ri i energjisë do të nxisë shtrenjtimin e artikujve të tjerë të konsumit, kurse edhe me shumë do ta dobësojë fuqinë blerëse të qytetarit tonë, me çka do të rrezikohen, në radhë të parë, bizneset e vogla dhe të mesme, gjë që do ta shpjerë shoqërinë tonë në drejtim të një krize tejet të rëndë ekonomike.

Andaj, është mirë që kjo Qeveri ta rishqyrtojë edhe një herë procesin e privatizimit të Distribucionit, si dhe ta anulojë vendimin për rritjen e çmimit të rrymës dhe në këtë mënyrë të tregojë sadopak kujdes dhe mirëkuptim për brengat dhe problemet esenciale të jetesës së qytetarit kosovar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Hadërgjonaj, nuk është. Deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Do të kisha filluar me një tregim të vërtetë lidhur me Distribucionin. Pse unë e përkrah dhe ç'ndodh sot çdo ditë në praktikë.

Gjatë dimrit të kaluar ishte një dimër shumë i fortë. Disa fshatra të një zone, ku unë e kisha një zonë elektorale, kishin rënë në errësi dhe pas intervenimit që të ndërhyhet te KEK-u, arsyetimi i KEK-ut ishte se kjo kërkon një procedurë të gjatë të prokurimit, nuk kanë pajisje të tilla që të zëvendësohen dhe në këtë mënyrë ata, për çudi, në atë dimër e

kishin një errësirë shumë të gjatë dhe sot Distribuimi, sikur të kishte ndodhur vetëm në këtë regjion, ose në Evropë, vetëm në Republikën e Kosovës, ne do ta kishim bërë temë.

Unë jam duke u çuditur pse askush nuk bën krahasime pse është bërë në shtetet tjera dhe pse edhe ne po e bëjmë dhe cilat janë benefitet, edhe sociale edhe ekonomike, edhe atraktuese për investitorët. Qeveria e Kosovës dhe ky Parlament kanë krijuar edhe bazë ligjore, edhe analizë paraprake, që ky distribucion duhet të privatizohet dhe se është në të mirën e ekonomisë, është në të mirën e zhvillimit të vendit. Kundërshtimet e pabaza që bëhen sot dhe që nuk dëgjohen nga kolegët tanë, duke u përdorur një fjalor i egër, i rrugaçerisë nga disa deputetë këtu, mendoj që nuk krijojnë as kushte të mira të relacioneve ndërshtetërore, as ndër-regjionale, sepse në këtë Parlament janë sharë shumë shtete, fillojnë të shahen shumë shtete, të ofendohen, të frikohen shumë investitorë, por unë u garantoj, në emër të Partisë Demokratike dhe elektoratit, që këta zëra, të cilët mendojnë që ta frikojnë privatizimin janë të dështuar dhe janë të gjykuar për dështim. Privatizimi i Distribuimit dhe kontestimi i privatizimit, po ashtu edhe i asetëve tjera, siç është posta, e kanë një qëllim dhe një prapavijë të errët, sepse me këtë kundërshtim, ata që po kundërshtojnë, po mundohen t'ia ulin vlerën, e jo Qeveria, e cila e ka për obligim dhe sot merr krahasimin për shembull edhe te Posta-Telekomi, meqë kemi edhe një "provajder", i cili e konkurrin dhe ia ka ulur çmimin, siç është IPKO-ja. Kualiteti i saj është duke rënë ditë për ditë dhe çdo vonesë që bën Qeveria, do t'ia ulë vlerën.

Prandaj, fare në fund, meqë është fundi i seancës për këtë pikë, ftoj deputetët, të cilët vërtet mendojnë në të mirën e vendit, në të mirën e zhvillimit, për analizën e një mocioni, i cili ka nuanca të një majtizmi ekstrem, po ashtu edhe një mocion tjetër kontra, i cili është vetëm ad hoc, sa për të thënë se e kemi një "kontra-partë", të mos votohen, por të përkrahet Qeveria dhe të vazhdohet me obligimet dhe detyrat tjera, të cilat janë të parapara me plan dhe me strategji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

E mora fjalën edhe si deputet për shkak se vërtet disa gjëra që i dëgjova këtu, edhe nga deputetët e partisë në pushtet, por edhe nga ministri e kryeministri, janë gjëra të cilat nuk përkrijnë fare, jo vetëm me realitetin në Kosovë, por madje as me një logjikë të thjeshtë të një njeriu që i ka mbushur pesë vjet, e që i ka mësuar edhe disa shkronja.

Pra, këta për nga dija po më duken që janë nën të. Por, përveç kësaj janë edhe të pavërteta, pra ka shumë edhe gënjeshtër, që u shfaqën në disa raste. Kisha filluar nga ajo që e tha ministri më herët në adresimin e tij Kuvendit për Distribucionin. Tha që sindikatat e KEK-ut e përkrahin këtë proces, edhe tha që një pjesë e shoqërisë civile e përkrah këtë proces, që është rrena më e madhe që ka mund ta bëjë sot. Nesër bën vaki e tejkalon, veç sot s'ka mundur të bëjë rrenë më të madhe.

Derisa ne jemi këtu, sindikatat e KEK-ut kanë lëshuar komunikata për shtyp, me të cilat thonë që ky proces i privatizimit është mjerim. E kanë quajtur mjerim. Pra, nëse ata e përkrahin mjerimin, ndoshta edhe ka të drejtë ministri. Por, unë nuk mendoj që ka ndonjë

njeri, që ka një fije truri, e që e përkrah mjerimin, përveç kësaj Qeverisë sonë që e përkrah mjerimin e të tjerëve.

Çështja tjetër është, derisa ne po flasim këtu ajo që quhet “Complayas Adviser”, ombudsmeni, njëfarë një lloj ombudsmeni i Bankës Botërore është duke planifikuar ta nisë një proces të auditimit të këtij procesi të privatizimit, duke u bazuar nga kërkesa e Sindikatës së KEK-ut, e cila e kanë ngre çështjen e mosrespektimit të politikave mjedisore dhe politikave shoqërore që i ka Banka Botërore karshi projekteve energjetike. Edhe tash, kjo kompani nga atje, pra ky auditor, do ta auditojë tërë procesin për ta vlerësuar nëse kjo është e vërtetë apo jo, këtë që e ka ngre Sindikata e KEK-ut, këta që sipas ministrit po u pajtuakan me këtë proces të privatizimit.

Një çështje tjetër, që po ashtu u tha edhe nga ministri, por edhe nga shumë deputetë, domethënë njëra prej çështjeve që më së shumti u rreh këtu, përveç asaj e cila ka konkurrencë apo jo, është çështja e Rregullatorit. Pra, po na thuhet që deri sot kur ka qenë Distribucioni në pronësi publike, Rregullatori nuk ka mundur të bëjë asgjë, ama nesër kur të privatizohet, Rregullatori do të na bëhet i shkëlqyeshëm. Pra, do ta kontrollojë aq mirë këtë kompani, sa këta s’do të mund të lëvizin. E deri sot ia paskemi falë, meqenëse paska qenë kompani publike, me gjasë.

Pra, ky Rregullator i cili nuk ka as dy javë që e rriti çmimin e energjisë elektrike, duke u bazuar në kërkesën, natyrisht, tash për tash informale të kompanisë, e cila është e interesuar ta blejë rrjetin e shpërndarjes, pra kompaninë kosovare për Distribuim dhe Furnizim. Çështja tjetër është konkurrenca. Madje, edhe kryeministri e tha atë që e bën këtë Qeveri edhe më të pashpresë. Tha “ka konkurrencë”. Pra, rrjeti edhe furnizimi po i shiten një kompanie, dhe kjo po quhet konkurrencë. Me kë do të konkurrojnë, “Çaliku” me “Limakun”? A është ajo konkurrenca? Se kjo është konkurrenca e vetme e mundshme në këtë rast. Po ashtu, një çështje që ka të bëjë me konkurrencën që lidhet me këtë rast, por jo vetëm në këtë rast, që shtrihet edhe në sektorë tjerë të ekonomisë, që duhet ne ta kemi parasysh: “Çaliku” është aksionari më i madh i BKT-së, Bankës Kombëtare Tregtare, që vjen nga Shqipëria, e që ka degë edhe në Kosovë. Ndërkohë që “Limaku”, të gjithë e dimë, e ka marrë në koncesion Aeroportin për 20 vjet. Aeroporti, Distribucioni, e nesër Posta dhe Telekom i Kosovës, veçanërisht Telekom, konsiderohen të jenë ajo që quhet “makinë e parave”, për shkak se gjenerojnë “kesh” brenda ditës në nivel shumë të madh. Kur e kemi këtë prani kaq të madhe të këtyre dy kompanive, në këto kompani kaq të rëndësishme që gjenerojnë “kesh” dhe po ashtu një bankë, e cila mund të bëhet shumë e rëndësishme në Kosovë, atëherë këta, jo vetëm që e monopolizojnë energjinë dhe fluturimet, por po e monopolizojnë edhe sektorin financiar gradualisht.

Edhe ata që i kontrollojnë energjinë edhe financat, të jeni të bindur, deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e kontrollojnë shtetin. Kot kemi për të bërë ne ligje këtu, siç ka qenë disa herë kote dhe deri sot që kemi bërë ligje. Një çështje tjetër që u përmend këtu, ministri tha: “Do të ketë reduktim të humbjeve”. Por, plani qenka i tillë, që në vitin e parë të jetë 3% të humbjeve teknike, e pastaj do të shkojë nga 2% për vit. Kështu e tha ministri, ndërkohë që në secilin raport të ZRRE-së, që na vjen, tregohet që

deri tash ka pasur ulje të humbjeve teknike deri në 2%, varësisht prej vitit, por mesatarisht 2%.

Pra, prejse e ka marrë Qeveria e Hashim Thaçit në dorë pushtetin, pra prej vitit 2007, na kanë thënë që i kemi zbritur për çdo vit humbjet teknike. Edhe unë them shumë mirë që i paskemi zbritur. Ju përgëzoj për këtë, por çka po dallon tash me privatizim. Nëse vazhdimisht do të ketë zbritje të humbjeve teknike për 2%, atëherë këtë nuk po e bëka kapitali privat, se këtë e paska bërë edhe kompania publike. Pra, nuk qenka ndonjë çudi që po na ardhka prej kapitalit privat. Dje e kemi pasur në komisionin tonë për raportim zëvendëskryeminstren për Tregti dhe Industri, zonjën Mimoza Kusari-Lila. Pyetja ime e thjeshtë ka qenë kështu: “Në rastin e ‘Sharrcemit’, a është e vërtetë që ka dështuar efikasiteti i kapitalit privat, meqenëse po thoni që kapitali privat është gjithnjë efikas”. Tha “po, edhe jo domosdoshmërisht kapitali privat është efikas”. Tash unë e pyes ministrin, vartësin e saj në këtë rast: A do të jetë ky kapitali privat në Distribucion aq efikas, meqenëse në prodhimin e çimentos na doli se nuk ishte?

Tjetra, u përmend këtu subvencioni. Ju kisha lutur, deputetë të nderuar, por edhe juve ministra, që ta konsultoni fjalorin kur flitni. Mos u jepni kuptime tjera se nuk mund ne këtu në Kuvend t’ua ndryshojmë kuptimin fjalëve. Subvencioni është shumë i qartë. Subvencion është kur e ndihmon një kompani me financa për ta tejkaluar një periudhë të caktuar të vështirësive ekonomike, që ajo mund t’i ketë. Dhe, tash po thuhet: “Ne nuk mund ta financojmë, ta subvencionojmë KEK-un”. Mirëpo, kemi mundur ta subvencionojmë pesë vjet “Ferronikelin”, mu energjinë elektrike të “Ferro nikelit”. Kemi mundur ta subvencionojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Deliu.

BLERTA DELIU - KODRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolege edhe kolegë deputetë,

Zoti Muja e përmendi tërthorazi përvojën e rajonit në këtë proces të privatizimit. Unë do të ndalem te privatizimi i kompanive të distribuimit në rajon dhe nëse këtë proces të privatizimit po tentojmë ta quajmë “proces të mjerimit”, siç edhe u tha më herët, atëherë po i bie që shumë vende të rajonit tashmë, apo edhe vende të Evropës Juglindore veç janë futur në këtë proces të mjerimit. Për të mos i përmendur edhe vendet e rajonit, siç janë Shqipëria dhe Maqedonia, të cilat tashmë veç e kanë kryer këtë proces të privatizimit. Këto privatizime të gjitha kanë synuar edhe tejkalimin e një sërë problemesh që ndërliken me sektorë, përfshirë këtu nivelin e lartë të humbjeve teknike dhe joteknike nga defektet në shpërndarje, në faturim dhe inkasim, si dhe vështirësitë për t’u përballur me vjedhjet e energjisë elektrike.

Këto çështje, apo më mirë të themi këto përvoja, me të cilat janë ballafaquar vendet tona kanë ndikuar në përmirësimin e këtyre defekteve të sektorit, të cilat kanë qenë edhe shkak

kryesor për marrjen e vendimit të Kuvendit numër 03-074, për privatizimin e Distribuimit dhe Furnizimit të KEK-ut, siç është bërë edhe në vendet e tjera të rajonit, të cilat kanë kaluar nëpër të njëjtën përvojë. Çmimet e ofruara nga investitorët do të varen edhe nga disa detaje specifike të secilit transaksion, përshirë këtu të ardhurat që priten të lejohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji që kanë mbikëqyrje mbi bizneset që privatizohen dhe nga niveli i riskut që investitorit i kërkohet ta pranojë.

Andaj, asnjë transaksion nuk krahasohet drejtpërdrejt me transaksione të tjera, siç nuk mund të krahasohet asnjë privatizim drejtpërdrejt me privatizime të tjera. Është e mundshme, për shembull, të jepet një shikim i përgjithshëm i faktorëve që kanë ndikuar në këto çmime. Nëse ndalemi te Shqipëria, do të thotë “Cezi”, kompani nga Republika Çeke, ka blerë aksione kompanisë me një shumë prej 114 euro për konsumator. Po ashtu, në Shqipëri, e njëjta kompani ka pasur 1.000.000 konsumatorë. Qeveria ka ofruar garanci shtetërore për implementimin e metodologjisë tarifore dhe obligime të tjera. Kjo ka pamundësuar Qeverinë e Shqipërisë në implementimin e reformave të mëtejshme. Njëkohësisht është ofruar edhe një garanci shtesë nga Banka Botërore, në vlerë prej 60.000.000 euro. Veç prania e këtyre garancive ka rezultuar me probleme pas privatizimit, sepse edhe kur kompania nuk i përmbush obligimet e saj, atëherë thirret në garanci, të cilën mund ta kërkojë në çdo kohë.

Borxhi i keq ka qenë 14% në momentin e privatizimit dhe i tëri kthehet në tarifa, ndërsa humbjet kanë qenë 32%. Nuk është privatizuar Korporata Energjetike e Shqipërisë, e cila ka për detyrë hyrjen në kontrata afatgjata për blerjen e energjisë. Pjesë e privatizimit kanë qenë edhe asetet 110kW. Nëse ndalemi te Maqedonia, kompania austriake “EVN” ka blerë me çmim mesatar prej 230 euro për konsumatorë. Pjesë e pakos tenderuese kanë qenë edhe disa hidrocentrale me 14 MW fuqi dhe mundësi dhe mundësi për rritje. Garancia shtetërore, por edhe mbulimi i rrezikut nga BERZH-i, duke rezultuar në probleme të njëjta, si në Shqipëri. Niveli i humbjeve ka qenë 27%, kurse borxhi i keq 28%. Mundësia e mbledhjes së borxhit të keq është shumë më e mirë, sepse është definuar konsumatori, por edhe niveli i borxhit.

Për kompaninë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji, konsorciumi “Çalik & Limak” ka ofruar një çmim prej 26,3 milionë për 100% të aksioneve të kësaj kompanie. Përpos kësaj, “Çalik & Limak” do të ndërmarrë një nivel të konsiderueshëm të investimeve edhe në sistemin e distribuimit të Kosovës për ta zvogëluar kështu edhe nivelin e humbjeve teknike. Nëse “Çalik & Limak” i përmbahet planit zhvillimor të rrjetit KEK për vitin 2010, që kërkon së paku 100.000.000 euro investime të reja ndërmjet viteve 2012-2014, zotimi i përgjithshëm i kësaj kompanie në distribuimin e kompanisë do të jetë 126.000.000 euro, që jep një çmim mesatar, 300 euro për konsumator.

Mirëpo, nevoja për investim në Kosovë është shumë më e lartë se në të gjitha shtetet e tjera të rajonit, për të cilat fola paraprakisht.

Njëkohësisht, Qeveria nuk ka ofruar garanci shtetërore që do ta reduktonte koston për Buxhetin e Kosovës dhe do të mundësonte zhvillim të reformave edhe në vitet që vijnë në sektorin e energjisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në Kosovë niveli i humbjeve komerciale dhe teknike është shumë më i lartë, do të thotë është 37% në periudhën e viteve 2011-2012. Po ashtu, nëse ndalemi të borxhi i keq, që është më i lehti për t'u inkasuar, në Kosovë është 10%. Mirëpo, prej kësaj vetëm 5% pranohen nga Rregullatori si kosto dhe, së fundi, në Kosovë është privatizuar furnizuesi publik që ka obligime lidhur me furnizimin e qytetarëve dhe duhet po ashtu të hyjë në kontrata afatgjata për blerjen e energjisë, që paraqet një rrezik të madh komercial për kompaninë.

Dhe, krejt në përfundim, çmimi që është ofruar nga konsorciumi "Çalik & Limak" është i arsyeshëm, kur merret parasysh edhe niveli i pritur i investimeve, si dhe ruajtja e Buxhetit të Kosovës nga obligimet kontingjente. Faleminderit!

(Diskutim i deputetes S. Hadërgjonaj, i dorëzuar me shkrim)

SAFETE HADËRGJONAJ: Me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës është paraparë mundësia e privatizimit të divizioneve të Distribuimit dhe Furnizimit të KEK-ut, në mënyrë që: a) Të rritet eficientia dhe qëndrueshmëria financiare e sektorit të energjisë dhe b) të eliminojë obligimet financiare të Qeverisë së Republikës së Kosovës për subvencionimin e sektorit të energjisë.

Eksperiencia nga shtetet e ndryshme tregon për disa probleme kritike në këtë proces dhe është shumë e rëndësishme që Qeveria e ka marrë parasysh mënyrën më të mirë të evitimit të rreziqeve në këtë proces.

Privatizimi i KKDFE (Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim) është strukturuar ashtu që të përkojë me kërkesat për rritjen e eficientës dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit të energjisë elektrike. Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka vendosur lidhur me 1. Rregullat për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara dhe 2. Targetet për Reduktimin e Humbjeve.

Ndryshe nga shumë shtete në rajon, Qeveria ka alokuar gjithë rrezikun komercial të kompania private. Kjo do të thotë se në Kosovë, në rast se kompania nuk mund t'i arrijë targetet e caktuara nga Rregullatori, atëherë do ta bartë vetë koston.

Në shumicën e shteteve në rajon, qeveritë kanë ofruar për investitorët garanci shtetërore. Këto garanci, të cilat janë borxh publik dhe paraqesin rrezik për buxhetin shtetëror, garantojnë performansën e disa institucioneve publike, përfshirë Qeverinë, Rregullatorin apo gjykatat. Përveç garancisë shtetërore, po ashtu ka edhe garanci që janë dhënë nga institucionet multilaterale financiare - si për shembull në Shqipëri, Banka Botërore e ka dhënë një garanci të pjesshme në vlerë prej 60 milionë euro. Përderisa këto garanci sigurojnë një çmim më të lartë në shitjen e aksioneve, ato gjithmonë rezultojnë në një rreth vicioz, ku pamundësia e kompanisë në menaxhimin e rreziqeve komerciale rezulton në rrezik për buxhetin shtetëror.

Sa u përket subvencioneve të Qeverisë së Kosovës, është me rëndësi të theksojmë se nëpërmjet këtij privatizimi nuk do të ketë asnjë subvencion për kompaninë private. Për arsye se KEK-u nuk prodhon energji të mjaftueshme për ta mbuluar kërkesën, atëherë është krijuar një mekanizëm për mundësinë e subvencionimit të KEK-ut për të blerë energji, mirëpo ky nuk është obligim ndaj kompanisë private, por një zgjidhje që do të bëhet në baza vjetore.

Andaj, qëllimi parësor i privatizimit që është rritja e efikasitetit të sektorit të energjisë elektrike për të përfituar konsumatorët fundorë dhe eliminimi i subvencioneve të Qeverisë do të arrihet me kohë me privatizimin e divizioneve të Distribuimit dhe Furnizimit të Kompanisë Kosovare për Distribuimin dhe Furnizimin me Energji.

Sa i përket çmimit që do të paguhet nga ofertuesi i preferuar për KKDFE - çmimi blerës i arritur gjatë privatizimit - është përcaktuar nga rregullat për tarifën e vendosura nga ZRRE-ja. Rregullat e tarifave definojnë të ardhurat e privatizuesit të KKDFE-së dhe fitimi që do t'u lejohet ta kenë. Vlera që investitorët vendosin për KKDFE-në do të përcaktohet fundamentalisht nga të ardhurat që lejohen nga ZRRE-ja. Nëse ZRRE-ja do ta përcaktonte nëpërmjet rregullave një kthim më të madh në investim, atëherë sigurisht se edhe çmimi i shitjes do të ishte më i lartë.

Andaj, është ZRRE-ja që në esencë ka përcaktuar se sa është vlera e divizioneve të KKDFE-së dhe çka investitorët janë të gatshëm të paguajnë.

Sa do që ka rëndësi çmimi që do të paguhet për blerjen e KKDFE-së, me rëndësi të madhe janë investimet që planifikohen të kryhen në sektor nga investitori brenda divizioneve të Distribuimit dhe Furnizimit. Këto investime e sigurojnë bazën që në Kosovë të zhvillohet një sistem eficient i distribuimit që lejon zhvillimin e shërbimeve kualitative me furnizim të energjisë elektrike.

Vendimi për privatizimin e KKDFE-së nuk është ndërmarrë për ta arritur çmimin më të lartë për privatizimin e divizioneve të KEK-ut. Por, vendimi për privatizimin e KKDFE-së është bërë në mënyrë që ta ngrëjë efikasitetin e sektorit të energjisë elektrike dhe ta reduktojë ekspozimin financiar të Qeverisë së Kosovës në këtë sektor. Këta objektiva do të arrihen me privatizimin e KKDFE-së.

*Safete Hadërgjonaj,
(GP i PDK)*

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Konstatoj që debati me deputetët ka përfunduar. Fjalën e ka zoti Beqaj që ta arsyetojë dhe t'i japë përgjigjet e tij në çështjet që janë ngrehur në debat. Zoti Beqaj, e keni fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuari kryeministër,
Ministra,

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni t'i falënderoj të gjithë deputetët sot për këtë kontribut, për trajtimin nga këndvështrimet e ndryshme të procesit të privatizimit të Distribucionit në Republikën e Kosovës. Edhe njëherë dua të theksoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme të konstatohet se ky është proces konform standardeve më të larta ndërkombëtare, respektivisht proces i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë e vë në funksion Zyrën për Rregullatorin e Energjisë, e cila është institucioni suprem i rregullimit të tregut të energjisë. Çdo transaksion, në këtë rast, ky transaksion dhe investitori privat në të ardhmen do t'i nënshtrohet të gjitha rregullave nga Rregullatori dhe ka për obligim për blerjen e tërë energjisë, e cila prodhohet në Republikën e Kosovës sipas tarifave të cilat përcaktohen nga Rregullatori.

U bënë krahasime lidhur me rajonin. Dëshiroj t'i falënderoj, sepse kishte edhe përgjigje në tërë këtë. Nëse flasim vetëm për rastin e Maqedonisë, Distribucioni ka përfshirë edhe 110kW, ka përfshirë edhe hidrocentralin prej 40mW, ka përfshirë dhe një pjesë të borxheve, që është afro 30%, të cilat u janë shitur dhe asnjë nga këto asete nuk janë në listën e asetëve, të cilat janë në proces për t'u shitur. Dua të them që i tërë rrjeti i shitur pa dallim në aspektin ku gjendet ajo, a gjendet në veri apo në jug, e kemi një qasje gjithëpërfshirëse të Republikës së Kosovës. Ndërsa, lidhur me transparencën, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, unë e kuptoj që transparenca nënkupton ndarjen e informacionit dhe gatishmërinë e plotë për ta marrë atë informacion dhe për ta kuptuar.

Dua të ju rikujtoj edhe njëherë që unë disa herë kam marrë pjesë personalisht në Komisionin për Zhvillim Ekonomik të Parlamentit, ku e kam shpjeguar në detaje tërë këtë proces. Ka pasur debate publike, të organizuara nga Zyra e Rregullatorit, debate publike që janë mbajtur në Kuvend. Ka qenë e hapur dhoma për informim publik, e shumë e shumë informacione të tjera, të cilat janë shpërndarë. Lidhur me sindikatat, dua t'ju them se Sindikata për Distribucion e ka përkrahur, e përkrah dhe kemi konstatime të përbashkëta, kemi deklarata të përbashkëta dhe kontratat e punëtorëve, sepse u tentua në një formë të jepet një informim ndryshe. Kontratat e punëtorëve, edhe kontratat afatshkurtra, edhe ato dymujore, tremujore e gjashtëmujore janë shndërruar në kontrata me afat prej 3 vjetësh, të cilat garantojnë brenda kësaj periudhe, e kjo do të jetë në kontratën, të cilën investitori do ta nënshkruajë.

Unë po e shoh që ka edhe kërkesa tjera, posaçërisht nga Grupi i Lidhjes Demokratike, çështje të cilat janë ngrehur sigurisht që pas këtij procesi ne do të mbetemi në obligim për t'i ofruar edhe Kuvendit, edhe LDK-së, të gjitha informatat, të gjitha dokumentet. Po ju ftoj edhe njëherë, të gjitha dokumentet janë në dhomën publike, e ne jemi të gatshëm për t'i ndarë të gjitha këto informata me juve dhe me gjithë palët e interesuara, sikur kemi qenë deri më tani dhe i kemi vendosur të gjitha këto informata në dhomën e informimit publik.

Unë edhe njëherë dua t'ju falënderoj, sigurisht që konceptet janë koncepte. Ekonomia e tregut është proces, në të cilin Qeveria e Kosovës është e përkushtuar dhe ne do të vazhdojmë me këtë proces për të krijuar mirëqenie më të mirë, punësim më të mirë, më të

qëndrueshëm, zhvillim më të qëndrueshëm dhe një perspektiv më të mirë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radha është e propozuesit të interpelancës, zoti Ymeri, i keni pesë minuta.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Përfundimisht, për mendimin tim, nga ministri u kuptua se nuk e ka ndërmend ta kthejë përgjigjen në asnjërin prej pyetjeve që u shtruan këtu. Iu shmang atyre duke u dhënë disa pallavra “nëpër hava”, që thonë. Ky proces, prapë, po e them, nuk është proces transparent. Njëfarë mënyre ministri e tha që nëse doni të merrni informata ‘ejani te unë’. Pra, edhe tha që ne jemi të gatshëm të ju japin informata. Me këtë e tregoi njëlloj zemërgjerësie të Qeverisë, thua se nuk e ka obligim ta informojë Kuvendin për një çështje të tillë.

Ne e konsiderojmë dhe i mbetemi besnik fuqishëm idesë që Qeveria i përgjigjet Kuvendit, e jo Kuvendi të shkojë të kërkojë informata se mos Qeveria po do t’ia japë disa. Pra, kjo është përmbyse shumë e rrezikshme e rolit dhe pozitës së institucioneve të ndryshme në Kosovë. Edhe për shkak të kësaj përmbyseje, kjo Qeveri po funksionon në këtë përmbyse. Një çështje tjetër është, prapë po më duhet ta përsëris, se e përsëriti edhe ministri, nuk janë sindikatat duke e përkrahur këtë proces, ministër! Shikoji lajmet sonte edhe ke për ta parë. Nuk janë duke e përkrahur. Mos shpërndaj dezinformata! Tregojte të vërtetën, thuaj “kemi folur me ta, nuk jemi pajtuar”, në rregull. Po ta merr mendja se je më i mençuri, më i miri, grahi vetë, por mos thuaj që po më përkrahin të tjerët, kur nuk përkrahin. Shumë pak veta e përkrahin këtë proces. Nja dy këtu ulur prapa meje dhe disa që po i shoh këtu përpara.

Tash, për mocionin. Meqenëse këtu ne e kemi paraqitur një mocion qysh kur e kemi kërkuar interpelancën, siç bëhet zakonisht me këto çështje, unë kam pritur që kryetarët e grupeve që kanë qenë të interesuar për ta modifikuar këtë nuk më kanë thirrur asnjëherë, nuk kam pasur ndonjë kërkesë prej tyre. Sot u dëgjua këtu se, në fakt, po të kishte qenë i modifikuar, edhe do ta votonim. Për ne si grup parlamentar, kjo është në rregull. Prandaj, kisha dashur ta kërkoj, para se të flas pak për mocionin, ose të tregoj një gatishmëri të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si kërkuese e kësaj interpelance, që mocionin eventual, cilido qoftë ai, ta votojmë pas pauzës, duke u dhënë kështu gjasë grupeve parlamentare që të bisedojnë në përpjekje për t’u marrë vesh për tekstin e mocionit, nëse mund të merren vesh. Nëse jo, atëherë del ky mocion dhe kush e voton, e voton.

Dua ta ngre një çështje këtu: Nuk ka të bëjë asgjë mocioni me përcaktimin ideologjik të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Edhe pse e pranoj, ne kemi përcaktimin ideologjik, siç ka secili këtu, mirëpo ky mocion nuk është ideologjik. Edhe ata që mendojnë që duhet privatizuar Distribucioni, por edhe ata që mendojnë që nuk duhet të privatizohet kurrë, në një pikë u pajtuan, që kjo mënyrë e privatizimit është jashtëzakonisht e dëmshme edhe e rrezikshme për Kosovën. Dhe, si e tillë, pika e parë e mocionit e thotë pikërisht këtë: “Të anulohet procesi i privatizimit të Shpërndarjes dhe Furnizimit të energjisë elektrike”. Kaq! Nuk po

flasim për procesin në të ardhmen, as nuk jemi duke folur për ato procese në të kaluarën. Po flasim për aktualin, për të cilin e kemi thirrur këtë interpelancë.

Pika e dytë thotë: “Të analizohen të gjitha opsionet e mundshme për sanimin e gjendjes teknike dhe financiare të kompanisë”. Çka ka të keqe këtu? Tentojmë ta sanojmë gjendjen financiare ekonomike, po qe se kemi mundësi, nëse jo, d.m.th. se nuk kemi mundësi.

Çështja e tretë: Qeveria të marrë hapa për investime strategjike në rrjetin e shpërndarjes, që humbjet teknike të reduktohen. Pra, u tha që Qeveria deri tash ka investuar. Mocioni e kërkon një çështje shumë të thjeshtë. Vazhdoni të investoni për aq sa kemi, për aq sa kemi mundësi. Mirëpo, mos thoni që nuk kemi para për Distribucionin, kur po i kemi gjithë ato para për autostradën; kur po i kemi gjithë ato para për çështje tjera luksi, lidhje e pa lidhje. Qysh nuk ka para për ato që janë të domosdoshme për Kosovën? E katërta është që Qeveria nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe asaj të Drejtësisë të marrë masa për ndarjen e kyçjeve ilegale dhe për ndihmë në inkasimin e borxheve që të reduktohen humbjet komerciale.

Tash, a ka dikush “kundër” kësaj diçka, se s’po e kuptoj?! Sepse na u tha që edhe kompania private do të ndihmohet nga gjykata dhe policia, por meqenëse ajo do të ndihmohet, pse nuk po ndihmohet publikja? Se u përmend këtu disa herë që po e subvencionojmë, por asnjëherë nuk e tha kurrkush ‘ngadalë bre veç pak, se qytetarët e Kosovës ia kanë borxh 370.000.000 euro KEK-ut’. Edhe një prej arsyeve pse KEK-u sot rezulton me humbje është për shkak se nuk i paguhet energjia elektrike. Një pjesë e madhe e këtij borxhi madje i takon enklavës serbe, veriut, edhe të tjerave që nuk e kanë paguar rrymën. E tash ne po e dënojmë KEK-un për një diçka që nuk ka mundur Qeveria dhe qeveritë e mëparshme, përfshirë edhe UNMIK-un, kurrë ta zgjidhin. Tash po thonë “paska qenë faji i pronës”, jo nuk ka qenë faji i pronës. Ka qenë faji i Qeverisë, ka qenë faji i “atij” që po thirret si pronar i kësaj prone. E pronari i kësaj prone është Qeveria, qind për qind. Nuk mund të thuash që ka dështuar kompania, e pronari nuk paska dështuar. Se pronari i ka marrë vendimet, apo jo?

Pra, vendimet e kësaj Qeverie e paskan shkatërruar KEK-un, e tash të ndërrohet KEK-u? Jo, jo, duhet ndërruar Qeverinë. Ju faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Nga Qeveria, e do dikush fjalën për fund? E paska kryer. Mirë!

Sabri urdhëro, e kërkoje fjalën.

SABRI HAMITI: Meqë paraqitësi i kërkesës për interpelancë e dha fjalën, unë desha veç dy fjalë. Nuk është e vonuar kjo që kemi propozuar. Është në bazë të Rregullores së Kuvendit. Për çdo diskutim të kësaj natyre, kurrë nuk është vonë që të paraqitet mocion. Mocioni është, i cili në dhjetë pika faktikisht nuk kërkon asgjë më tepër se sa

transparencë nëpër sektorë të ndryshëm të këtij privatizimi, të cilin e shohim proces të pakryer ende.

Prandaj, pajtohemi që grupeve t'u jepet shans nëse duan ta pranojnë një mocion ose ta kombinojnë, të jepet pushimi i drekës dhe pas drekës ta shohim. Nëse nuk kalon, nuk kalon. Nëse kalon, kalon. Ky është qëndrimi im. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit!

I nderuari kryetar!

Unë desha vetëm të sqaroj në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për kërkesat e Grupit Parlamentar të LDK-së, Qeveria e Kosovës zotohet se do t'i raportojë Kuvendit për të gjitha kërkesat që janë parashtruar në letrën zyrtare të Lidhjes Demokratike të Kosovës, meqë edhe ne pajtohemi që janë në përputhshmëri me angazhimet e Qeverisë së Kosovës për transparencë të plotë.

Por, natyrisht, janë procedurat, të cilat kërkohet të respektohen. Kështu që kërkoj të shkojmë në votim.

KRYETARI: Visar, a deshe fjalën ti? Vetëm shkurt, të lutem!

VISAR YMERI: Kryetar, faleminderit!

Unë, në fund, meqenëse e kam të drejtën me Rregullore si parashtrues i kërkesës për interpelancë, që ta përfundoj interpelancën. E dhashë një propozim të shpallet pauzë, nëse grupet parlamentare duan t'i harmonizojnë kërkesat po që se i kanë. Nëse jo, votojmë. Mirëpo, kjo që po ia jep fjalën Qeverisë, nuk është në kuadër të Rregullores, sepse kërkuesi i interpelancës e përmbyll debatin për këtë çështje. Kaq! Ka fol mjaft Qeveria, e ka kohën më së shumti. Natyrisht, me Rregullore e ka shfrytëzuar dhe u krye kjo.

Çështja e dytë është: Është e domosdoshme që të ndalet njëherë procesi, nëse duam transparencë. Nuk ka kurrfarë kuptimi të na informojnë ne, e të vazhdohet me të njëjtën. Çka do t'i bëjmë? Pra, le të ndalet njëherë procesi, le t'i tregojnë dokumentet, e pastaj nëse ka nevojë të vendoset për vazhdim, le të vendosë Kuvendi. Kurrfarë problemi nuk ka. Mirëpo, pa u ndalur procesi, nuk ka kurrfarë kuptimi të qenët transparent tash pasi e kërkua ne. Prej se kanë filluar nuk janë transparentë, tash po thotë "unë t'i sjell ato dokumente"!

KRYESUESI: Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së i ka të dëgjuar të gjitha debatet. Përcaktimi ynë është shumë i qartë - për ekonomi të lirë të tregut, dhe ne e përkrahim procesin e privatizimit.

Ne vlerësojmë se e kemi konsumuar këtë temë. Jemi plotësisht dakord me kërkesat parimore që i ka shtruar LDK-ja, mirëpo për ne këto janë të vonuara dhe kërkojmë nga

Qeveria vërtet që pas kësaj seance t'i japë informatat e nevojshme. Ndërsa, kërkojmë të hyjmë në procesin e votimit dhe ta përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës.

KRYETARI: Mirë! 20 minuta pauzë!

A jeni të pajtimit? Le të deklarohen shefat e grupeve... Jeni për pauzë 20 minuta?

(Ndërhyrje: Jemi që të vazhdojmë të procedojmë më tutje, të votojmë. Pas votimit mund të marrim pauzë.)

Jo, ju lutem, mocioni i Lidhjes Demokratike ka ardhur sot. Ne sot kemi me publikim që ta votojmë mocionin që e keni sjellë si "Vetëvendosje", mbi bazën e të cilit është organizuar ky mocion dhe ky debat. Prandaj, rregullat janë rregulla. Ju lutem, uluni!

Pauzë 20 minuta dhe do të votojmë nëse grupet parlamentare arrijnë ta harmonizojnë tekstin. Në orën 14:50 minuta do të votojmë!

(Vazhdimi i seancës plenare pas pauzës)

KRYETARI: Ju lutem, e vazhdojmë seancën! Visar Ymeri e ka fjalën. Visar, a i keni harmonizuar qëndrimet?

VISAR YMERI: Kryetar, faleminderit!

Në bisedimet që i patëm me përfaqësuesin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, por edhe me të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, u dakordua që ta modifikojmë mocionin, tekstin e mocionit dhe, nga katër e reduktuam në dy pika.

Këto pika, siç u morëm vesh, janë kështu, po i lexoj tash, e pastaj le të deklarohen grupet ç'mendojnë për to, se vërtet tjetër nuk mund të bëjmë më shumë. Pra:

1. Të pezullohet procesi i privatizimit kompanisë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike, derisa të dorëzohen informatat e plota në Kuvendin e Republikës së Kosovës në lidhje me këtë proces dhe

2. Vendimin përfundimtar për privatizimin e merr Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Këto janë dy pikat e mocionit. Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat mocionin e "Vetëvendosjes", të mbështetur nga opozita. Janë dy pika të mocionit. Do të thotë, pozita nuk e ka mbështetur këtë.

Hyjmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 80 deputetë. 27 vota për, 48 kundër, 2 abstenime. U krye, me 28 vota, plus një me dorë, plus katër, 27+4=31 për, 48 kundër, 2 abstenime. Edhe pse unë paskam votuar gabimisht! Mocioni nuk kalon.

Kuvendi nuk e miratoi mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”.
Pauzë, një orë për drekë.

(Vazhdimi i seancës pas pauzës së drekës)

KRYETARI: Të nderuar deputetë! Po fillojmë me vazhdimin e seancës. Në radhë është pika:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim në parim.

E ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Blerand Stavileci, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Politikat e prodhimit dhe përdorimit të masave mbrojtëse i obligojnë shoqëritë e ndryshme që të praktikojnë sisteme menaxhimi dhe kontrolli në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Dhe, meqë ligji aktual për mbrojtjen e bimëve nuk ka gjetur implementim të plotë për shkak të mangësive që janë shfaqur në ndërkohë, sidomos në inspektim dhe mbikëqyrje, ky veprim i ndërmarrë legjislativ për hartimin e këtij projektligji, përveç që ka qenë shumë i nevojshëm, është në linjë të plotë edhe me përkushtimin tonë dhe tuajin për ta rregulluar sa më mirë ligjërisht këtë fushë, si dhe për ta harmonizuar me legjislacionin e BE-së edhe në përcaktimin e emrave të bimëve, prodhuesve bimorë dhe çështjeve të tjera plotësuese.

Pra, arsyeja kryesore për propozimin e këtij Projektligji ka qenë përafrimi me standardet dhe praktikën e vendeve të Bashkimit Evropian, e në pajtim me praktikën më të mira do të bëhet edhe identifikimi dhe evidentimi i rregullt para dhe pas paraqitjes së organizmave të dëmshëm të bimët, në mënyrë që të sigurohet një gjurmim i mirëfilltë në lidhje me paraqitjen e organizmave të dëmshëm dhe për të pasur informata më të sakta lidhur me këtë problematikë.

Projektligji për mbrojtjen e bimëve i rregullon të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e bimëve, mbrojtjen e produkteve bimore dhe objekteve të nevojshme që ndërliken me prodhimtarinë bimore, si dhe, përveç këtyre, e rregullon edhe procesin e

përcaktimit të masave për parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm në prodhimtarinë bimore dhe zhdukjen e tyre. Gjithashtu, përveç këtyre, Projektligji lehtëson edhe mbledhjen dhe këmbimin e informatave dhe të dhënave të ndryshme me vendet e tjera dhe rregullon dhe qartëson edhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësiive të subjekteve të përfshira në mbrojtjen e bimëve dhe në zbatimin e këtij ligji në Kosovë.

Në këtë Projektligj përfshihen në mënyrë të detajuar edhe procedurat zyrtare për vlerësimin e organizmave të dëmshëm. Pra, procedurat e grumbullimit, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave mbi praninë e organizmave të dëmshëm në bimë dhe vlerësimi i tyre do të bëhet në bazë të përcjelljes së gjendjes shëndetësore, në bazë të hulumtimeve sistematike dhe në bazë të kontrollit inspektues, apo edhe procedurave të tjera. Duke u bazuar në rekomandimet e ekspertëve, mënyra më e mirë për ta rregulluar mbrojtjen e bimëve dhe mbrojtjen e produkteve bimore është vetëm nëpërmjet avancimit të praktikave të punës dhe të legjislacionit. Prandaj, ju ftoj që ta miratoni edhe këtë Projektligj, i cili në mënyrë të veçantë do të ndikojë në ngritjen e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore në vendin tonë. Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural. Naiti nuk është këtu. Mirë! Fjalën e ka, në emër të Komisionit, Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullore së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25.6.2012, e shqyrtoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e bimëve dhe njëkohësisht pas shqyrtimit në parim, vlerësoi se Projektligjit për mbrojtjen e bimëve i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike, deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë Projektligj. Ligji i vjetër për mbrojtjen e bimëve, i miratuar në vitin 2004, sikur edhe disa ligje të mëhershme, i mban peng në kompetencë të Parlamentit ndryshimet e shpeshta, të cilat po ndodhin si rezultat i zbulimeve të shumta shkencore, e të cilat është e nevojshme që të aplikohen shpejt gjatë prodhimit, nga prodhuesi dhe nga institucionet ekzekutive.

Kështu, në Ligjin aktual për mbrojtjen e bimëve ka pasur disa lista të sëmundjeve dhe dëmtuesve, të cilat nuk janë në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian, sidomos me atë 2000/29. Në këtë Projektligj, po ashtu janë shtuar edhe disa lista të tjera, të cilat janë në harmoni me këtë direktivë. Edhe në kreun kur flitet për importin, eksportin dhe transitin e dërgesave bimore janë bërë ndryshime në harmoni me këtë direktivë.

E njëjta ndërhyrje është bërë edhe në kreun e shtatë, te pasaportat bimore. Këto ndryshime janë bartur edhe në përkufizimet, ku janë bërë disa ndryshime dhe shtime të disa termave tjerë. Ligji i mëhershëm, veç tjerash, ka shumë pasaktësi dhe ia vlen që të rikthehet. Ky Projektligj është më i plotësuar dhe më i saktë, ka më pak dykuptimësi dhe ne presim që të zbatohet më lehtë.

Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah këtë Projektligj dhe do të punojë në fazat e ardhshme të plotësimit të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

Qëllimi i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve është rregullimi i të gjitha çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me importin dhe eksportin e bimëve, që mund të bartin organizma të dëmshëm.

Projektligji është kundër përhapjes së këtyre organizmave të dëmshëm, duke përjashtuar ato që dedikohen për mbjellje dhe për të siguruar koherencë me legjislacionin në fuqi. Projektligji për mbrojtjen e bimëve prodhon kosto shtesë buxhetore në shumën prej 20.000 euro, mjete të cilat do të përdoren dhe shpenzohen për kompensimin e fermerëve në rastet e asgjësimit të bimëve dhe produkteve bimore, të cilat vlerësohen se kanë organizma të dëmshëm. Ky buxhet, sipas Ministrisë së Bujqësisë, është i përballueshëm për faktin se janë të themeluara organet që do të involvohen në zbatimin e tij. Pra, fusha e veprimit të Projektligjit është krijimi i infrastrukturës ligjore të përshtatshme për harmonizimin e emrave të bimëve, produkteve të bimëve etj.

Ligji gjithashtu përcakton lejet për importin e organizmave të dëmshëm nëse ata përdoren për veprimtari shkencore dhe hulumtuese. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji bëhet nga organi kompetent nëpërmjet Inspektoratit Fitosanitar. Ligji parasheh gjobë në të holla për kundërvajtje subjektiv fizik dhe juridik nëse fut në territor apo nuk respekton ndalimin e përhapjes, tregtimit dhe mbajtjes së organizmave të dëmshëm për bimë dhe produkte bimore. Mjetet e grumbulluara në pajtim me këtë ligj do të derdhen në Buxhetin e Kosovës. Ky ligj gjithashtu është në përputhje dhe nuk i cenon parimet themelore dhe politikatat e Bashkimit Evropian.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në parim do ta përkrahë këtë Projektligj në lexim të parë, duke e dhënë kontributin më tej gjatë punës në komision. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “Vetëvendosje”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë në parim këtë ligj. Ky Projektligj përcakton mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimore, gjë që nënkupton aktivitetin e planifikuar të shtetit në këtë fushë, rrjedhimisht nënkupton edhe forcimin e

shtetit në funksion të mbrojtjes së bimëve, produkteve bimore dhe rrjedhimisht edhe mbrojtjen e qytetarit dhe mjedisit.

Çdo ligj që avancon forcimin e shtetit, natyrisht që është i mirëseardhur për Lëvizjen “Vetëvendosje”, edhe pse shprehim mosbesimin tonë në implementimin e tij, pasi politika e pushtetit në Kosovë është e orientuar tërësisht në drejtime tjera. Politika e Qeverisë sot e dobëson shtetin dhe kontrollin shtetëror mbi cilësinë dhe ajo thjesht është e orientuar vetëm drejt hapjes së pakontrolluar të kufijve dhe drejt profitit, e jo drejt interesave të qytetarëve.

Mirëpo, meqenëse, edhe pse jemi skeptikë në implementimin e këtij ligji, megjithatë ligji si i tillë është i mirë dhe rrjedhimisht ne do ta votojmë në parim “për” dhe natyrisht do të angazhohemi për përmirësimin e tij gjatë amendamentimit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të AAK-së, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Me këtë Projektligj rregullohen çështje, të cilat janë të rëndësishme dhe me prioritet për importin dhe eksportin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, të cilat mund të bartin organizma të dëmshëm, me përjashtim të atyre që dedikohen për mbjellje dhe për të siguruar koherencë me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Bujqësisë është bartëse e zbatimit të këtij ligji. Buxheti shtesë i këtij ligji thuhet se do të shpenzohet për kompensimin e fermerëve në raste të asgjësimit të bimëve dhe produkteve bimore, të cilat vlerësohen të kenë organizma të dëmshëm. Atëherë, shtrohet pyetja: A ka infrastrukturë të mjaftueshme ministria përkatëse për inspektimin dhe destinimin e buxhetit aty ku ka nevojë vërtetë? Inspektimi i shërbimeve bëhet nga inspektorët e bujqësisë dhe inspektorët fitosanitarë. A ka numër të mjaftueshëm të inspektorëve për inspektim të tërë veprimtarisë bujqësore.

Grupi i Aleancës e ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe do ta përkrahë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e bimëve dhe duke marrë parasysh se Qeveria është drejtuar kah sektori i bujqësisë në mënyrën e duhur, e përkrah Projektligjin.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit “6+”, kryetari i Grupit Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë Projektligj për mbrojtjen e bimëve dhe në parim do ta përkrahë, ndërsa kontributin tonë do te japim gjatë punës në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Të pranishëm janë 64 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 57 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e bimëve. Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim në parim. E ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Blerand Stavileci, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit edhe një herë kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që ta paraqes para jush ekspozenë e Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë.

Roli i statistikave në krijimin e politikave të mirëfillta, veçanërisht në rastin e ekonomive në tranzicion, ku ndryshimet janë të vazhdueshme, është i një rëndësie vendimtare dhe i tillë është edhe në rastin e statistikave bujqësore, ku informacionet luajnë rol shumë të rëndësishëm në procesin e politikëbërjes në vendimmarrje, si dhe në programimin, implementimin dhe monitorimin e programit vjetor të ministrisë.

Regjistrimi bujqësor në Kosovë nuk është bërë që nga viti 1960, e kjo ka krijuar vështirësi të mëdha, veçanërisht në sigurimin e informacioneve të sakta dhe kredibile për sektorin e bujqësisë.

Prandaj, hartimi i këtij ligji dhe krijimi i kornizës ligjore mbi parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe organizimin kanë qenë jetike për realizimin e regjistrimit të përgjithshëm bujqësor në vitin 2013, të cilin do ta bëjë Agjencia e Statistikave të Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe të gjitha institucionet tjera relevante. Burim i të dhënave në sektorin e bujqësisë deri më tani kanë qenë anketat statistikore, të dhënat doganore dhe të

dhënat e komunave, por përderisa kanë munguar të dhënat e përgjithshme të integruara në një sistem, të dhënat e krahasueshme edhe me të dhëna ndërkombëtare të Bashkimit Evropian, përveç vështirësive të tjera, në mënyrë specifike, më së shumti vështirësi ka rezultuar të jetë procesi i harmonizimit me politikat e përbashkëta bujqësore të BE-së.

Prandaj, në këto rrethana, organizimi i regjistrimit të bujqësisë ka qenë pa dyshim alternativa e vetme për t'i siguruar të dhënat relevante për sektorin, të cilat në të ardhmen, përveç se do të kenë ndikim pozitiv në hartimin e politikave bujqësore e kombëtare, do të jenë thelbësore edhe për negociatat në fazën e para-anëtarësimit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Për ta realizuar këtë regjistrim, ne tashmë i kemi siguruar dhe mjetet e nevojshme financiare, mirëpo është i nevojshëm edhe miratimi i këtij ligji për t'i hapur rrugë zbatimit të projektit. Ky ligj përfshin krijimin e komisioneve, përbërjen, kompetencat e organeve që organizojnë, ndihmojnë dhe kryejnë regjistrimin, duke përfshirë periudhën e mbledhjes së të dhënave, dokumentacionin e nevojshëm, procedurën për sistemimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave, që dalin nga regjistrimi bujqësor, si dhe rregullon formën e publikimit, shpërndarjen e të dhënave dhe ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave individuale të regjistrimit.

Pra, nëpërmjet miratimit të këtij Projektligji, ne do ta rregullojmë mbrojtjen që ka të bëjë me të dhëna për strukturën e ekonomive bujqësore brenda territorit të Kosovës, si: mbrojtjen e të dhënave për ekonomitë familjare e bujqësore, për organizatat ekonomike, për institucionet shkencore dhe për të gjithë ata që japin të dhëna të besueshme statistikore, të cilat janë të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave bujqësore në përputhje me standardet e BE-së dhe rekomandime ndërkombëtare.

Metoda e regjistrimit që do të praktikohet do të jetë ajo tradicionale 'derë më derë', me anë të pyetësorëve të regjistrimit për ekonomitë bujqësore në zonat rurale. Rezultatet e përkohshme të regjistrimit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, sipas ligjit, duhet t'i shpërndajë deri më 28 shkurt 2014, ndërsa ato përfundimtare do të shpërndahen, duke filluar nga data 30 shtator 2014. ky regjistrim, i cili parashihet të zgjasë rreth 2 vjet, është në harmoni të plotë edhe me kërkesat e Komisionit Evropian dhe pjesë e fazës përgatitore, të nderuar deputetë, ka qenë edhe hartimi i këtij projektligji. Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e tij, ju ftoj që ta miratoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Komisionit, fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25.6.2012, e shqyrtoi në parim Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë.

Pas shqyrtimit në parim të këtij Projektligji për regjistrimin e bujqësisë, Komisioni vlerëson se Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, deputeti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar!

Me këtë Projektligj do të mundësohet regjistrimi i bujqësisë për grumbullimin e informatave mbi prodhimtarinë bujqësore, ekonominë bujqësore dhe disa komponentë tjerë në tërë territorin e Kosovës.

Për gjysmë shekulli, Kosovës i ka munguar ky lloj informacionesh, pa të cilat, siç e dëshmoi koha e tranzicionit, ne nuk kemi pasur një zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë. Asnjëherë nuk ka mundur që të mbyllet cikli i hulumtimit, prodhimit, përpunimit dhe tregtimit në bujqësi për shkak të mungesës së statistikave të besueshme, me të cilat ky sektor do të ishte pavarësuar deri diku nga ndërhyrjet dhe hilet e të tjerëve. Prandaj, e kemi pasur një diskriminim të programuar në radhë të parë të prodhuesve privatë, ekonominë e të cilëve nuk kanë mundur t'i bëjnë ballë ekonomisë së tregut të lirë.

Sot, sektori i bujqësisë ka statistika për disa fusha, për të cilat janë grumbulluar të dhëna rast pas rasti, nëpërmjet anketave mostër, për të cilat është thënë se kanë besueshmëri relative. Këto statistika u kanë shërbyer vendimmarrësve për të marrë vendime, të cilat nuk kanë mundur të jenë përherë kualitative.

Nga këto informata janë hartuar plane të fushave, e madje edhe plani i Kosovës për bujqësi dhe zhvillim rural, bashkë me planet e veprimit. Duke u bazuar në këto informata, është ndarë buxheti dhe është dashur të bazohet edhe legjislacioni, të cilin e kemi miratuar.

Në fund të fundit, nga këto informata ka pasur pasoja dhe efekte zhvillimi i bujqësisë, pylltarisë dhe i vendbanimeve rurale.

Me këtë Projektligj do të hapet rruga për regjistrimin e bujqësisë, i cili do të zbatohet në vitin 2013, falë buxhetit që e ka siguruar ministria. Me statistika të reja do të themelohet baza e të dhënave, e cila do të ofrojë informata të besueshme për ekonominë bujqësore, prodhimtarinë, metodat e prodhimtarisë e tjera, të cilat mund t'i shfrytëzojnë institucionet e pushtetit të të dyja niveleve, institucionet arsimore dhe shkencore dhe shoqëria civile për nevojat e planifikimit të aktiviteteve të tyre.

Grumbullimi i informatave të plota do të bëjë të mundur kombinimin e tyre për t'i vlerësuar më saktë mundësitë dhe për t'i caktuar prioritetet e fushave të zhvillimit, të cilat mund të sjellin fitime të mira për ekonominë familjare, në të cilat do të fokusohet shteti për të ofruar përkrahje me grante dhe subvencione.

Kështu, shteti do të ndihmojë aktivizimin e burimeve tona të pashfrytëzuara, me çka do ta mbajmë popullsinë në vendbanimet rurale, do ta përmirësojmë jetën atje dhe do të plotësohet oferta me produkte vendore, të cilat do të bëjnë të mundur qarkullimin e parasë në vend dhe shtimin e punësimit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet miratimin e këtij Projektligji dhe do të punojë në fazat e ardhshme për pasurimin e tij. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe njëkohësisht në parim do ta mbështesë dhe kontributin e vet do ta japë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Këtë ligj e konsiderojmë si një ndër ligjet goxha të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë.

Regjistrimi i bujqësisë është një ndër hapat elementarë para planifikimit të zhvillimit të bujqësisë, pasi i mbledh të gjitha të dhënat statistikore për potencialet bujqësore që i ka Kosova.

Lëvizja “Vetëvendosje” e sheh zhvillimin e bujqësisë si një ndër fushat më të rëndësishme në zhvillimin ekonomik, në uljen e papunësisë dhe në zvogëlimin e migrimit nga fshatrat.

E zhvillimin e bujqësisë nuk mund ta shohë ndryshe, pos si një zhvillim të integruar e të planifikuar, ku shteti e ka rolin e vet primar.

Të dhënat e sakta mundësojnë një planifikim të saktë dhe planifikimi ofron sigurinë për bujqit. Kjo e bën regjistrimin e domosdoshëm. Shpresojmë që pas këtij regjistrimi, ndihmat e shtetit të shkojnë aty ku ka nevojë, te bujku që prodhon, që prodhimi i bujqve tanë të mos përfundojë i kalbur e i hedhur, siç ndodh shpesh me pataten e Vushtrrisë, siç ndodhi disa herë edhe me rrushin e Rahovecit.

Që pagesat e drejtpërdrejta, subvencionet, të bëhen jo vetëm në kesh, por edhe me karburante, plehra, ushqime, farëra e të tjera. Që pagesat e drejtpërdrejta të mos bëhen vetëm për prodhim, e në këtë rast marrin më shumë ata që prodhojnë më shumë, por të ndihmohen edhe fermerët më të vegjël, që t’i zhvillojnë ata fermerë ose ata bujq në përputhje me nevojat, në bazë të një plani të gjithëmbarshëm zhvillimor të bujqësisë në Kosovë, duke mos i diskriminuar as regjionet e caktuara.

Pra, ne do ta votojmë këtë ligj në parim për shkak se konsiderojmë që edhe është ligj goxha i mirë, edhe është shumë i rëndësishëm për bujqësinë.

KRYETARI: Në emër të Grupit të AAK-së, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij Projektligji është regjistrimi i bujqësisë në vitin 2013 në territorin e Republikës së Kosovës, kompetencat, përgjegjësitë dhe sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm. Do të sigurohen informata mbi prodhuesit bujqësorë, ekonomitë bujqësore dhe bizneset e tjera.

Metodat e regjistrimit, thuhet në nenin 8, do të jenë ‘derë më derë’, duke i përdorur formularët që më parë janë aprovuar nga Enti i Statistikave të Kosovës. Ne jemi pak skeptikë, sepse edhe regjistrimi i popullsisë është bërë ‘derë më derë’ në këtë formë dhe e dimë se në çfarë rezultati u harmonizua. Të mos themi se ishte dështim i vërtetë. Të shpresojmë se komisioni gjithëpërfshirës do të jetë serioz dhe me kompetencë do t’i kryejë punët e veta. E njëjta vlen edhe për komisionet komunale.

Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë Projektligj dhe do ta përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë dhe duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji, kontributin e vet do ta japë në Komision Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së? Nuk ka. Në emër të Grupit “6+”? Janë dakord. Shkojmë në votim.

Të pranishëm janë 63 deputetë. Votojmë tash!

Me 59 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar propozim-strategjinë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim.

E ftoj ministrin Beqaj, si propozues i çështjes. Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Ju paraqes për miratim Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025. Këtë dokument strategjik e kemi trajtuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës edhe më herët dhe, pas diskutimeve të zhvilluara, i është kthyer Qeverisë së Republikës së Kosovës për plotësim.

Pas kthimit të dokumentit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik është angazhuar dhe për këtë e ka themeluar një grup punues, i cili i ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e bëra nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe i ka shqyrtuar të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe komentet e bëra nga deputetët gjatë diskutimit parlamentar dhe i ka inkorporuar ato në këtë dokument.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kohore, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka mbajtur takime me institucionet relevante, siç janë: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, AKP-ja, “Trepça”, Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë dhe është konsultuar me ekspertët e fushës së minierave me qëllim të përpunimit të këtij dokumenti vital për sektorin e minierave në Kosovë.

Deputetë të nderuar,

Më lejoni që në pika të shkurta të paraqes përmbajtjen e këtij dokumenti.

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës është e hartuar në bazë të vizionit ekonomik të Qeverisë, ku zhvillimi i qëndrueshëm, zhvillimi i sektorit mineral, miratimi i legjislacionit adekuat, reforma strukturore ekonomike dhe edukimi i gjeneratave të reja janë parimet bazë për të ardhmen ekonomike të vendit.

Kjo strategji bazohet në katër shtyllat themelore, që janë:

Shtylla e parë - krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerare dhe tërheqje të investimeve. Institucionet e Kosovës do ta vendosin me këtë ligj një bazë të qartë legjislative dhe politika sektoriale me qëllim përkrahjen dhe zhvillimin e sektorit mineral.

Kjo bazë ligjore do të mundësojë vazhdimin e ristrukturimit të sektorit, avancimin e aftësive konkurruese të tyre në tregun vendor dhe ndërkombëtar, si dhe do të mundësojë krijimin e perspektivave të reja për shfrytëzim dhe përpunim të resurseve minerale.

Valorizimi i resurseve nënkupton vendosjen e resurseve minerale të Kosovës, posaçërisht ato të linjitit, të xeheve të plumb-zinkut në funksion të zhvillimit të mirëfilltë ekonomik të vendit. Objektivat strategjike për realizimin e shtyllës së parë janë, si në vijim: plotësimi i infrastrukturës ligjore dhe rregulluese, hartimi i politikave zhvillimore për sektorin minerar, zhvillimi i politikave fiskale dhe realizimi i rivlerësimit ekonomik të potencialit minerar.

Ky vlerësim ekonomik duhet të bëhet me qëllim të krijimit të një pasqyre të qartë lidhur me përfitimet që do të mund të krijohen nga industria minerare për shtetin dhe për komunitetet.

Ky aktivitet është pjesë e planit të veprimit dhe do të fillojë pas aprovimit të strategjisë.

Shtylla e dytë - rritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin minerar.

Rritja e kapaciteteve të institucioneve relevante shkencore dhe edukativo-arsimore do të mundësojë zhvillimin e industrisë minerare, sipas kërkesave të tregut dhe standardeve ndërkombëtare.

Kosova e ka bartur një kapital njerëzor me ekspertivë të vlefshme profesionale në këtë fushë, por aktualisht shihet si imediate nevoja e ripërtëritjes dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të këtij kapitali për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm të sektorit në përgjithësi.

Objektivat strategjikë për realizimin e shtyllës së dytë janë: zhvillimi institucional dhe i ka kapaciteteve njerëzore, hulumtimi i resurseve minerare dhe raportimi i tyre.

Shtylla e tretë - ka të bëjë me çështjen sociale dhe përfitimet e komunitetit. Kjo strategji, gjithashtu, i definon veprimet dhe nismat për trajtim të sektorit minerar, bazuar në përparësitë e vendit për të mundësuar që zhvillimi i sektorit minerar të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve si pronarë natyral të këtyre resurseve.

Pjesëmarrja e komuniteteve dhe përfitimit nëpërmjet punësimeve të banorëve dhe zhvillimit të infrastrukturës lokale do ta kenë një ndikim të rëndësishëm social dhe do të mund të nxisin zhvillimin rajonal në Kosovë.

Objektivat strategjikë për shtyllën e tretë janë: trajtimi i çështjeve sociale dhe siguria në punë dhe pjesëmarrja dhe përfitimet e komunitetit, të cilat mundësojnë dhe parashohin që një numër i madh i banorëve, të cilët në aktivitetin e tyre duhet të jenë pjesë e zhvillimeve minerare në rajone nga ata vijnë.

Shtylla e katërt - ka të bëjë me përkujdesjen për mjedisin. Duke konsideruar se mjedisi miqësor dhe i shëndetshëm ka rëndësi primare për qytetarët e Kosovës, kjo strategji e konsideron si shumë të rëndësishme mbrojtjen e mjedisit dhe garanton marrjen e masave të nevojshme për minimizimin e ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga aktiviteti mineral.

Shtyllat e lartpërmendura në vetvete përmbajnë objektiva, politika zhvillimore dhe veprime. Objektivat janë shkoqitur dhe detajuar në kuadër të kësaj strategjie, ndërsa politikat zhvillimore do të krijojnë kornizë të qartë për zhvillim të qëndrueshëm dhe trajtim miqësor për mjedisin, duke e përkrahur kështu hulumtimin, nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, si dhe zhvillimin e tërësishëm të sektorit mineral.

Objektivat strategjikë për shtyllën e katërt janë: zgjidhja e problemeve mjedisore historike - e dini që kemi shumë mbetje industriale, mbrojtja e mjedisit nga aktiviteti mineral dhe në vazhdim janë masa, të cilat do të merren në drejtim të asaj që kjo strategji të jetë funksionale.

Në kapitullin e katërt janë paraqitur në mënyrë të detajuar resurset minerare me të dhënat, të cilat janë në disponim, ku resurset energjetike dhe ato të metaleve me ngjyrë paraqesin potencialin më të rëndësishëm për zhvillimin e gjithëmbarshtëm. Ndër to mund të veçohet linjiti, mineralet e plumb-zinkut, argjendit, arit, minerali i cili ka përbërje të nikelit dhe kobaltit, të hekur-nikelit, boksitit, manganit, magnezitit dhe një numër i konsiderueshëm i mineraleve jometalore, industriale dhe materialeve gjeologjike ndërtimore.

Shfrytëzimi racional dhe i menaxhuar mirë i këtyre resurseve mund të sigurojë mbështetje për zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Në kapitullin e pestë është paraqitur analiza SFOT, si një instrument i dobishëm për identifikimin e faktorëve të brendshëm ndikues në sektorin mineral, siç janë përparësitë dhe dobësitë, si dhe faktorë të jashtëm, siç janë mundësia dhe rreziqet që kanë dhe mund të kenë ndikim në sektorin mineral.

Në kapitullin e gjashtë janë paraqitur sfidat për zhvillimin e sektorit mineral, të cilat fokusohen në financimin, rehabilitimin e minierave ekzistuese dhe funksionalizimin e tyre sa më shpejt dhe me kosto sa më të vogël të mundshme.

Dhe, normalisht, procesi i riorganizimit të ndërmarrjeve shoqërore në sektorin mineral paraqet gjithashtu tërheqjen e investimeve vendore dhe të huaja në sektorin mineral, valorizimin dhe rritjen e shkallës së përpunuesë për minerale të caktuara, deri në produkte finale dhe gjysmëprodukte, harmonizimi i programeve universitare me nevojat e sektorit mineral dhe stimulimi i gjeneratave të reja në zhvillimin e këtij sektori, hulumtimi i mëtutjeshëm për identifikimin e resurseve të reja minerale në Kosovë, zhvillimi i industrisë së përpunuesë në sektorin mineral dhe gjetja e tregjeve të reja në tregun botëror.

Dhe, normalisht, në fund, zhvillimi i minierave për prodhimin e linjtit.

Në kapitullin e shtatë janë paraqitur objektivat strategjikë për secilën shtyllë dhe në vete përmbajnë politikat dhe masat, të cilat do të krijojnë kornizë të qartë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe trajtim miqësor për mjedisin. Brenda secilit objektiv janë paraqitur masat, të cilat do të ndërmerren në realizimin e objektivave përkatës.

Procesi i hartimit të strategjisë përbëhet nga dy faza. Faza e parë përfshin përgatitjen e strategjisë dhe aprovimin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ndërsa faza e dytë përfshin përgatitjen e programit trevjeçar për zbatimin e strategjisë.

Në programin e zbatimit do të grupohen aktivitetet, në kuadër të së cilës shtyllë dhe objektiv do të paraqitet afati kohor i realizimit, kostoja e realizimit, institucioni përgjegjës dhe mbështetës për zbatimin e aktivitetit.

Të nderuar deputetë,

Besoj se dokumenti i Strategjisë Minerare do ta marrë mbështetjen tuaj, në mënyrë që të fillojë implementimi në dobi të zhvillimit të këtij sektori dhe për mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ju ftoj që ta votojmë këtë projekt-dokument lidhur me Strategjinë Minerare të Kosovës!
Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani, radha është e kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri, deputeti Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar këtë strategji, të sjellë rishtazi nga Qeveria, pavarësisht se për një kohë të shkurtër dy herë e kemi trajtuar, meqenëse një herë nuk ka kaluar nga Kuvendi. Komisioni i ka shfrytëzuar të gjitha procedurat dhe të gjitha kompetencat, që ta trajtojë këtë dokument në mënyrën sa më të mirë.

E kemi pasur edhe një dëgjim publik dhe, po ashtu, e kemi debatuar edhe brenda komisionit. Komisioni ia ka dhënë dritën jeshile, e ka përkrahur këtë dokument, këtë strategji.

I ftoj deputetët dhe Kuvendin që ta miratojnë strategjinë, sepse është dokument, i cili u hap rrugë synimeve të Qeverisë për zhvillimin e sektorit minerar në Kosovë dhe, po ashtu, dëshiroj të tërheq vëmendjen që ministria e ka trajtuar një numër të madh të çështjeve që kanë dalë nga debati i kaluar, si çështje të cilat ne kemi vërejtur se janë trajtuar në këtë strategji dhe mendojmë se tashmë janë pjekur kushtet për t'u aprovuar nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, deputetja Sala Berisha - Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA - SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministër Beqaj,

Ministër i Bujqësisë,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Tani e kemi në shqyrtim draft-Strategjinë për Minierat e Kosovës. Gjithçka që të flasim, për diçka do të sillemi rreth atij dokumenti, i cili veç na është servuar nga Qeveria e Kosovës.

Konsideroj që është koha t'i lëmë anash të gjitha çështjet tjera, që janë të dorës së dytë, e të merremi shumë seriozisht e ta mbështetim këtë dokument të rëndësishëm, i cili i duhet Qeverisë së Kosovës dhe, mbi të gjitha, i duhet ekonomisë së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Pajtohem i të gjithë, besoj, se zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social është prioritet i lartë i institucioneve shtetërore të Kosovës. Fatbardhësisht, Kosova është mjaft e pasur me llojllojshmëri të resurseve minerale, prej të cilave mineralet energjetike dhe ato të metaleve me ngjyrë paraqesin potencial të rëndësishëm për zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik.

Prandaj, shfrytëzimi i resurseve minerale është një ndër shtyllat më të rëndësishme që ta kemi një zhvillim ekonomik, që kushtimisht mund të përkthehet me mirëqenie sociale, e kjo nënkupton edhe krijimin e vendeve të reja të punës në Kosovë.

Dokumentin që e kemi para nesh, përkatësisht Strategjia Minerare përbën kornizën themelore, në bazë të së cilës përcaktohen objektivat dhe prioritetet zhvillimore të sektorit mineral.

Strategjia Minerare përcakton politikat dhe masat për zhvillimin e sektorit mineral në dobi të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale.

Ministri i përmendi shtyllat kryesore që paraqiten në këtë strategji dhe objektivat që pasohen pas shtyllave, pastaj hapat për implementimin e këtyre objektivave, por më lejoni t'i përmend disa karakteristika kyçe të vizionit ekonomik, të cilat mund të realizohen nëpërmjet kësaj strategjie, të cilat janë:

- ky dokument ofron përfitime afatgjata ekonomiko-sociale për Kosovën dhe
- kontribuon në arritjen e objektivave zhvillimore ekonomike.

Të punojmë për mbrojtjen e mjedisit, të mundësojmë tërheqjen e investimeve të reja në këtë sektor. Nuk mund pa e përmend se tani, për momentin, Komisioni Parlamentar e ka në duar plotësim-ndryshimin e projektligjit për miniera dhe minerale dhe në këtë rast shqyrtimi i kësaj strategjie na ndihmon shumë që ne t'i koordinojmë këto dy dokumente shumë të rëndësishme, sepse identifikimi i problemeve në sektorin mineral, të cilin e ka bërë Qeveria dhe na e ka ofruar me këtë dokument, e paraqet si njërin nga dobësitë dhe mungesat edhe infrastrukturën ligjore dhe rregullatore, që duhet të jetë një bartëse për zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit mineral.

Midis tjerash, midis objektivave tjera që paraqiten te ky dokument i kemi edhe çështjet sociale dhe përfitimin e komunitetit, që ne si grup punues për plotësim-ndryshimin e Ligjit për miniera dhe minerale duhet ta kemi parasysh, sepse në ligj aktualisht mungon një gjë e tillë.

Komuniteti ku zhvillohen operime minerare momentalisht me ligj nuk përfiton asgjë, përveç se përfiton një ndotje të tmerrshme të mjedisit.

Qeveria, nëpërmjet një objektiwi dhe një shtylle tjetër e ka paraqitur edhe përkujdesjen për mjedisin.

Ne e dimë se mjedisi është një obligim tjetër për t'i plotësuar standardet tjera evropiane si shtet. Prandaj, këtu i kushtohet një vëmendje shumë e rëndësishme zgjidhjes së problemeve mjedisore, e sidomos problemeve të trashëguara të mbetjeve industriale dhe minerare, me të cilat ballafaqohet Kosova. Ato mbetje minerare janë kryesisht si rezultat i operimeve të mëhershme historike, për të cilat kryesisht ngarkohen KEK-u dhe "Trepça".

Ka edhe shumë çështje tjera, të cilat analizohen dhe paraqiten në këtë strategji. Unë nuk do të ju marr kohë më tutje, vetëm të them se si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështetim këtë strategji. Kontributin tonë do ta japim edhe në grupin punues, në Ligjin për miniera dhe minerale, bashkërisht me grupin punues, me deputetët tjerë edhe të subjekteve tjerë, që janë pjesë e atij grupi punues. Prandaj, sot, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj ta votojmë këtë dokument shumë të rëndësishëm, që i hap rrugë zhvillimit ekonomik dhe trajtimit shumë të sinqertë të çështjeve, edhe mjedisore, edhe sociale. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të LDK-së, deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,
Ministra,
Kolegë deputetë,

Versioni aktual i Strategjisë Minerare nuk ka ndryshime esenciale nga versioni, i cili nuk është miratuar nga Kuvendi në fund të vitit të kaluar. Prandaj, vërejtjet dhe rezervat e shprehura në atë kohë mbeten të vlefshme edhe tani.

Megjithatë, shkurtimisht do t'i përmend vërejtjet kryesore, që kanë të bëjnë me qasjen ndaj sektorit minerar, rolin e rentës minerare, zhvillimin e sektorit të rërës dhe zhavorrit, SFOT-analizës, si dhe rritjes së investimeve në këtë sektor.

Sa i përket qasjes ndaj zhvillimit të sektorit minerar, përsëri nuk mund të dallohet qartë se cili është qëllimi primar i strategjisë.

A është qëllimi i strategjisë që sektori minerar, gjegjësisht rezervat tona minerare të pashfrytëzuara dhe të cilat nuk janë në pronësi të subjekteve aktuale, që veprojnë në këtë sektor, të bëhen bartës i zhvillimit ekonomik të vendit, apo qëllimi i strategjisë është

vetëm përkrahja e subjekteve, të cilat aktualisht veprojnë në këtë sektor dhe ringjallja e tyre?

Ne mendojmë se strategjia nuk duhet të merret me proceset e strukturimit dhe organizimit të ndërmarrë minerar, por të fokusohet në rregullimin ligjor dhe institucional të këtij sektori, analizën e potencialit minerar, që është paraqitur mjaft mirë në këtë strategji, si dhe paraqitjen e rrugës apo mënyrave se si ky sektor duhet të bëhet bartës i zhvillimit ekonomik të vendit, me theks të posaçëm në shfrytëzimin e mineraleve jometalore dhe materialeve të ndërtimit, të cilat i kanë parakushtet më të favorshme për t'u zhvilluar.

Së dyti, strategjia nuk e analizon rentën minerare, si faktor kyç nxitës i shfrytëzimit të pasurive natyrore. Në strategji përshkruhen tri lloje të rentës minerare, por që nuk sqarohet se cili lloj është më i përshtatshmi për implementim në vendin tonë, duke marrë parasysh që mënyra e përcaktimit të saj është e një rëndësie të posaçme për zhvillimin e këtij sektori.

Strategjia duhet të definojë qartë se cili është roli primar i rentës minerare, mbushja e buxhetit, përkatësisht aspekti fiskal apo tërheqja e investimeve, qofshin ato vendore apo të huaja.

Ne mendojmë se inkurajimi i investimeve duhet të ketë përparësi absolute ndaj trajtimit të rentës minerare, si faktor fiskal.

Çështje tjetër është zhvillimi i sektorit të rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë, i cili aktualisht është i ndaluar me vendimin e Qeverisë nga nëntori i vitit të kaluar për një periudhë trevjeçare, kurse nuk jepet kurrfarë opsioni se çka do të ndodhë pas këtyre tre vjetëve.

Ne mendojmë se është i pajustificueshëm ndalimi i zhvillimit të këtij sektori, vetëm pse Inspektorati Minerar nuk mund ta kontrollojë dhe mbikëqyrë këtë sektor në aspektin mjedisor. Aktet e tilla japin sinjale jo të mira sa u përket kapaciteteve tona institucionale për zhvillim apo për mbrojtje të resurseve tona.

Po ashtu, kjo mund të interpretohet edhe si favorizim ligjor i sektorit tjetër, përkatësisht i rërës dhe zhavorrit nga shkëmbinjtë e fortë.

Analiza SFOT përcillet me disa kundërshtime, siç është rasti i fuqisë punëtore, që në njërin anë paraqitet si përparësi, kurse në anën tjetër si dobësi e këtij sektori. Paraqitja si dobësi e mungesës së një sistemi të përhershëm monitorues të ndotjeve, kurse reformat qeveritare për tërheqje të investimeve si mundësi janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Po ashtu, janë joreale të paraqiten si rreziqe jostabiliteti i mundshëm rajonal dhe pakënaqësitë sociale, të cilat direkt i dekurajojnë investitorët e huaj.

Grupi Parlamentar i LDK-së mendon që Strategjia duhet të kthehet dhe të plotësohet dhe të vijë përsëri në Kuvend për miratim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit kryetar!

Kjo strategji, e cila është risjellë nga Qeveria në Kuvend, i ka disa ndryshime nga ajo e kaluara. Është e vërtetë ajo që e tha ministri, por edhe kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik.

Pra, është një strategji, e cila deri diku i ka marrë për bazë vërejtjet, që janë shtruar në Kuvend në fund të vitit të kaluar, kur është kthyer nga Kuvendi prapa. Dhe, mendoj se është një faktor goxha i rëndësishëm, që ta kemi parasysh ne si deputetë këtë që po i ndodh strategjisë. Pra, kur e ka kthyer Kuvendi strategjinë në Qeveri, Qeveria ka vendosur ta përmirësojë pak atë dhe e ka përmirësuar.

Pra, është shumë mirë që të kthehet përsëri, që ta bëjë një dokument edhe më të mirë. Meqenëse, kjo punë po funksionuaka kështu, është shumë mirë që po funksionon kështu, qysh ishte dashur të funksionojë raporti Kuvend - Qeveri.

Me gjithë faktin se është përmirësuar si strategji, për Lëvizjen “Vendvendosje” kjo strategji prapë nuk e përmbush atë që ish dashur ta përmbushë një strategji dhe i ka disa probleme goxha për mendimin tonë të rëndësishme për sektorin minerar, gjë që e bën atë të pamjaftueshme edhe të papranueshme për ne.

Po tentojmë t'i radhis disa këtu. Përveç atyre që janë thënë në seancën e kaluar kur është kthyer prapa, janë edhe disa tjera që kisha të sillen në këtë seancë.

Kjo strategji, e cila është risjellë nga Qeveria e ka një strukturë dhe definim në tekst më të mirë se sa e kaluara. Mirëpo, janë disa çështje kyçe në të cilat nuk jep zgjidhje të duhur. Përkundrazi, në shumë pjesë është disi më shumë deklarative, që duke bukur, por që në veprimet që i propozon është goxha e zbrazët. Thelbësore është se mungojnë orientimet dhe projeksionet strategjike globale në zhvillimin e sektorit, e në veçanti në zhvillimin e thëngjillit apo të sektorit të thëngjillit dhe metaleve me ngjyra. Pra, mungojnë kërkesat për investime, sa janë ato investime, sa kërkohet të investohet në këtë sektor për t'u zhvilluar? Pastaj, sa është potenciali i prodhimit, sa do të prodhohim po ta investonim një shumë të caktuar? Sa është planifikuar të investohet në të? Cili do të jetë përfitimi i Kosovës nga ky sektor minerar? Pra, duhet ta kemi një projeksion ndoshta të përafërt, se të saktë nuk mund ta kemi, të asaj se sa do të përfitojë Kosova gradualisht me investimet në këtë sektor. Cili do të jetë kthimi nga investimet për Kosovën si shtet, për Buxhetin e Kosovës, por edhe për popullin e Kosovës? Domethënë, cilat janë ato të mira sociale që vijnë nga këto investime në sektorin minerar?

Këto mungesa në strategji disi janë arsyetuar me publikimin e të dhënave të ndryshme në lidhje me rezervat. Pra, në një farë mënyre në strategji thuhet që nuk e kemi bash të qartë se çfarë rezervash minerare kemi, meqenëse kemi të dhëna dhe raporte të ndryshme, hulumtime të ndryshme, të cilat janë bërë gjatë viteve.

Strategjia nuk ka mbështetje as për zhvillimet aktuale në KEK, e as në “Trepçë”, e kjo e bën atë jo të plotë në disa segmente, të parealizueshme. Në faqen 36 të saj thuhet se nënkupton realizimin në tërësi të strategjisë së energjisë, që do të thotë se Kosova B dhe Siboci do të jepen falas në kuadër të procesit të tenderimit për Kosovën e Re, e të gjitha gjasat janë që edhe fusha tjera mbajtëse të linjtit, të cilat janë të hulumtuara, me vendim të Qeverisë, t’i jepen falas një kompanie ndërkombëtare, apo ndonjë konsorciumi tjetër që mund të paraqitet në Kosovë.

Çka mbetet të menaxhohet prej shtetit në këtë sektor? Kjo është një pyetje që duhet t’i shtrohet Qeverisë.

Në strategji, sa i përket angazhimit të kapitalit privat, flitet vetëm për basenin e Drenicës dhe basenin e Dukagjinit, ndërkohë që baseni i Kosovës është lënë plotësisht anash, e në janë bërë investime shumë të mëdha. Nga kjo mund të spekulohet, ose krijohet përshtypja se ai madje as nuk do të privatizohet, por do të jepet falas.

“Trepça”, siç e dimë të gjithë, është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sipas Ligjit për riorganizimin të ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre. E kemi thënë disa herë, por po e përsëris. Ky ligj nuk ka dallim përmbajtësor me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/49. Atë kohë Qeveria e Kosovës dhe menaxhmenti i Trepçës e patën bllokuar zgjedhjen e administratorit sipas asaj rregulloreje, ndërkohë që me ligjin, i cili është miratuar në Kuvend vitin e kaluar, vetëm është hequr prej titullit fjala “likuidim”, ndërkohë që ligji përmbajtësisht ka mbetur i njëjtë, edhe pse ka disa ndryshime.

Për shkak të rolit vendimtar të Këshillit të Kreditorëve që parashihet në këtë ligj, në rend të parë, i cili sipas ligjit thuhet se do të konsiderohet shumë shpejtë, nëse nuk konstituuar deri tash, “Trepça” shumë lehtë mund të shkojë në likuidim, meqenëse kreditorët do ta kenë fjalën kryesore për vendimmarrjen për “Trepçën”, gjë që është shumë e rrezikshme, duke pasur parasysh veçanërisht kush janë kreditorët, por edhe në përgjithësi, duke ua lënë në dorë kreditorëve, shumica prej tyre spekulantë, që të vendosin për një gjigant kaq të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës.

Konsiderojmë se mbeturinat metalurgjike dhe sterile të flotacioneve duhet të ndahen prej “Trepçës”, e cila është në moratorium, dhe të kalojnë nëpër kujdesie dhe pronësi shtetërore.

Teknologjitë që janë zhvilluar kohëve të fundit mundësojnë përpunimin profitabil të mbeturinave historike të flotacioneve dhe atyre metalurgjike të “Trepçës”.

Gjatë viteve 2006 dhe vitit 2007 ka pasur bisedime intensive me kompaninë nga Gjermania për investimin deri 300 milionë euro në Mitrovicë për përpunimin e mbeturinave metalurgjike. Bisedimet qenë ndërprerë për shkak të krizës së madhe me çmimin e metaleve me ngjyra në atëbotë.

Në tenderin e shpallur në “Trepçë” në këtë vit ka pasur oferta dhjetëra-milionëshe për blerjen e këtyre mbeturinave, të cilat do të transportoheshin me disa mijëra kilometra dhe do të përpunoheshin madje me profil shumë të lartë.

Për përpunimin e mbeturinave në Artanë ka pasur po ashtu bisedime konkrete për ngritjen e kapaciteteve përpunuese, vlera potenciale e metaleve në mbeturina ka qenë 300 deri 400 milionë euro, ndërkohë që investimet që do të kërkoheshin janë 7 deri 10 milionë euro maksimalisht.

Ne mendojmë që në strategji duhet të kërkohet ndërtimi i kapaciteteve përpunuese, flotacioni përkatës në Artanë dhe investimet direkte në përpunimin e mbeturinave. Kjo është një çështje që nuk është mbuluar në strategji dhe është e domosdoshme të përfshihet.

Pra, këto janë disa vërejtje, për mendimin tim substanciale, që do ta përmirësonin jashtëzakonisht shumë këtë strategji, mirëpo sa do të ketë mundësi që këto vërejtje të futen në të varet edhe prej votave të deputetëve. Prandaj, po them se është mirë ta kthejmë këtë strategji përsëri te Qeveria, të përmirësohet dhe kur të bëhet dokument komplet dhe strategji e mirëfilltë për një sektor kaq të rëndësishëm, atëherë natyrisht që askush nuk do të ketë arsye ta refuzojë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Herën e kaluar ku kemi diskutuar për Strategjinë Minerare të Kosovës, kemi thënë se është më tepër një listë e politikave eventuale të Qeverisë, e jo strategji. Mendojmë se me gjithë faktin që është e vërtetë, se u tha që ka disa përmirësime, prapëseprapë kemi të bëjmë me një listë të dëshirave për politika të mundshme. Strategjia nuk zberthen më tepër se çka do të arrijë dhe si do të arrihet dhe, pa dashur të shtoj më tepër, ndoshta edhe fjala e kaluar mund të jetë pjesë e transkriptit, Aleanca nuk mund ta votojë këtë strategji sot në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se ky Kuvend i Kosovës edhe pak kohë më parë e ktheu Strategjinë Minerare dhe tash prapë e kemi një strategji tjetër nga Qeveria për periudhën 2012-2025, atëherë mund të themi se Qeveria ka bërë disa plotësim-ndryshime në të. Mirëpo, pasi këtu sot është ministri me ne dhe po qëndron brenda, mund të themi se hyrja e strategjisë është bërë në mënyrën adekuate çfarë duhet të jetë, mirëpo objektivat dhe misioni në afat të shkurtër dhe afat mesëm nuk janë cekur, por duke marrë parasysh krizën globale financiare në sektorin mineral, atëherë as ministri nuk është në atë gjendje ta parashohë çka do të ndodhë deri në vitin e ardhshëm.

Prapëseprapë, them se janë bërë disa plotësim-ndryshime, mirëpo është e drejtë e të të gjithë deputetëve t'i japin vlerësimet e veta dhe të implementohen në këtë strategji, për arsye se është një dokument, i cili mund të riparohet çdo tre vjet dhe askush nuk është në gjendje ta parashohë çka mund të ndodhë pas 5 vjetëve tjera në sektorin minerar, mirëpo mund të kemi vullnet politikë që proceset t'i shtyjme përpara.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah strategjinë, mirëpo prapëseprapë e them edhe një herë sugjeron te ministri që ndoshta pas plotësim-ndryshimit të Ligjit për miniera dhe minerale t'i shohë mundësitë çka mund të ndodhë në situatën afatshkurtër dhe afatmesme në sektorin minerar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputeti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Teşekkür ederim sayın başkan, bakanlar ve milletvekilleri,

Meclise sunulan 2012 - 2025 Maden ve Mineraller Strateji Tasarısını ister komisyonda ister de parlamento grubumuzda değerlendirdiğimizi ifade etmek istiyorum. Kosova'nın büyük bir zenginliği olan ve Kosova ekonomik kalkınmasında bir lokomotifini oluşturacak olan madencilik alanı iyi bir şekilde kullanımının değerlendirilmesi gerekir. Özellikle enerji sektöründe kullanılan linyitin değerlendirilmesi ve kullanılması son derece hassas ve önemlidir. Tabii ki bu 12 yıllık stratejinin yeni inşa edilecek termik santrallerinin akıbetini de belirleyecektir. Strateji 12 yıllık bir zamanı içermektedir. Bizce her beş yıl içerisinde bu strateji gözden geçirilmelidir, çünkü değişen dünya ekonomik düzeni ekonomik stratejilerini de etkilemektedir. Dolayısıyla maden ürünlerinin makul kullanımı için stratejinin takibi çok önemlidir.

KRYETARI: Jo, dy herë fjalën askujt. Vazhdojmë. Jemi në procedurën e votimit. Nuk ka të lajmëruar për diskutim.

Të pranishëm 71 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 37 vota për, 29 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

8. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në mbledhjen e mbajtur më datën 13 qershor 2012, e ka shqyrtuar raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin kryetari i OSHP-së dhe Auditori i Përgjithshëm.

Opinionin e auditorit është opinion i pakualifikuar, do të thotë jo i mirë. Gjatë shqyrtimit të raportit, Komisioni ka konstatuar se OSHP-ja në fushën e raportimit financiar mbetet shumë për të bërë, sidomos në trajtimin e të hyrave nga ankesat dhe gjobat tjera.

Të gjeturat e KZAP-it janë në këto fusha:

1. Paraqitje jo e saktë e shpenzimeve të buxhetit, pasqyrat financiare,
2. Mungesa e evidencës së saktë dhe të plotë mbi të hyrat vetjake,
3. Mungesa e një plani të prokurimit në pajtim me ndarjet buxhetore,
4. Regjistrimi jo i saktë i aseteve, i pasurive financiare,
5. Mungesa e regjistrimit të aseteve të pasurive materiale dhe
6. Mungesa e auditimit të brendshëm.

Gabimet janë lëshuar në pasqyra financiare, si në rastin e deklaramentit të të hyrave, po ashtu edhe në regjistrimin e pasurisë, regjistrimi i buxhetit, si dhe shpenzimet në pasqyrat financiare të OSHP-së.

Të hyrat vetjake: Ekzistojnë dallime në shumën e mjeteve të deklaruara në raportin vjetor të punës së OSHP-së dhe të dhënat në pasqyrat financiare. Në kontekst të gjobave të shqiptuara, përderisa në raport thuhet se shuma e mjeteve nga gjoba është 63 mijë euro, në pasqyra financiare thuhet se nga gjobat janë mbledhur 35 mijë euro. Edhe pse në total të shumës së mbledhur nga ankesat dhe gjobat nuk ka diferenca, ndërmjet llojit të të hyrave ka dallime.

Përveç të dhënave të gjetura nga sistemi i rebalancit të Ministrisë së Financave, OSHP-ja nuk ka ndonjë evidencë tjetër për të hyra.

Pagesa për punëtorë jashtë orarit, OSHP-ja për 10 muaj të vitit 2011 ka bërë pagesa të orëve shtesë për punën jashtë orarit deri në nivelin 40 orë në muaj. Për këtë nuk ka as bazë juridike, nuk ka as evidencë dhe normativë, me të cilën verifikon se është punuar jashtë orarit. Do të thotë se i kanë marrë dy paga, e kjo vazhduar për 8 persona.

Prokurimi: Ekzistojnë mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet planit të prokurimit dhe ndarjes së buxhetit në mallra dhe shërbime.

Plani i prokurimit, derisa ishte 91 mijë e 990 mijë euro, më i lartë se ndarja e buxhetit për vitin 2011, afro 40% e blerjeve janë bërë pa procedura të prokurimit. Mirëpo, edhe për blerjet që kanë pasur prokurim, auditori ka konstatuar se ka mangësi së sigurisë së ekzekutimit dhe nënshkrimi i kontratave është bërë në mungesë të tri ofertave të përgjegjshme.

Pasuritë: Trajtimi i pasurisë kapitale dhe jokapitale në pasqyrat financiare nga OSHP-ja nuk ka qenë në rregull. Mosregjistrimi i plotë si dhe mungesa e bar-kodeve e sjell në dyshim tërë procesin. Po ashtu, nuk është bërë inventarizimi në fund të vitit, siç parashihej me Rregulloren e Thesarit.

Sistemi i auditimit të brendshëm: Meqë OSHP-ja nuk i plotëson kriteret sipas udhëzimit të ketë auditim të brendshëm, megjithëkëtë ajo nuk ka angazhuar apo nuk kërkon që ta ketë një auditim të tillë.

Sipas vlerësimit të Komisionit, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik duhet të ndërmarrë veprime konkrete për adresimin e rekomandimeve të KZAP-it dhe të Komisionit. Këtë mund ta bëjë duke filluar në një vetëvlerësim të menaxhmentit financiar dhe kontrollit, sipas instruksioneve të Ministrisë së Financave, e cila do t'i ndihmojë. Ndihmë do t'i japë OSHP-së në eliminimin e dobësive dhe adresimin e të gjeturave të Auditorit të Përgjithshëm.

Në raportin e 9-mujorit financiar, OSHP-ja duhet të paraqesë tabela të harmonizuara financiare dhe regjistrimin e saktë të pasurisë, ta dorëzojë në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike raportin e detajuar lidhur me pagesat e bëra për punën jashtë orarit.

Raporti duhet ta përmbajë bazën ligjore të pagesës; arsyeshmërinë e pagave dhe veprimet e ndërmarra lidhur me këto të gjetura; të sigurojë auditor të brendshëm; ta harmonizojë planin e prokurimit me buxhetin e ndarë; ta dorëzojë planin vjetor lidhur me të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Për të gjitha këto veprime, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, në afat prej 4 muajve, me raport me shkrim duhet ta njoftojë Kuvendin nëpërmejt Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me këto rekomandime, si dhe me të gjeturat e konstatuara nga Auditorit të Përgjithshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? A pajtoheni? Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të OSHP-së për vitin 2011, të proceduar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Kualifikimi i auditimit, i dhënë nga zyra e Auditorit të Përgjithshëm është opinion i kualifikuar, që do të thotë një opinion jo i mirë i shfrytëzimit dhe i menaxhimit të financave publike.

Sipas raportit të ZAP-it, opinionimi i auditimit është jo i mirë për arsye se në pasqyrat financiare informacioni i dhënë në disa aspekte nuk është i vërtetë. Kjo ka të bëjë me rezultatin, i cili nuk është i drejtë dhe ka të bëjë me rrjedhën e parasë së gatshme.

Pasuritë nuk janë pasuruar ashtu siç duhet, si dhe menaxhimi financiar i OSHP-së.

Menaxhimi jo i mirë i financave publike, pagesat shtesë të punëtorëve, hartimi jo i mirë i planit të prokurimit e të tjera, janë disa nga shkeljet që i ka gjetur auditori.

Kryetari i OSHP-së e ka pranuar që stafi i tij është i pakualifikuar. Kërkojmë nga menaxheri i OSHP-së të ndërmarrë përgatitjet e duhura shtesë që ata të jenë të kualifikuar dhe t'i përgatisë pasqyrat financiare, ashtu siç kërkohet me ligj.

Menaxheri kryesor i kësaj organizate buxhetore t'i ndërmarrë masat e duhura dhe të reflektojë në të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Arsyet pse te pasqyrat financiare nuk janë evidentuar të hyrat, është një gabim me Kodin e planit kontabël të Thesarit, ku gjobat dhe donacionet janë shënuar në një kod. Po ashtu, nuk është bërë një ndarje e saktë edhe te shpenzimet.

Sa u përket pagesave jashtë orarit për stafin, Ligji e lejon një gjë të tillë, por nëse të gjithë punojnë në të njëjtën kohë jashtë orarit, kjo nuk është më punë jashtë orarit, por është një pagesë shtesë.

OSHP-ja, pas vërejtjeve nga ZAP-i, tash nuk vepron më kështu dhe kjo gjë është e mirë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah raportin me rekomandime nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike dhe i fton deputetët që ta votojnë raportin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Për të mos bërë fjalë kallaballëk jashtë asaj që thamë, unë do t'i them disa çështje që mendoj se ia vlen të thuhet.

Këto janë të gjetura të konstatuara dhe janë brengë. Në veçanti, trajtimi i pasurisë, brengë është pagesa e orëve jashtë orarit, 40 orë në muaj, e dihet që fondi i orëve është 42, do të thotë edhe nga një pagë ua u ka dhënë dhe këto lëshime i bën një institucion i nivelit që është më i larti për t'i menaxhuar, për t'i korrigjuar të tjerët. Kjo është brenga.

Desha të them, në emër të grupit, mendoj se ka ardhur koha që duhet të mendojmë, zoti kryetar, në raportet të cilat flasin për lëshime të tilla. Duhet të shkojmë me legjislacion ... edhe më tutje. Ne kemi raste këtu që nuk po miratohen raporte dhe ato vazhdojnë prej viti në vit. Fatmirësisht, kemi edhe raste që korrigjohen. Dje e patëm një takim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, që ka qenë një brengë e madhe vitin e kaluar, por që këtë vit ka ndryshime. Por, kemi edhe të tjera, të cilat e vazhdojnë avazin e vjetër. Mendoj, se në këtë drejtim, në veçanti për institucionet, të cilat janë të formuara prej këtij Kuvendi dhe i menaxhon Kuvendi, duhet të mendojmë se çka edhe në çfarë forme, kur arrijmë te një konstatim kësisoj.

Tjetër çështje që desha ta them është se në vendet e demokracisë së gjerë, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni i Inteligjencës, është rregulluar me norma që duhet ta udhëheqë opozita. Dhe, nuk është e rastësishme kjo. Po nisem nga logjika, jo pse i takoj pjesës opozitare, por nga ajo që po e shoh. Aty kua ka funksionuar Auditori i Brendshëm, nuk po kem probleme, aty ku nuk ka funksionuar po lindin këso problemesh. Prandaj, Auditori i Brendshëm për Qeverinë dhe këto institucione është ky Komision dhe e ka logjikën që duhet ta ketë, jo veç kryesimin, por ta ketë edhe shumicën, që të diskutohet në mënyrë që kur të vijë Raporti i Progresit nuk do t'i gjejë gabimet e njëjta. Do të thotë do të mund që palarat tona t'i rregullojmë vetë, e jo të na i rregullojë Brukseli.

Prandaj, në këtë drejtim, mendoj se ky Komision, po ta ketë shumicën, ka shumëçka të sjellë këtu për t'i diskutuar në detaje dhe në një mënyrë ajo do të jetë pasqyrë për Ekzekutivin. Them pasqyrë, sepse ato të gjetura, në fund të vitit i gjen dhe i konstaton Raporti i Progresit. Prandaj, kemi mundësi këto t'i korrigjojmë ne vetë. Po them se ka shumë organizata të tjera, në të cilat kemi shkelje të njëjta apo të ngjashme, e ky është një shqetësim i përgjithshëm yni.

Ne, ju kujtohet, zoti kryetar, edhe vitin e kaluar e kemi shqyrtuar një raport, sipas të cilit i kanë marrë 23 paga! Ka diçka këtu që nuk funksionon, ka diçka që ata nuk e dinë se dikush i përcjell, i menaxhon dhe kanë sanksione për gjëra të tilla, Prandaj, është koha, jo për të hequr koka, por për t'i korrigjuar proceset. Ta kuptojnë se dikush do ta përcjellë gjithë punën e tyre, do ta korrektojë dhe pasqyrojë, sa ka vepruar dhe si ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Afrim Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Është bërë praktikë që në çdo auditim të agjencive të pavarura të audituara nga Auditori, të nxirret një raport i cili pasqyron shkelje ligjore dhe nënligjore, e që kanë për qëllim keqpërdorimin e parasë së taksapaguesve të Republikës së Kosovës.

Kjo po ndodh si pasojë e inkuadrimit të militantëve partiakë nëpër këto agjenci. Nga kjo nuk amnistohet as Organi Shqyrtues i Prokurimit, duke u bazuar në raportin e auditimit, të paraqitur nga Auditori.

Ky raport thekson se ky organ nuk ka mbajtur evidenca dhe raporte përmbledhëse për të hyrat e realizuara. Gjithashtu, ky raport thekson se Organi Shqyrtues i Prokurimit e ka bërë pagesën e orëve shtesë të punës, të cilat u përmendën nga kryetari i komisionit, për stafin, për dhjetë muaj rresht gjatë vitit 2011, me arsyetimin e rritjes së vëllimit të punëve.

I gjithë stafi është paguar nga 40 orë shtesë në muaj, mirëpo Auditori nuk ka gjetur dëshmi për punën shtesë që ishte kryer gjatë kësaj periudhe kohore dhe gjatë intervistave me shërbimin e OSHP-së. Auditori ka vërejtur se nuk ka pasur rritje të vëllimit të punëve. Për më tepër, ky raport pasqyron saktë edhe shkeljet në prokurim, që ka bërë Organi Shqyrtues i Prokurimit. Kjo shprehet sidomos në nënshkrimin e kontratës në mungesë të tri ofertave të përgjegjshme. Kjo e tregon një imazh të keq të punës së këtij organi, sepse ky organ nuk mund të cilësohet kredibil dhe i përgjegjshëm në anulimin e tenderëve të nënshkruar nga institucionet me kompani private, si pasojë e mosrespektimit të ligjeve dhe ky mosrespektim i ligjeve ka për bazë edhe veprimin e këtij organi. Vazhdimi i shkeljeve nga Organi Shqyrtues i Prokurimit pasqyrohet edhe në përdorimin e veturave nga zyrtarët e OSHP-ës, shfrytëzimi i të cilave bëhet pa plotësimin e formularëve, gjë të cilën janë të obliguar ta bëjnë në bazë të udhëzimeve administrative numër 03/2008. Gjithashtu, ky raport përmban edhe shkelje tjera për të cilat komisioni ka nxjerrë rekomandim për evitimin e tyre në afat të caktuar nga OSHP-ja dhe si të tillë Grupi ynë Parlamentar i “Vetëvendosjes” do ta përkrahë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Gjithsesi se edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështesë raportin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Sidoqoftë, mendojmë se ka rekomandime të mangëta, ndoshta është edhe çështje e Rregullores së punës aktuale, se ne nuk kemi rekomandime tjera nga Komisioni. Mendojmë, sidoqoftë, se ka qenë e mundshme që të rekomandohet që përgjegjësit për këtë gjendje në Organin Shqyrtues të Prokurimit të shkarkohen. Kuvendi e ka këtë të drejtë dhe ka mundur ta bëjë një gjë të tillë.

Mendojmë se është jashtëzakonisht e habitshme, e papërgjegjshme nga Kuvendi t'i konstatojë shkeljet nga komisioni, t'i konstatojë shkeljet serioze të ligjit dhe të mënyrës së menaxhimit, jo të vetëm parasë publike, sepse kemi të bëjmë këtu edhe me para publike, por edhe me çështje tjera dhe në të njëjtën kohë, pasi ta miratojmë rekomandimin e Komisionit, të mos ndodhë asgjë.

Mendoj se për asnjë institucion tjetër të Republikës së Kosovës, nuk po flas vetëm për institucionet e pavarura, mënyra se si kalojnë nëpër Kuvend këto çështje, nuk është aspak motivuese për njerëzit që ta respektojnë ligjin dhe të punojnë, por përkundrazi, është motivuese që edhe njerëzit tjerë ta shkelin ligjin dhe të vazhdojnë të abuzojnë me gjithçka që është publike.

Sot, do ta mbështetim rekomandimin e Komisionit, mirëpo mendoj se Kuvendi shumë shpejt duhet të kërkojë që të ndërmerren masa seriozisht konkrete dhe të gjithë shkelësit e ligjit të shkarkohen dhe të ballafaqohen me ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryetar i Kuvendit, Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e mbështet raportin e Komisionit dhe rekomandimet e propozuara. Dhe, gjithashtu, ne shprehim brengosje që një trup i tillë rregullator, i cili duhet ta zbatojë ligjin në çdo pikë, në çdo ditë dhe në çdo çështje, bën lëshime të tilla. Dhe, në qoftë se ju kujtohet, kur e kemi aprovuar raportin, kemi thënë se raporti është i mirë, por situata në përgjithësi në fushën që e mbulon ky organ nuk është e mirë. Prapëseprapë, ky raport tregon ndoshta që me të vërtetë duhet të merremi seriozisht me këto organe rregullative, të cilat duhet të sigurojnë zbatimin e standardeve, të cilësisë dhe të qeverisjes dhe të ligjshmërisë në fusha të caktuara.

Unë mendoj se nëse ne pretendojmë që të kemi investime dhe pretendojmë që ta rregullojmë fushën e prokurimit publik, që është esenciale për luftën kundër korrupsionit dhe për sigurimin e përgjegjësive lidhur me përdorimin e parasë publike, sigurisht këto rekomandime duhet t'i marrim shumë seriozisht dhe çdo vonesë në zbatimin e tyre ta sanksionojmë me masa konkrete nga Kuvendi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, kryetari Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe duke pasur parasysh opinionin e Auditorit Gjeneral, si opinion i kualifikuar, dhe pas konstatimit të Komisionit në fushën e raportimit financiar, ku OSHP-ja duhet të bëjë shumë më shumë, në veçanti në trajtimin e të hyrave nga ankesat dhe gjobat, mosevidentimi i pasurisë dhe shkeljet që janë bërë në emër të pagesës së orëve shtesë për tërë stafin, si dhe gjetjet tjera nga Auditori, Grupi Parlamentar “6+” e përkrah rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Faleminderit!

KRYETARI: Për diskutim është lajmëruar edhe deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Unë e dëgjova me vëmendje dhe opinionin e Komisionit dhe të gjitha grupeve parlamentare.

Këtu i kemi dy skenarë. Në fakt, raporti i Auditorit të Përgjithshëm u përkrah nga të gjithë, sepse nuk ka si të jetë ndryshe, dhe e kemi një opinion të kualifikuar, që është shumë shqetësues. U tha edhe më herët, është Organi Shqyrtues i Prokurimit, i cili merret me shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë për parregullsitë që mund të jenë ... të padrejtësisë nga autoritetet kontraktuese.

Unë i kam dy pyetje për Kuvendin dhe për Kryesinë:

Nëse raporti nuk votohet, sepse kemi raste kur në këtë Kuvend ne nuk e votojmë raportin, çka ndodh? I njëjti bord, i njëjti staf, i njëjti shef ekzekutiv vazhdon ta marrë pagën e njëjtë, vazhdon ta ketë punën e njëjtë dhe pozitat e njëjta. Cilat janë masat ndëshkuese?

U tha edhe versioni tjetër, se raporti mund të aprovohet, por me rekomandimet që gjetjet e Auditorit t'i përmirësojë në afatin sa më të shkurtër, në periudhën prej 4 muajve.

Kemi pasur edhe raste të tilla, kur institucioneve u kemi rekomanduar, mirëpo ato nuk i kanë përmbushur rekomandimet, as të Kuvendit, as nuk u janë përgjigjur gjetjeve të Auditorit. Do të thotë, çka në këtë rast?

Ne vetëm po diskutojmë, po i kalojmë raportet. LDK-ja e ka ngrehur edhe më herët shqetësimin se ne po i shqyrtojmë raportet e punës, pa i pasur raportet e Auditorit. Po ta shikojmë transkriptin, kur është shqyrtuar raporti i punës, ka deputetë këtu që kanë thënë fjalë shumë lavdëruese për Organin Shqyrtues të Prokurimit. E, tash na del një opinion i kualifikuar i Auditorit që në fakt i hedh poshtë të gjitha ato.

Edhe një mangësi tjetër, që besoj e kemi ne si Kuvend, është ndarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Ne në asnjë mënyrë nuk po i ndëshkojmë ata. Organi Shqyrtues i Prokurimit vjen në Komisionin për Buxhet e Financa dhe ne, duke mos u konsultuar, në këtë rast, me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i aprovojmë të gjitha kërkesat buxhetore.

Ne duhet të marrim masa ndëshkuese dhe duhet të fillojmë t'i disjplinojmë këto institucione, të cilat i përgjigjen Kuvendit dhe janë institucione që e kanë një rol shumë relevant në zhvillimin ekonomik dhe në mbarëvajtjen e rendit dhe ligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi tjerë të lajmëruar për diskutim. Por, një sqarim: Deputete, Kryesia ka rol administrativ. Përgjegjësia është e Komisionit dhe e Kuvendit, sa u përket raporteve të agjencive të ndryshme, që i përgjigjen Kuvendit.

Edhe një herë po them, Kryesia ka rol më tepër administrativ se sa vendimmarrës. Vendimmarrës është Kuvendi si tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Të pranishëm i kemi 65 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 50 vota për, 12 vota kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit - pasqyra vjetore financiare e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të miratuara para pak ditësh

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Besim Beqaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë shkurt Projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqes para jush Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Projekt-kodi penal fillimisht ka ardhur me këto nene dhe më vonë, për shkak të shqetësimeve, të cilat janë ngrehur nga mediet dhe shoqëria civile, Qeveria i ka mirëpritur dhe në emër të propozuesit konsideron se neni 37 mbulohet me ligjin për përgjegjësinë penale të personave juridikë, kurse vlerat që mbrohen me nenet 38 dhe 39 mbrohen me Konventën Evropiane të të drejtave të njeriut, e cila mund të zbatohet drejtpërdrejt, sepse Kushtetuta i jep kësaj përparësi.

Prandaj, në emër të Qeverisë ju ftoj që ta votoni Projekt-kodin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Ishte me autorizimin e kryeministrit! Në emër të Komisionit, kryetari Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Ministri e bëri një gabim teknik. Ndoshta është lapsus lingua, prandaj po ia marrim si të tillë. Bëhet fjalë për propozimin që ka ardhur prej Qeverisë, është Projektligji për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39.

Vërejtjet që kanë dalë nga Komisioni dhe puna e Komisionit është: Ky projektligj duhet të quhet - Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Kodin Penal të Kosovës dhe në brendinë e tij duhet të jetë fokusi kryesor - heqja e neneve 37, 38 dhe 39, e jo "shfuqizimi". Pra, i kemi dy elemente kryesore - Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe brendia e tij është - heqja e neneve 37, 38 dhe 39, e jo shfuqizimi.

Ky është pak a shumë qëndrimi i Komisionit me vërejtjet substanciale, mirëpo ka ekzistuar vullneti që të kalojë në leximin e parë, e pastaj me amendamente të zgjidhen këto probleme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kryetari i Grupit, Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar me vëmendje këtë Projektligj dhe u bën thirrje të gjithëve që ta votojnë, edhe pse, siç thonë gjakovarët - “Pasuli ishte pa kripë”, megjithatë ne kemi paralajmëruar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Ademi, megjithatë, po e “ha pasulin” ashtu si është tash, me kripë e pa kripë! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka thënë edhe herën e kaluar, dhe nuk kam çka t’i shtoj asaj, përpos asaj që e ka thënë edhe Komisioni. Domethënë, Grupi ynë Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe po ashtu e mbështetim heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 dhe si të tillë ne do ta përkrahim dhe do ta votojmë.

KRYETARI: Qoftë edhe pa kripë! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Siç po shihet, ministri s’po di as ta prezantojë këtë Projektligj. Domethënë nuk e di, nuk e ka idenë se cila është përmbajtja dhe këtu shihet edhe angazhimi i Qeverisë në lidhje me lirinë e medieve.

Së pari, është për të të ardhur keq që u zhvilluan gjithë këto debate dhe procedura për të arritur në pikën fillestare. Pra, për të ardhur te fshirja e neneve problematike 37 dhe 38, të cilat ne i kemi sjellë në formën e amendamenteve që ditën e parë.

U desh që ta marrë vesh e gjithë bota se në Kosovë klasa politike po tenton t’i inkriminojë mediet dhe të dëmtohet edhe më shumë imazhi i Kosovës për të arritur deri këtu, pra te ky riprocedim.

Për të gjithë ata që nuk e dinë, duhet ta mësojnë, se liria e medieve është një nga parametrat kryesorë me të cilët matet niveli i demokracisë së një vendi. Dhe, e përsëris: për të gjithë ata deputetë në Kuvendin e Kosovës, të cilët nuk e dinë, le ta mësojnë se liria e medieve është një nga parametrat kryesorë me të cilët matet niveli i demokracisë së një vendi, sepse po e shoh që nuk po dëgjojnë.

Një vend që instalon ligje dhe atmosferë mbytëse për këtë liri, nuk ka si të jetë demokratik, pavarësisht çfarë deklarojnë politikanët. E pra, këtë herë, natyrisht se jo për herë të parë, Kosova tingëlloi shumë jodemokratike, ose më saktë - diktatoriale, siç e kam thënë në seancën e votimit.

Unë mendoj se është e turpshme e gjithë kjo situatë. Është e turpshme që fillimisht Ministria e Drejtësisë e solli në Kuvend një kod me nene të marra nga Kodi penal i Serbisë së Milosheviqit dhe tentoi t'i kontrabandojë këto nene në Kuvend.

Unë personalisht e kam denoncuar si inkriminues nenin 37, si inkriminues për lirinë e medieve, por nuk më ka shkuar mendja se një nen i tillë mund të ishte marrë nga ligjet e aplikuara nga Milosheviqi. Kjo shkon përtej imagjinatës sime.

Personalisht, nuk e kuptoj as mentalitetin e tipit - "Për inat të nuses më vdektë djali!" I tillë ka qenë në Kuvend votimi i dytë, kur disa deputetë prej inatit se amendamentet për nenet 37 dhe 38 i kishim bërë ne, pra "Vetëvendosje", votuan kundër. Thjesht, më duket logjikë fëmijërore. Ligji nuk bëhet as për një person të caktuar, as për një subjekt politik të caktuar, por bëhet për të gjithë qytetarët e Kosovës, për të sotmen dhe të ardhmen, ku do të jetojnë fëmijët tanë, pavarësisht çfarë statusi social dhe ekonomik i përkasin. Dhe, ju siguroj se një vend me medie të lira është në të mirën e të gjithëve.

Por, unë kurrësi nuk mund t'i justifikoj ata deputetë që ishin plotësisht të vetëdijshëm për përmbajtjen e këtyre neneve, të cilët votuan të bindur se ato duhet të mbeten pjesë e Kodit Penal. Kjo e ka vetëm një shpjegim: Ata e projektojnë veten si zotë të medias, zotë të kontrollit të plotë, zotë të manipulimit dhe propagandës. E vërteta është se disa medie i kontrollojnë, madje i kanë kthyer në tellall. Mirëpo, çfarë po ndodh tani? Qeveria, pra sponsoruesja e neneve 37 dhe 38, pasi dështoi ta legalizojë kontrollin e synuar, mbeti kontroll në tentativë, kërkon t'i lajë duart si Ponc Pilati, për gjithë dëmin që i shkaktoi Kosovës, duke e riproceduar Kodin Penal, të cilin sapo e miratuan bashkë me nenet inkriminuese për mediet. Nenet duhet fshirë. Këtë ne si Grup Parlamentar e kemi kërkuar që në ditën e parë, por kjo nuk duhet bërë duke dënuar çdo praktikë parlamentare. Një kod penal që inkriminon mediet duhet riproceduar, por mbi një bazë ligjore dhe pa shkaktuar precedentë negativë për ligje të tjera.

Kuvendi i Kosovës po kalon nga gabimi në gabim. Ligji - pra Kodi, nuk ka hyrë në fuqi, hyn më 1 janar. Është parim juridik për të gjithë ata që nuk dinë që edhe Kuvendi i Kosovës do të duhej ta respektonte, që është një parim juridik, pra që quhet "vacatio legis", e që nënkupton fjetje apo pushim të ligjit, deri sa të hyjë në fuqi. Gjatë kësaj periudhe, ligji nuk guxon të preket, as të aplikohet, apo të amendamentohet, të ndryshohet apo shfuqizohet.

Në anën tjetër, Kuvendi po bën punë Sizifi. Ripërsërit procesin e votimit, ku nuk ka asnjë garanci se kjo gjë do të sjellë rezultat tjetër, sepse pikërisht nga partia që po e riprocedon ligjin, në kundërshtim me parimet juridike dhe pa bazë ligjore, ka deputetë që ende mendojnë se nenet 37 dhe 38 duhet të mbeten në Kod.

Sot e kemi një situatë kur varrmihësi kërkon të kthehet në shpëtimtar. E gjithë kjo ngutje po bëhet që PDK-ja të pajtohet me mediet, si dhe e ka qëllimin që sa më parë ta kthejë Hajredin Kuçin në Qeveri, e kjo është një logjikë tipike për interesat e ngushta.

Ne si Grup Parlamentar, të bindur që nenet 37, 38 dhe 39 janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, e kemi dërguar lëndën në Gjykatën Kushtetuese për interpretim. Ne shpresojmë në një interpretim të drejtë dhe të pavarur të Gjykatës Kushtetuese, si dhe brenda kornizës së afateve ligjore, të përcaktuara me ligj. Është Gjykata Kushtetuese, arbitri në këtë rast, dhe mendoj se duhet të fillojmë e ta respektojmë rendin institucional.

Natyrisht se Kuvendi dhe Gjykata janë institucione të pavarura, mirëpo Kuvendi e tha fjalën e tij në këtë ligj dhe pikërisht sepse nuk e tha drejt, ne e dërguam në Gjykatën Kushtetuese.

Unë, gjithashtu, e shfrytëzoj rastin t'u bëj thirrje edhe organizatave "ojg dog" që ta mbikëqyrin procesin në Gjykatën Kushtetuese, po ashtu ta mbikëqyrin edhe praktikën e procedurave parlamentare, pasi kjo çfarë po ndodh këtu nuk gjen model të ngjashëm në asnjë vend demokratik.

Dhe, së fundi, po ju them se mos mendoni se nenet 37, 38 dhe 39 janë i vetmi problem në Kodin Penal. Ky ligj e ka edhe një defekt tjetër shumë të rëndës. Shikojeni nenin 400 për dëshmitarët e mbrojtur, çfarë gabimi është bërë, dhe do ta shihni se ky kod nuk ofron asnjë siguri për mbrojtjen e tyre. A është ky një gabim aksidental, apo i qëllimshëm? Këtë le ta thonë ata që e kanë hartuar dhe miratuar Kodin Penal të Republikës së Kosovës, mirëpo pasojat e implementimit në praktikë do të jenë të mëdha. Faleminderit!

KRYETARI: Mendoj se përmendja e kriminelit Milosheviq nuk duhet të ndodhë shpesh në Kuvendin tonë dhe demokracia është sundim i shumicës, prandaj pakica duhet të mësohet e të mos përpiqet t'i imponojë gjithçka shumicës.

(Reagim)

Kjo duhet të jetë kulturë parlamentare. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se një herë dikush ka votuar për inat të dikujt tjetër, e dikush më vonë prapë ka votuar për inat të dikujt tjetër. Është përsëritur nja dy herë kjo në Kuvendin e Kosovës. Nuk është mirë.

Është hera e parë që më duhet tri herë të them për të njëjtën temë: "e mbështetim". Domethënë, është hera e tretë që duhet të them: E mbështetim heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës se kështu po ndodh. Kjo është ajo çfarë po ndodh.

Dhe, sa për atë kripën e famshme, t'i them Ademit, ne në Gjakovë themi "Duhet qitur ngadalë kripën, se është kollaj me ia qitë, por është goxha zor me ia heq". Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re, për të tretën herë e përkrah Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe duke marrë parasysh interpretimet të cilat janë duke u bërë sot në Kuvendin e Kosovës, është përgjegjësi e deputetëve nëse votojnë për apo kundër. Mirëpo, duhet të dihet se Kuvendi është vendi ku duhet të debatohet, e jo të fyhet, jo të përmenden fjalët që janë shumë larg Kuvendit.

Edhe një herë, kërkoj që deputetët të dinë çka duhet të miratohet në këtë Projektligj.

Koalicioni për Kosovë të Re, e them, për të tretën herë, e përkrah këtë Projektligj.

KRYETARI: Nuk ka të lajmëruar tjerë për diskutim. Shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Të pranishëm janë 64 deputetë.

Me 59 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë